



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Numër | 13
Shtator | 2018

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 13

BOTUES	© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës Departamenti i Analizave Ekonomike dhe i Stabilitetit Financiar 33 Garibaldi, Prishtinë 10000 Tel: ++381 38 222 055 Fax: ++381 38 243 763
Faqja e internetit	www.bqk-kos.org
Adresa elektronike	economic.analysis@bqk-kos.org
KRYEREDAKTOR	Zana GJOCAJ
REDAKTOR	Krenare MALOKU BAKIJA
AUTORË	Arta HASHIMI Arta NUSHI Bejtush KIÇMARI Taulant SYLA
REDAKTOR TEKNIK	Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CIS	Commonwealth of Independent States
DST	Të Drejtat Speciale të Tirazhit
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
ISSB	Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar
KJP	Kreditë jo-performuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KNK	Kthimi në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MeF	Ministria e Financave
MNI	Margjina Neto e Interesit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OJSHEF	Organizatat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (<i>angl.: Rule of Law Index</i>)
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
 Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2018),
 Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 13, Prishtinë.
 Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	12
2. Përmbledhje e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar-----	15
Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar-----	26
3. Ambianti i jashtëm makroekonomik dhe financiar -----	28
3.1. Zhvillimet makroekonomike globale-----	28
3.2. Zhvillimet në tregjet globale financiare -----	30
4. Ambianti i brendshëm ekonomik-----	33
4.1. Zhvillimet makroekonomike -----	33
4.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve -----	37
4.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare -----	41
5. Zhvillimet në sistemin financiar -----	44
5.1. Aktiviteti bankar -----	45
Kutia 2. Anketa e Kreditimit Bankar -----	49
6. Rreziqet e sektorit bankar -----	53
6.1. Rreziku kreditor -----	55
Kutia 3. Ndryshimet në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor -----	58
6.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit-----	59
6.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja-----	63
6.4. Kapitali -----	64
Kutia 4. Korniza rregullative mbi kërkesat për kapital -----	66
6.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit -----	68
6.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza stress-test-----	71
7. Institucionet financiare jo-bankare -----	78
7.1 Sektori Pensionsal-----	78
7.2 Sektori i Sigurimeve-----	80
7.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar -----	84
8. Infrastruktura Financiare në Kosovë-----	89
8.1. Sistemi i Pagesave -----	89
Kutia 5. Korniza rregullative në funksion të stabilitetit financiar -----	91
9. Korniza për Makroprudencë -----	93
9.1. Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut Sistemik -----	93
9.2. Kapitali shtesë kundërciklik -----	94
9.3. Bankat me rëndësi sistematike -----	95
9.4. Përmbledhje e zhvillimeve në tregues të zgjedhur të makroprudencës -----	98
10. Shtojca Statistikore-----	99

LISTA E FIGURAVE	15
Figura 1. Normat e rritjes ekonomike vjetore	15
Figura 2. Norma vjetore e rritjes së BPV-së reale në Kosovë	17
Figura 3. Ndryshimi vjetor i vlerës së shtuar sipas sektorëve ekonomik	18
Figura 4. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	19
Figura 5. Asetet e sektorëve të veçantë në kuadër të sistemit financiar	19
Figura 6. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar	20
Figura 7. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar: kriterët përbërës	20
Figura 8. Tregues të për zgjedhur të shëndetit financiar	21
Figura 9. Performanca financiare e sektorëve tjerë	23
Figura 10. Hendeku i kreditimit të sektorit privat	25
Figura 11. Harta e stabilitetit financiar	26
Figura 12. Norma e rritjes së BPV-së globale	28
Figura 13. Norma e rritjes së inflacionit në Eurozonë	28
Figura 14. Shkalla e KJP-ve në vendet kryesore të eurozonës në vitin 2017	29
Figura 15. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar në disa prej vendeve të eurozonës	29
Figura 16. Norma e rritjes së BPV-së në vendet e rajonit	29
Figura 17. Kursi i këmbimit të euros ndaj valutave kryesore	31
Figura 18. Çmimi i naftës 'Brent'	31
Figura 19. Çmimet e Metaleve	31
Figura 20. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuuesit në rritje	33
Figura 21. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor	34
Figura 22. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar	34
Figura 23. Pranimet e remitencave	35
Figura 24. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponentëve	35
Figura 25. Shuma e borxhit të emetuar, ndryshim vjetor	36
Figura 26. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore	36
Figura 27. Shuma e kërkuar dhe e emetuar e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës	36
Figura 28. Shuma e kërkuar dhe e emetuar e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës	36
Figura 29. Pjesëmarrja në letrat me vlerë, sipas afatit të maturitetit	37
Figura 30. Pjesëmarrja në letrat me vlerë, sipas afatit maturitetit	37
Figura 31. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës	37
Figura 32. Indeksi i qarkullimit industrial	38
Figura 33. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë	38
Figura 34. Indeksi i besueshmërisë së biznesit	38
Figura 35. Ndërmarrjet e reja	39
Figura 36. Borxhi i ndërmarrjeve	40
Figura 37. Normat e interesit për ndërmarrjet	40
Figura 38. Borxhi i ekonomive familjare	41

Figura 39. Depozitat e ekonomive familjare-----	42
Figura 40. Normat e interesit për ekonomitë familjare-----	42
Figura 41. Peshat e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së-----	44
Figura 42. Pjesëmarrja në gjithsej asetet e sistemit financiar -----	44
Figura 43. Pronësia e segmenteve përbërës të sistemit financiar-----	45
Figura 44. Pjesëmarrja në strukturën e aseteve -----	46
Figura 45. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake -----	46
Figura 46. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja -----	46
Figura 47. Pozicioni neto ndaj jo-rezidentëve -----	47
Figura 48. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktiviteteve me jo-rezidentët-----	47
Figura 49. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare-----	47
Figura 50. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare-----	48
Figura 51. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë: ndërmarrjet -----	48
Figura 52. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë: ekonomitë familjare-----	49
Figura 53. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve ---	50
Figura 54. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve-----	50
Figura 55. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet-----	51
Figura 56. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare -----	51
Figura 57. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare-----	52
Figura 58. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare -----	52
Figura 59. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriterëve të rreziqeve -----	53
Figura 60. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar -----	53
Figura 61. Rritja vjetore e kredive dhe kredive jo-performuese -----	55
Figura 62. Efekti i procesit të shlyerjeve (write-offs) -----	55
Figura 63. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit-----	56
Figura 64. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave -----	56
Figura 65. Kreditë jo-performuese-----	56
Figura 66. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve -----	57
Figura 67. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione -----	57
Figura 68. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	59
Figura 69. Struktura e profitit të sektorit bankar-----	60
Figura 70. Kontribuuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit -----	60
Figura 71. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit-----	60
Figura 72. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit -----	61
Figura 73. Struktura e të hyrave të sektorit bankar-----	61
Figura 74. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar -----	61
Figura 75. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar-----	62
Figura 76. Hendeku kumulativ i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit-----	62

Figura 77. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit	63
Figura 78. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë.....	63
Figura 79. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj	64
Figura 80. Kapitalizimi i sektorit bankar	64
Figura 81. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit	65
Figura 82. Struktura e kapitalit rregullator	65
Figura 83. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej asetëve të sektorit	65
Figura 84. Struktura e APR-ve sipas peshës së rrezikut.....	66
Figura 85. Klasat e asetëve sipas peshës së rrezikut	66
Figura 86. Struktura e financimit	68
Figura 87. Struktura e depozitave	68
Figura 88. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit.....	68
Figura 89. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive.....	69
Figura 90. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar.....	69
Figura 91. Indikatorët e likuiditetit.....	70
Figura 92. Rezervat e likuiditetit.....	70
Figura 93. Hendeku i likuiditetit.....	71
Figura 94. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit, sipas skenarëve.....	73
Figura 95. Rezultatet e stres testit për rrezikun kreditor-humbjet dhe rikapitalizimi	73
Figura 96. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit-skenari 1	76
Figura 97. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -skenari 2	77
Figura 98. Asetet e sektorit pensional	78
Figura 99. Struktura e investimeve të sektorit pensional.....	78
Figura 100. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensione.....	79
Figura 101. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.....	79
Figura 102. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve	79
Figura 103. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve.....	80
Figura 104. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë	80
Figura 105. Asetet e sektorit të sigurimeve	81
Figura 106. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve	81
Figura 107. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve	82
Figura 108. Primet bruto të arkëtuara	82
Figura 109. Struktura e primeve bruto të shkruara	82
Figura 110. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara	82
Figura 111. Ndryshimet në vlerën e primeve dhe dëmeve, sipas produkteve	83
Figura 112. Asetet e sektorit mikrofinanciar.....	84
Figura 113. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar	84
Figura 114. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit	85
Figura 115. Struktura e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik.....	85
Figura 116. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve.....	86

Figura 117. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar -----	86
Figura 118. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	86
Figura 119. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	87
Figura 120. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	87
Figura 121. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	88
Figura 122. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	88
Figura 123. Hendeku i kreditimit -----	95
Figura 124. Kapitali shtesë kundër-ciklik-----	95
Figura 125. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike-----	96
Figura 126. Kriteri i madhësisë -----	96
Figura 127. Kriteri i zëvendësueshmerisë -----	97
Figura 128. Kriteri i ndërlidhjes -----	97
Figura 129. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit -----	97

LISTA E TABELAVE ----- 16

Tabela 1. Rreziqet e sektorit bankar -----	16
Tabela 2. Treguesit e borxhit ndaj bankave dhe performancës së ekonomive familjare -----	43
Tabela 3. Numri i institucioneve financiare -----	45
Tabela 4. Rreziqet e sektorit bankar -----	54
Tabela 5. Supozimet për skenarët e rrezikut kreditor -----	72
Tabela 6. Koeficienti i elasticitetit të normës së KJP-ve -----	72
Tabela 7. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik kreditor -----	75
Tabela 8. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit -----	76
Tabela 9. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit -----	77
Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së -----	89
Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar -----	90
Tabela 12. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela -----	91
Tabela 13. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë -----	96

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka kënaqësinë t'i prezantojë publikut numrin e 13-të të Raportit të Stabilitetit Financiar (RSF), një dokument që publikohet dy herë në vit. Ky edicion i RSF-së është rishikuar dhe përmirësuar në përmbajtje dhe cilësi, gjithmonë në funksion të sigurimit të objektivit parësorë të BQK-së, ruajtjes së stabilitetit financiar përmes identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve që kanosin sistemin financiar dhe infrastrukturën e tij. Përmes një perspektive të analizës së bazuar në rrezik, RSF synon jo vetëm të informoj publikun mbi gjendjen e sistemit financiar, por edhe të rritë transparencën dhe të nxitë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar dhe infrastrukturës së tij.

Zhvillimet e jashtme me ndikim në stabilitetin financiar të Kosovës kanë qenë përgjithësisht të favorshme në gjysmën e dytë të vitit 2017. Aktiviteti ekonomik global si dhe aktiviteti ekonomik në eurozonë kanë shënuar përshpejtim të rritjes dhe prospektet për periudhën e ardhshme mbeten pozitive. Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka vazhduar me politikën e saj akomoduese monetare, duke qenë se inflacioni bazë vazhdoi të mbetet në objektivin e BQE-së, përkund rritjes së lehtë në periudhën e fundit. Zhvillime të ngjashme u shënuan edhe në ekonominë e Ballkanit Perëndimor, ku shkalla mesatare të inflacionit shënoi rritje si pasojë e rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Stabiliteti financiar është ndikuar pozitivisht nga rritja ekonomike në Kosovë, që ndikoi në përmirësimin e pozicionit financiar të agjentëve ekonomik. Rritja ekonomike që karakterizoi ekonominë e vendit në vitin 2017 dhe përmirësimi i aftësisë paguese të agjentëve ekonomik ka rezultuar në përmirësimin e mëtejshëm të portfolios kreditore, dhe rrjedhimisht, kanë krijuar kushtet për rritje më të madhe të kreditimit. Në linjë me zhvillimet në rajon, edhe në Kosovë, rritja e aktivitetit ekonomik dhe rritja e çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare është reflektuar në rritje të shkallës mesatare të inflacionit në vitin 2017. Për vitin 2018, projeksionet sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të ketë një normë më të lartë të rritjes ekonomike krahasuar me vitin 2017, duke krijuar rrethana më të favorshme për rritjen e kreditimit dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Vlerësuar në bazë të treguesve të performancës dhe shëndetit financiar, sektori bankar vazhdoi të karakterizohet me stabilitet të lartë. Indeksi i agreguar i rrezikut të sektorit bankar ka shënuar rënie krahasuar me vitin paraprak, kryesisht si rezultat i rënies së rrezikut kreditor dhe nivelit të lartë të profitabilitetit dhe kapitalit. Rezultatet e analizës stres-test sugjerojnë aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar tronditjet e mundshme në portfolion kreditore dhe atë të likuiditetit nën supozimin e disa skenarëve hipotetik të moderuar si dhe atyre më të rënduar.

Gjatë vitit 2017, edhe sektorët tjerë përbërës të sistemit financiar si sektori pensional, mikrofinanciar dhe sektori i sigurimeve u karakterizuan me rritje të aktivitetit dhe përmirësim të performancës financiare, përderisa edhe treguesit e shëndetit të këtyre sektorëve janë në nivele të kënaqshme. Posaçërisht vlen të theksohet përmirësimi i performancës së sektorit të sigurimeve, i cili pas një periudhe të gjatë të karakterizuar me rezultat financiar negativ, në vitin 2017 arriti të regjistrojë vlerë pozitive të neto profitit. Përmirësimi i performancës së sektorit të sigurimeve pasqyron rezultatet e masave rregullative dhe mbikëqyrëse të ndërmarra nga ana e BQK-së, me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm të këtij sektori.

Në funksion të zhvillimit të sektorit financiar dhe ruajtjes së stabilitetit financiar, gjatë vitit 2017, BQK ka vazhduar progresin drejtë avancimit të kornizës rregullative dhe infrastrukturës financiare. Në këtë periudhë, BQK ka hartuar rregullore të rëndësishme të sistemit financiar, duke kontribuar në përafrimin e kornizës rregullative me standarde ndërkombëtare me funksion të shtuar në ruajtjen e stabilitetit financiar. Infrastruktura financiare ka vazhduar zgjerimin dhe avancimin teknologjik,

duke rritur shtrirjen dhe përdorimin, me theks të veçantë në shërbimet elektronike dhe ato të automatizuara.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar punën për operacionalizimin e Politikës për Makroprudencë, e cila u adaptua në vitin 2016 me qëllim të identifikimit, monitorimit dhe vlerësimit të rrezikut sistemik në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar. Në vitin 2017, zhvillimet e përgjithshme të indikatorëve makroprudent në Kosovë ishin të qëndrueshme, pa ndonjë kërcënim për stabilitetin financiar të vendit.

Fehmi MEHMETI


Guvernator

2. Përmbledhje e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar

Zhvillimet e jashtme me ndikim në stabilitetin financiar të Kosovës kanë qenë të favorshme në gjysmën e dytë të vitit 2017, duke ndikuar që sektori financiar të vazhdojë të karakterizohet me qëndrueshmëri të lartë. Pritjet për rritje ekonomike të qëndrueshme në eurozonë vazhdojnë, si dhe prospektet për rimëkëmbjen e vendeve të rajonit mbeten pozitive, duke ndikuar në përmirësimin e mëtejshëm të faktorëve me ndikim në ekonominë e Kosovës dhe në pozicionin e agjentëve ekonomik. Sidoqoftë, pasiguri të vazhdueshme ekzistojnë rreth zhvillimeve në ekonominë dhe tregjet globale, të cilat në rast të materializimit mund të ndikojnë në rritjen e rrezikut nga ambienti i jashtëm makroekonomik. Rreziqet kanë të bëjnë kryesisht me pasiguritë e vazhdueshme rreth tensioneve gjeopolitike, konflikteve në tregtinë ndërkombëtare, luhatjeve të mëdha në nivelin e çmimeve të mallrave dhe metaleve, si dhe ndryshimet e mundshme në tregjet financiare apo ndryshimi i çmimeve të aseteve që mund të ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar.

Aktiviteti ekonomik global ka shënuar përshpejtim të rritjes. Norma mesatare e rritjes së ekonomisë globale ishte 3.8 përqind në vitin 2017 krahasuar me 3.2 përqind në vitin 2016, e mbështetur kryesisht nga përmirësimi i kushteve të financimit dhe rritja e çmimeve të naftës dhe metaleve. Rritja e aktivitetit ekonomik kishte shtrirje me bazë të gjerë, me ç'rast vendet në zhvillim kanë shënuar norma më të larta të rritjes.

Figura 1. Normat e rritjes ekonomike vjetore



Burimi: FMN, Eurostat dhe ASK (2018)

Ekonomia e eurozonës, si partneri kryesor tregtar i Kosovës dhe rajoni me origjinën më të lartë të remitencave, ka vazhduar me rritjen e qëndrueshme të aktivitetit ekonomik duke

shënuar një normë mesatare të rritjes së BPV-së prej 2.3 përqind nga 1.8 përqind sa ishte në vitin 2016. Kushtet e favorshme të financimit të mbështetura nga politikat stimuluese monetare të BQE-së, si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës dhe tregjeve të patundshmërive, ndikuan në rritjen e konsumit dhe investimeve private, të cilët ishin burimet kryesore të rritjes në eurozonë krahas përmirësimit të pozicionit neto të eksporteve.

Ballkani perëndimor është karakterizuar me vazhdim të rimëkëmbjes ekonomike, por me ritëm të ndryshëm ndërmjet vendeve. Aktiviteti ekonomik në nivel rajoni vlerësohet të jetë zgjeruar me 2.8 përqind gjatë vitit 2017, mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme dhe përmirësimit të neto eksporteve që u ndikua nga rritja e kërkesës në eurozonë. Norma më të larta të rritjes ekonomike janë shënuar në Mal të Zi dhe Shqipëri ndërsa në vendet tjera kanë shënuar norma më të ulëta të rritjes ekonomike krahasuar me vitin 2016 kryesisht si rezultat i kushteve jo të favorshme klimatike dhe pasigurive të vazhdueshme politike.

Tabela 1. Rreziqet e sektorit bankar *

Rreziqet	2016	2017	Trendi i rrezikut
Rreziku makroekonomik			↓
Rreziku Kreditor			↓
Rreziku i Profitabilitetit			↓
Rreziku i Solvencës			↓
Rreziku i Likuiditetit			↑
Rreziku Operacional			↑

Rrezik i papërfillshëm	Rrezik i ulët	Rrezik i mesëm	Rrezik mbi mesatar	Rrezik i lartë

Burimi: BQK (2018)

*Metodologjia e ndërtimit të shkallëve të rrezikut bazohet në metodologjinë e Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës


Pozita e stabiliteti financiar është ndikuar pozitivisht nga rritja ekonomike në vend që ndikoi në përmirësimin e pozicionit financiar të agjentëve ekonomik, si ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. Stabiliteti makroekonomik dhe përmirësimi i aftësisë paguese të agjentëve ekonomik ka rezultuar në përmirësimin e mëtejshëm të portfolios kreditore, që së bashku kanë mbështetur rritjen e kreditimit të qëndrueshëm. Pritjet për vitin 2018 janë që rritja ekonomike të përshpejtohet lehtësisht, duke krijuar rrethana të favorshme për vazhdimin e rritjes së kreditimit të qëndrueshëm dhe mbështetjen e pozitës së favorshme të profitabilitetit dhe kapitalizimit të sektorit bankar.

Aktiviteti ekonomik në Kosovë është rritur gjatë vitit 2017, ndonëse me normë më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në vitin 2017 shënoi rritje vjetore prej 3.7 përqind. Burimet e rritjes ishin kryesisht investimet dhe rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, ndërsa konsumi ka shënuar kontribut negativ. Degët e ekonomisë me kontributin më të madh në rritjen ekonomike ishin ndërtimtaria, tregtia me shumicë e pakicë, riparimi i automjeteve dhe aktivitetet financiare dhe të sigurimit. Rritja e aktivitetit ekonomik dhe rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare ndikuan në rritjen e presioneve inflacioniste në vend. Norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur

nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), është karakterizuar me rritje prej 1.5 përqind në vitin 2017.

Pozicioni fiskal i Kosovës vazhdon të jetë i qëndrueshëm. Reformat e vazhdueshme me synim ngushtimin e hendekut tatimor kanë ndikuar, ndër tjera, që të hyrat buxhetore të rriten më shumë në raport me shpenzimet. Kjo ka ndikuar në përmirësim të lehtë të deficitit primar buxhetor i cili në dhjetor 2017 zbriti në 0.9 përqind ndaj BPV-së. Borxhi publik, përkundër rritjes së vazhdueshme, mbetet në nivel relativisht të ulët në vetëm 16.6 përqind të BPV-së.

Figura 2. Norma vjetore e rritjes së BPV-së reale në Kosovë



Sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale për 9.0 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së suficitit në llogaritë e shërbimeve, të ardhurave dytësore dhe parësore, ndërkohë që deficitit tregtar i mallrave shënoi rritje. Rritja e kërkesës së jashtme ka ndikuar në rritjen më të madhe të eksporteve të mallrave në krahasim me importin, mirëpo niveli shumë më i lartë i importit të mallrave ka ndikuar që deficitin në tregtinë e mallrave të shënoj rritje prej 7.6 përqind dhe të arrijë në 2.7 miliardë euro. Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi rritje prej 25.9 përqind. Në kuadër të llogarisë rrjedhëse, remitancat u rritën për 9.9 përqind dhe IHD-të shënuan rritje vjetore prej 30.8 përqind. Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht

tek sektori i shërbimeve financiare, patundshmëritë dhe tek sektori i ndërtimtarisë, ndërsa sektori i tregtisë dhe industrisë shënuan rënie. Në fund të vitit 2017, borxhi i jashtëm i Kosovës (borxhi i jashtëm privat dhe borxhi i jashtëm publik), ishte 2.09 miliardë euro, që është për 3.8 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2016. Si përqindje e BPV-së, borxhi i jashtëm bruto arriti në 33.3 përqind.

Sipas projeksioneve të BQK-së, prospektet për rritje ekonomike në vitin 2018 janë pozitive, me ç'rast ekonomia pritet të shënoj një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2017, duke u luhatur në një interval prej 4.2 përqind në 4.4 përqind. Ky përmirësim i atribuohet stimulit të përforcuar fiskal gjatë vitit 2018, veçanërisht atij të gjeneruar nga shpenzimet kapitale të qeverisë. Remitencat dhe aktiviteti kredidhënës, edhe gjatë vitit 2018, pritet të jenë burime të qëndrueshme për financimin e aktivitetit ekonomik. Ambienti i jashtëm pritet të jetë favorizues për bilancin tregtar, bazuar në rishikimin për lartë të aktivitetit ekonomik në vendet partnere tregtare të Kosovës.

Performanca financiare e sektorit të ndërmarrjeve është përmirësuar, duke u reflektuar në përmirësim të cilësisë së kredisë nga ky sektor. Performanca më e mirë financiare ka ndikuar, në njërën anë, në rritjen e kërkesës për kredi, ndërsa në anën tjetër, përmirësimi i vazhdueshëm i faktorëve strukturor dhe kushteve për qasje në financa, kanë mundësuar rritjen e ofertës për kredi ndaj sektorit të ndërmarrjeve. Kredia e re për ndërmarrjet nga sektori bankar është rritur për 35 përqind, që shënon rritjen më të lartë në shtatë vitet e fundit. Ndërmarrjet kanë vazhduar gjithashtu me rritjen e financimit nga burimet e jashtme, me ç'rast borxhi i jashtëm arriti pjesëmarrjen në 21.1 përqind të gjithsej borxhit të ndërmarrjeve. Rritja e gjithsej borxhit të ndërmarrjeve ka kontribuar në thellimin e borxhit të ndërmarrjeve në 32.9 përqind ndaj BPV-së dhe përafrimin drejt vendeve të rajonit. Ndërmarrjet nuk kanë ekspozim direkt ndaj ndryshimeve në kursin valutor si rezultat i pozicionit tejet të ulët në valutë të huaj. Sidoqoftë, ndryshimet në valutë mund të ndikojnë aktivitetin afarist, sidomos të ndërmarrjeve tregtare.

Zhvillimet në treguesit ekonomik dhe financiar të ndërmarrjeve sugjerojnë për performancë pozitive të sektorit të

ndërmarrjeve. Sektori i industrisë dhe tregtisë me pakicë, që përbëjnë dy sektorët me pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej qarkullimin e sektorit të ndërmarrjeve, kanë rritur


qarkullimin. Pothuajse të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë kanë dhënë kontribut pozitiv në rritjen e vlerës së shtuar nga prodhimi i ndërmarrjeve. Numri i ndërmarrjeve që deklarojnë qarkullim në ATK, si dhe vlera e qarkullimit të deklaruar gjithashtu kanë shënuar rritje. Treguesi i klimës dhe ai i besueshmërisë së biznesit, përpiluar nga OEK, u karakterizuan me vlera më të larta në vitin 2017 përkundër pasigurive politike si rezultat i zgjedhjeve lokale dhe qendrore si dhe vonesave në formimin e qeverisë.

Çmimi i huamarrjes për sektorin e ndërmarrjeve ka vazhduar trendin rënës si rezultat i presioneve konkurruese dhe ambientit me norma të ulëta interesi. Cilësia e portfolios kreditore vazhdoi përmirësimin, kryesisht si rezultat i përcaktimit të afateve për shlyerjen e humbjeve nga bankat në qershor 2017 që ndikoi dukshëm në rritjen e nivelit të shlyerjeve. Rënia e kostos së financimit, përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore dhe performanca e përmirësuar financiare e ndërmarrjeve kanë ndikuar në rritjen e kërkesës për kredi.

Aktiviteti i shtuar ekonomik ka ndikuar në përmirësimin e lehtë në kushtet e tregut të punës, gjë që ka ndikuar në rritjen e të ardhurave të ekonomive familjare duke ndikuar, së bashku me faktorët e tjerë si rënia e kostos së financimit dhe përmirësimin e cilësisë së kredive, në rritjen e kërkesës për kredi. Kreditë e reja të sektorit bankar ndaj ekonomive familjare janë rritur për 15 përqind. Gjithsej borxhi i ekonomive familjare, përfshirë borxhin e jashtëm dhe atë nga sektori mikrofinanciar, është rritur për 15.6 përqind dhe ka arritur në 17 përqind të BPV-së së vendit. Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare, sipas treguesve të tërthortë, mendohet të ketë shënuar rënie të lehtë. Sektori i ekonomive familjare nuk ekspozohet ndaj rrezikut në valutë ngase kreditimi në valutë është marginal.

Neto pozicioni kreditor i ekonomive familjare ndaj sektorit bankar shënoi rënie si rezultat i rritjes më të lartë të kreditimit në raport me rritjen e depozitave të cilat shënuan rritjen më të ulët të regjistruar që nga fillimi i operimit në vend prej 2.3 përqind.

Figura 3. Ndryshimi vjetor i vlerës së shtuar sipas sektorëve ekonomik




Kreditë e sektorit bankar ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje vjetore prej 11.1 përqind. Depozitat e ndërmarrjeve shënuan përsheptim të rritjes vjetore gjithashtu, por rritja më e lartë e kreditimit ndikoi që neto pozicioni debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar të shënoi rritje në 995.0 milionë euro. Kreditimi i ndërmarrjeve nga bankat, përkundër rritjes së përsheptuar, vazhdon të mbetet nën potencialin e tij afatgjatë, siç sugjerohet nga hendeku negativ aktual i kreditimit ndaj BPV-së.

Ngadalësimi i trendit rritës të depozitave të ekonomive familjare mund të jetë dekurajim i ekonomive familjare për të investuar në këtë instrument si rezultat i normave mjaft të ulëta të interesit për depozita (1.0 përqind). Kursimet e ekonomive familjare gjithashtu shënuan rënie, potencialisht si rezultat i normave të ulëta të interesit. Kreditë, në anën tjetër, vazhduan rritjen dyshifrore duke ndikuar në ngushtimin për 4.3 përqind të pozicionit tradicionalisht

kreditor që kanë ekonomitë familjare ndaj sektorit bankar.

Figura 4. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare



Burimi: BQK (2018)


Sistemi financiar vazhdoi trendin rritës gjatë vitit 2017, ku sektori bankar dhe ai pensional zgjeruan aktivitetin konsiderueshëm. Të gjithë sektorët përbërës të sistemit financiar rritën asetet e tyre duke arritur vlerë prej 5.91 miliardë euro dhe rritje vjetore prej 9.7 përqind. Zhvillimet pozitive në sistemin financiar, të nxitura ndër tjera nga presionet e shtuara të konkurrencës, kontribuuan në shtrirje më të madhe të qasjes në produkte dhe shërbime financiare nga ana e publikut. Shkalla e ndërmjetësimit financiar, e shprehur si raport i aseve të sistemit financiar ndaj BPV-së është rritur për 5.3 pikë përqindje, duke arritur në 94.0 përqind.

Kreditë e sektorit bankar, si kontribuues kryesor në rritjen e aktivitetit të sistemit financiar, janë karakterizuar me një rritje të përshpejtuar vjetore prej 11.5 përqind duke arritur vlerën prej 2.49 miliardë euro. Rritja e kreditimit gjatë viti 2017 u nxit kryesisht nga oferta e lehtësuar kundrejt ndërmarrjeve, si dhe ekonomive familjare . Përmirësimi i kushteve të kreditimit u manifestua përmes kombinimit të masave si ulja e normave të interesit, rritja e shumës dhe maturitetit të kredive, si dhe zvogëlimi i kërkesave për kolateral, të cilat së bashku ndikuan në rritjen e aktivitetit kreditor. Ndërsa, faktorët kryesorë që ndikuan në lehtësimet në ofertën kreditore ishin rritja e konkurrencës në tregun kreditor, përmirësimi i cilësisë së kredive dhe qasja e favorshme në financim, sidomos atë të brendshëm nga depozitat. Në këtë funksion, ndikim pozitiv në rritjen e kreditimit kanë pasur edhe zhvillimet pozitive në faktorët strukturorë jo bankarë, si lansimi i Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive në

Kreditimi në valutë ndaj sektorit të ekonomive familjare mbetet në nivel të ngjashëm me vitin paraprak, nën 0.4 përqind të gjithsej kredisë për ekonomitë familjare. Vlera e kredive joperformuese pothuajse u përgjysmua në fund të vitit 2017, kryesisht si rezultat i rritjes së shlyerjeve të kredive të humbura nga bankat me hyrjen në fuqi të rregullores së re për përcaktimin e afateve të shlyerjeve.

vitin 2016, përmbauesit privatë, etj. Kreditë për sektorët kyç të ekonomisë, siç janë sektori i bujqësisë, prodhimit, ndërtimitarisë e tregtisë u karakterizuan me përshpejtim të rritjes vjetore. Kreditë me maturitet më të gjatë kanë vazhduar të rrisin pjesëmarrjen në gjithsej kreditë.

Figura 5. Asetet e sektorëve të veçantë në kuadër të sistemit financiar



Burimi: BQK (2018)

Burim kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar vazhdojnë të jenë depozitat, të cilat arritën vlerën 3.1 miliardë euro dhe shënuan rritje vjetore prej 6.8 përqind.


Në qëndrueshmërinë e rritjes së depozitave kryesisht ka kontribuar rritja e depozitave të ekonomive familjare, përkundër ngadalësimit të rritjes që është shënuar këtë vit. Njëherit, depozitat e ekonomive familjare konsiderohen

burim më i qëndrueshëm i financimit në raport me kanalet tjera të financimit, dhe janë kontribuues i rëndësishëm në stabilitetin e sektorit bankar.

Sektori bankar vazhdon të karakterizohet me stabilitet të lartë, vlerësuar në bazë të nivelit të treguesve të performancës dhe shëndetit financiar. Indeksi i agreguar i rrezikut të sektorit bankar ka shënuar rënie krahasuar me vitin paraprak, i ndikuar kryesisht nga rënia e rrezikut kreditor. Po ashtu edhe profitabiliteti dhe niveli i lartë i kapitalit kontribuuan në rënie të rrezikut të sektorit, përdërisa likuiditeti shënoi rritje të rrezikut krahasuar me vitin paraprak. Rritja e vazhdueshme e mospërputhjeve të afateve të maturimit si rezultat i zgjatjes së afateve të maturimit në anën e asetëve (kryesisht të kreditimit) dhe e rritjes së depozitave të transferueshme në anën e detyrimeve, ka ndikuar lehtësisht në rritjen e rrezikut të likuiditetit. Ky trend i zgjerimit të mospërputhjeve të maturitetit jep indikacione për ndryshime të mundshme në strukturën e financimit të bankave me qëllim mbështetjen e kreditimit afatgjatë. Rritja e vazhdueshme e kreditimit do të rrisë presionet në pozitën e kapitalit meqë presionet në profitabilitetin e sektorit në një ambient të rënies së vazhdueshme të normave të interesit në kredi mund të rriten. Përdërisa indikatorët e tjerë japin sinjale për rënie rreziku, nuk duhet injoruar faktin se rritja e vazhdueshme e digjitalizimit të shërbimeve financiare rritë ekspozimin e sektorit ndaj krimit kibernetik dhe rrezikut operacional, ndaj dhe duhen të ndërmerren masa adekuate për mbrojtje ndaj këtij rreziku në rritje.

Performanca e sektorit bankar dhe pozita e kapitalizimit shënuan rritje. Profiti u rritë për 13.1 përqind, duke arritur vlerën neto prej 85.4 milionë euro. Rritja e të hyrave neto nga jo-interesi, në formë të të hyrave nga tarifat dhe komisionet në njërin anë dhe në anën tjetër rënia e shpenzimeve për provizione e reflektuar nga zvogëlimi i rrezikut kreditor, ishin kontribuuesit kryesor në rritjen e profitit. Rritja e profitit gjatë vitit ndikoi në rritjen e indikatorëve të profitabilitetit.

Figura 6. Kreditë dhe depozitat e sektorit bankar




Burimi: BQK (2018)

Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) arriti në 2.6 përqind, ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) arriti në 21.3 përqind. Pozita e

kapitalizimit të sektorit vazhdon të reflektoj qëndrueshmëri dhe aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar humbjet potenciale. Treguesi i kapitalizimit arriti në 18.1 përqind, përdërisa cilësia e kapitalit rregullativ vazhdoi rritjen për të tretin vit radhazi si rezultat i rritjes së profitit të mbajtur. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e kapitalit të klasit të parë në gjithsej kapitalin rregullativ arriti në 90 përqind.

Figura 7. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar: kriterët përbërës




Burimi: BQK (2018)

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor ka vazhduar të bie, duke u pasqyruar me rënie të mëtejme të normës së kredive

joperformuese ndaj gjithsej kredive në 3.1 përqind në dhjetor 2017, që paraqet nivelin më të ulët që nga viti 2010. Procesi i shlyerjes së kredive joperformuese nga bilancet e bankave ka ndikuar në përmirësimin e mëtejshëm të kualitetit të portfolios kreditorë, krahas ndikimit pozitiv nga aktiviteti ekonomik në aftësinë paguese të agjentëve ekonomik si dhe i përmirësimit të faktorëve tjerë strukturor. Krahas ngritjes së cilësisë së portfoliut kreditor, është shënuar rritje e normës së mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione për humbje nga kreditë në 149.7 përqind, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme nga kreditë. Norma e kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive vazhdon të mbetet në nivelin më të ulët krahasuar me vendet e rajonit që mesatarisht kishin një normë të KJP-ve prej 10.0 përqind në dhjetor 2017.

Figura 8. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar



Burimi: BQK (2018)

Sektori bankar vazhdon të mbajë pozitë të kënaqshme të likuiditetit. Indikatorët kryesor të likuiditetit japin sinjale pozitive për stabilitet të likuiditetit bankar. Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të shumicës prej bankave janë depozitat, të cilat në nivel sektori tejkalojnë kreditë për 124.5 përqind. Megjithatë ky tregues u zvogëlua për 5.4 pikë përqindje, nën ndikimet e zgjerimit të aktivitetit kreditues. Asetet likuide qëndrojnë në nivele të larta dhe ndonëse raporti i tyre ndaj detyrimeve afatshkurtra u zvogëlua gjatë vitit në 37.9 përqind, raporti më i lartë se minimumi rregullator prej 25 përqind tregon për potencial të zgjerimit të aktivitetit kreditues. Bilanci i rezervave të likuiditetit të bankave komerciale

në BQK vazhdon të tejkalojë rezervën e obliguar për 53.4 përqind, përkundër normës negative të interesit në tepricën e rezervës. Ambienti i normave të ulëta të interesit është duke stimuluar ekonomitë familjare të zhvendosnin depozitat e tyre në favor të maturitetit afatshkurtër, që krahas trendit të përsheptimit të kreditimit afatgjatë rezultoi në theksimin e mospërputhjeve të maturitetit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve. Kjo situatë mund të paraqes sfidë për menaxhimin e likuiditetit të bankave në të ardhmen e mesme ndaj dhe mund të nxisë ndryshime në strukturën e financimit të bankave me qëllim të mbështetjes së kreditimit afatgjatë.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut vazhdon të jetë i ulët. Pozicioni i agreguar neto i hapur në valuta të huaja u zvogëlua gjatë vitit, duke e ulur më tej ekspozimin, edhe ashtu mjaft të ulët, ndaj rrezikut të ndryshimit të valutës. Raporti i pozicioneve neto të hapura për çdo valutë individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën nivelin maksimal prej 15 përqind të lejuar sipas rregullores përkatëse. Prandaj, luhatjet valutore kanë ndikim marginal në gjendjen financiare të sektorit, marrë parasysh nivelin mjaft të ulët të pozicioneve në valuta të huaja. Rreziku i tërthortë kreditor nga ekspozimi në valutë mbetet i ulët ngase kreditë në valutë mbeten në nivel të papërfillshëm. Kreditë në valutë të huaja përbëjnë vetëm 0.2 përqind të gjithsej kredive.

Rritja e vazhdueshme e kreditimit nga bankat në njërin anë si dhe rritja e pjesëmarrjes së depozitave të transferueshme dhe të atyre me afat më të shkurtër maturimi, ka rritur ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të ndryshimeve në norma të interesit. Krahasuar me vitin paraprak hendeku u zgjerua në të gjitha afatet e maturimit, përveç në afatin '31-90 ditë' që u ngushtua. Sidoqoftë, analiza e ndjeshmërisë së sektorit ndaj rritjes së mundshme të normës së interesit sugjeron për ekspozim të ulët të sektorit bankar ndaj këtij rreziku.

Avancimet teknologjike në fushën e financave, ndër tjera, kanë bërë sektorin më të ndjeshëm ndaj sulmeve të mundshme dhe gabimeve në sisteme, duke ngritur ekspozimin ndaj rrezikut operacional. Kërkesat për ndarje të kapitalit për rrezik operacional janë rritur, ndaj dhe niveli i mbajtjes së kapitalit për rrezik operacional në sektorin bankar të Kosovës ka shënuar rritje të qëndrueshme ndër vite. Bankat kanë krijuar sistem, politika dhe procedura të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut operacional. Menaxhimi i këtij rreziku në vitin 2017 ishte adekuat, duke mos pasur raste të materializimit të tij dhe duke ndarë kapitalin e nevojshëm për mbulimin e këtij rreziku në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore.


Sektorët tjerë përbërës të sistemit financiar u karakterizuan me rritje të aktivitetit dhe performancës financiare. Sektori pensional përfitoi nga diferenca e lartë pozitive në mes të kontributeve të reja dhe atyre të paguara, si dhe kthimit pozitiv në asete. Performanca e sektorit të sigurimeve u përmirësua duke rezultuar me profit pozitiv për dallim nga humbjet financiare të vitit paraprak. Sektori mikrofinanciar po ashtu u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit dhe performancës, të ndikuar kryesisht nga rritja e theksuar e kreditimit. Përkundër rritjes graduale, sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar mbesin me peshë modeste në raport me gjithsej asetet e sektorit financiar. Treguesit e shëndetit të këtyre sektorëve janë në nivele të kënaqshme. Ndërlidhja në mes të sektorit të sigurimeve dhe atij mikrofinanciar dhe segmenteve tjerë të sistemit financiar është ende në nivel të ulët, gjë që minimizon mundësitë e shpërndarjes së rreziqeve ndërmjet segmenteve të ndryshme të sistemit financiar të Kosovës.

Ecuria pozitive e kontributeve të reja dhe kthimit bruto në investimet e aseteve nga ana e fondeve pensionale ndikuan që ky sektor të rritet gradualisht ndër vite. Vlera e aseteve të sektorit pensional u karakterizua me një rritje vjetore prej 16.0 përqind, duke arritur në 1.65 miliardë euro. Struktura e aseteve të sektorit pensional vazhdon të dominohet nga investimet në tregun e jashtëm, të cilat kryesisht mbahen në formë të fondeve të përbashkëta që, diversifikojnë rrezikun me investimin në aksione dhe bono të thesarit të qeverive të huaja. Performanca financiare vjetore e sektorit shënoi rritje, kryesisht si rezultat i kthimit pozitiv në investime, rritjes së kontributeve të reja dhe rritjes së çmimit të aksioneve të fondeve pensionale. Zhvillimet pozitive në ekonominë e SHBA-së që u

Rezultatet e analizës stres-test sugjerojnë aftësi të lartë të sektorit bankar për të përballuar tronditjet e mundshme në portfolion kreditor dhe atë të likuiditetit nën supozimin e disa skenarëve hipotetik të moderuar si dhe atyre më të rënduar/ekstrem. Prova e sensitivitetit të sektorit ndaj goditjeve në kualitetin e portofolit kreditor dhe në nivelin e kapitalizimit që mund të pasojnë si rezultat goditjeve nga sektori real, nga ndryshimet në tregjet financiare të valutave dhe të normave të interesit, sugjeron për nivel të kënaqshëm të kapitalizimit për përballimin e goditjeve. Po ashtu, sektori bankar ka treguar aftësi për të ruajtur gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave.

shoqëruan me rritje të normave të interesit, ndikuan pozitivisht në rritjen e vlerës së kthimit në investime.

Figura 9. Performanca financiare e sektorëve tjerë



Burimi: BQK (2018)

Aktiviteti i sektorit të sigurimeve shënoi rritje. Masat rregullative dhe mbikëqyrëse ndaj sektorit të sigurimeve ndikuan pozitivisht në performancën financiare të sektorit. Sektori i sigurimeve zgjeroi aktivitetin e tij duke rritur asetet për 9.3 përqind. Niveli i penetrimit (niveli i ndërmjetësimit), më saktësisht primet e shkruara bruto si pjesë e BPV-së mbeten në nivel të ulët prej 1.4 përqind, pa ndonjë ndryshim në tre vitet e fundit kryesisht për shkak të rritjes më të lartë të BPV-së. Ndërsa, niveli i densitetit, që paraqet primet e shkruara për kokë banori gradualisht ka shënuar rritje ndër vite. Në vitin 2017, sektori shënoi kthesë në performancën e tij duke realizuar profit prej 6.4 milionë euro krahasuar me humbjen prej 26 milionë në vitin paraprak. Në performancën pozitive ndikuan ndërmarrja e masave prudente rregullative ndaj sektorit, si dhe hyrja në fuqi e Rregullores për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia dhe

menaxhimin e shpenzimeve të siguruesve në fillim të vitit 2017. Këto masa u reflektuan në rritjen e dëmeve të paguara nga disa kompani të sigurimeve 'jo-jetë', që në mënyrë direkte ka ndikuar në zvogëlimin e provizioneve teknike dhe rrjedhimisht në rënie të shpenzimeve.

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit dhe performancës, të ndikuar kryesisht nga rritja e theksuar e kreditimit. Vlera e aseteve të sektorit të mikrofinancave arriti në 192.4 milionë euro, që korrespondon me rritje vjetore prej 28.6 përqind. Kreditimi shënoi rritje vjetore prej 32.1 përqind. Për dallim nga vitet e më hershme, aktiviteti kreditor është orientuar në një masë më të madhe drejt sektorit të ndërmarrjeve. Performanca e sektorit mikrofinanciar u përmirësua në krahasim me pesë vitet e fundit, kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi që u ndikuan nga rritja e normave të interesit.

Korniza rregullative dhe infrastruktura financiare kanë vazhduar progresin në funksion të zhvillimit të sektorit financiar dhe ruajtjes së stabilitetit financiar. BQK gjatë vitit 2017 ka amandamentuar dhe hartuar rregullore të rëndësishme të sistemit financiar në përgjithësi dhe sektorit bankar në veçanti, duke kontribuar në përafrimin e kornizës rregullative me standarde ndërkombëtare me funksion të shtuar në ruajtjen e stabilitetit financiar. Gjithashtu, në vitin 2017 janë ndërmarrë iniciativa të rëndësishme në rishikimin e kornizës rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme për të përmirësuar informacionin në këtë fushë me peshë të madhe në stabilitetin e sektorit financiar, si dhe në rishikimin e rregullativës në sistemin e pagesave për të reflektuar rëndësinë sistemike të sistemit të pagesave. Infrastruktura financiare ka vazhduar zgjerimin dhe avancimin teknologjik, duke rritur shtrirjen dhe përdorimin, me theks të veçantë në shërbimet elektronike dhe ato të automatizuara.

Ndër rregulloret e amandamentuara në vitin 2017 ishte Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor, në kuadër të së cilës janë rregulluar kriteret dhe afatet kohore të shlyerjeve të kredive me qëllim të standardizimit dhe aplikimit të unifikuar të këtyre kriterëve për tërë sektorin bankar. Ky amandamentim përveç që ka ndikuar në sigurimin e barazisë në trajtimin e shlyerjeve në kuadër të sektorit, gjithashtu ka ndikuar edhe në rritjen e nivelit të shlyerjeve dhe përmirësimin e portfolios kreditorë të mbajtur

nga bankat. Efektet në nivelin e shlyerjeve ishin të vërejtshme në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017, i cili u karakterizua me rritje të theksuar të shlyerjeve dhe njëherit rënie të normës së kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive. Megjithëse norma e KJP-ve në sektorin bankar të Kosovës ishte në nivel të ulët edhe para aplikimit të ndryshimeve në nenin e shlyerjeve, një masë e tillë pritet të ketë efekt pozitiv në parandalimin e grumbullimit të humbjeve në të ardhmen.

Në proces të rishikimit janë edhe një sërë rregulloresh të ndërlidhura me procesin e përafrimit të kornizës rregullative me Kornizën e Bazelit për Kapitalin (angl: Basel Capital Framework), si dhe korniza rregullative që adreson aspekte të rëndësishme të sektorit financiar. Aktualisht BQK është në përfundim të procesit të adaptimit të plotë të kërkesave të Shtyllës së Parë të Bazelit, dhe njëkohësisht në proces të vazhdueshëm të avancimit të adaptimit të kërkesave të Shtyllës së Dytë dhe të Tretë. Gjithashtu, në proces të zhvillimit dhe avancimit janë edhe korniza rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme si dhe rregullimin e profesionit të vlerësuesve të pronave konform standardeve ndërkombëtare; korniza rregullative për procesin e rimëkëmbjes dhe likuidimit të bankave, si dhe rregullorja për Mbikëqyrjen e Sistemeve të Pagesave me

Rëndësi Sistematike si dhe metodologjia për vlerësimin e sistemeve të pagesave.

Infrastruktura bankare gjatë vitit 2017 vazhdoi të avancohet dhe të zgjerohet.


Numri si dhe vlera e transaksioneve të përpunuara nga sistemi ATS (Automatic Transfer System/Sistemi i Transferit Automatik) është rritur me 1.0 përkatësisht 9.2 përqind. Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare u karakterizua me rritje 4.9 përqind, ndërsa llogaritë e-banking kanë shënuar rritje prej 30.7 përqind. Me rritje u karakterizuan edhe kartelat e kreditit dhe debitit, numri i të cilave u ngrit për 7.7 përqind. Rrjeti i pajisjeve POS ka shënuar rritje, ndërsa numri i bankomatëve është zvogëluar. Përkundër zvogëlimit të numrit të bankomatëve, numri dhe vlera e transaksioneve të procesuara përmes tyre është rritur.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar punën për operacionalizim e Politikës për Makroprudencë, e cila u përpilua në vitin 2016 me qëllim të identifikimit, monitorimit dhe vlerësimit të rrezikut sistematik në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar. Në vitin 2017, zhvillimet e përgjithshme të indikatorëve makroprudencë në Kosovë ishin të qëndrueshme, pa ndonjë kërcënim për stabilitetin financiar të vendit. Njëkohësisht, përpjekjet për avancimin e analizës dhe kalibrimin e instrumenteve specifike për vlerësimin e rrezikut sistematik kanë vazhduar, me ç ‘rast është avancuar modeli për vlerësimin e hendekut të kreditimit, rezultatet e të cilit sugjerojnë që sektori privat në Kosovë asnjëherë nuk ka kaluar nëpër periudhë të ‘mbi kreditimit’ dhe vazhdon të jetë në periudhë graduale të thellimit të ndërmjetësisit financiar për të arritur së paku nivelin e vendeve të rajonit.

Në gjysmën e dytë të vitit 2017, zhvillimet e përgjithshme të indikatorëve makroprudencë në Kosovë ishin brenda parametrave të përcaktuar me kornizën legislative dhe Politikën për Makroprudencë. Treguesit e kapitalalizimit, profitabilitetit dhe likuiditetit sugjerojnë për zhvillime pozitive të qëndrueshme, pa ndonjë sinjal për akumulim të rreziqeve kreditore apo të likuiditetit.

Modelet për vlerësimin e rrezikut sistematik sugjerojnë për ekspozim të ulët ndaj rrezikut sistematik në dy dimensionet e tij, atë kohor dhe strukturor. Vlerësimi i hendekut të kreditimit ndaj BPV-së (angl: *credit to GDP gap*) jep sinjale se sektori bankar në Kosovë ka hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të

Figura 10. Hendeku i kreditimit të sektorit privat



aktivitetit kreditues në kuadër të kornizës së ambientit makro-financiar në të cilin vepron, përkundër rritjes vjetore dyshifrore në


periudhën e fundit. Treguesit tjerë shtesë si raporti i kredisë ndaj BPV-së, vlera e kredisë ndaj vlerës së kolateralit, si dhe vlerësimi kualitativ i ekspertëve mbështesin rezultatet e hendekut të kreditimit që sektori bankar i Kosovës është në fazën e thellimit të ndërmjetësimit mbi baza prudente ndaj dhe nuk ka shenja për akumulim të rrezikut sistemik në kohë. Sa i përket aspektit strukturorë të rrezikut sistemik që nënkupton ndërlidhjet ndërmjet akterëve financiarë dhe koncentrimin në tregje e sektorë të caktuar, rezultatet e modelit për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike tregojnë për prezencën e katër

bankave me rëndësi sistemike. Dy nga këto banka kanë rezultuar me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret (madhësisë, zëvendësueshmërisë, ndërlidhjes dhe aktivitetit ndërshtetërorë e kompleksitetit). Rezultatet po ashtu tregojnë që një bankë e cila nuk ka rëndësi të përgjithshme sistemike ka rezultuar e rëndësishme sistemikisht në kriterin e ndërlidhshmërisë. Sidoqoftë, sektori ka dëshmuar ndër vite që është mjaftë mirë i kapitalizuar dhe bankat me rëndësi sitemike posedojnë nivele të larta të kapitalit konform rëndësisë së tyre sistemike.

Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar

Harta e stabilitetit financiar¹ paraqet zhvillimet në treguesit kryesor të rreziqeve ndaj stabilitetit të sektorit bankar të Kosovës (figura 11). Gjysma e dytë e vitit 2017 është karakterizuar me rënie të rrezikut ndaj stabilitetit financiar nga ambienti makroekonomik i jashtëm, përderisa rreziku në ekonominë e brendshme mbetet ngjashëm por me tendencë rritjeje në fund të vitit. Zhvillimet pozitive në sektorin e ndërmarrjeve si dhe ekonomive familjare sugjerojnë për rënie të rrezikut nga veprimtaria e agjentëve ekonomikë, me përjashtim të rrezikut nga sektori qeveritar i cili është rritur lehtësisht. Treguesit e brendshëm të qëndrueshmërisë së sektorit kanë reflektuar zhvillime të ndryshueshme. Kapitalizimi dhe profitabiliteti i sektorit janë përmirësuar gjë që është reflektuar me rënie rreziku, ndërsa rreziku nga struktura e sektorit bankar është rritur lehtësisht por që në fund të vitit shfaq tendencë rënësë. Pozita e likuiditetit dhe financimit është përqësuar njashtu, duke u reflektuar në rritje rreziku. Përfundimisht, shumica e treguesve kanë shfaqur tendencë për rënie të rrezikut në fund të vitit si dhe vazhdojnë të qëndrojnë nën apo afër nivelit të rrezikut mesatar historik.²

Figura 11. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK (2018)

Rritja ekonomike e përshpejtuar e vendeve partnere tregtare të Kosovës në gjysmën e dytë të vitit 2017 ka dhënë kontributin kryesor në rënie të rrezikut edhe ashtu të ulët nga ambienti i jashtëm makroekonomik. Zhvillimet në të gjithë treguesit e tjerë të ekonomisë së jashtme kontribuuan në zbutjen e rrezikut, me përjashtim të çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare të cilat vazhduan rritjen edhe në gjysmën e dytë të vitit. Papunësia në vendet nga origjinonë shumica e remitencave të dërguara në Kosovë shënoi rënie si rezultat i rritjes ekonomike dhe kushteve më të favorshme në tregun e punës. Normat bazë të interesit vazhduan të bien më tutje, ndërsa prospektet për aktivitetin ekonomik në Evropë sipas Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim në Evropë u përmirësuan.

Ekonomia e Kosovës ka shënuar përshpejtim të rritjes dhe hendek pozitiv të prodhimit në gjysmën e dytë të vitit 2017, por me tendencë rënësë në fundin e vitit gjë që ka ndikuar në rritjen e rrezikut. Presionet inflacioniste, të cilat ishin më të larta se vitin paraprak, kontribuuan gjithashtu në rritje të rrezikut. Sidoqoftë, treguesit e tjerë të ekonomisë së brendshme u karakterizuan me zhvillime pozitive në kontekst të stabilitetit financiar dhe pothuajse balancuan efektin e rritjes së rrezikut nga faktorët e mësipërm. Borxhi i jashtëm ndaj BPV-së shënoi rënie të lehtë si rezultat i rritjes më të lartë ekonomike në raport me rritjen e borxhit; deficitin më të ulët tregtar në gjysmën e dytë të vitit ndikoi në rënie të raportit negativ të bilancit të llogarisë rrjedhëse ndaj BPV-së; vlerësimi i euros në tremujorin e tretë të vitit, ndikoi në rritjen e mesatares së normës reale efektive të këmbimit të euros dhe rënie të rrezikut, por që në fund të vitit u karakterizua me rënie; si dhe korniza ligjore dhe kualiteti i gjyqësorit shënuan progres. Niveli i rrezikut nga ambienti i brendshëm makroekonomik vazhdon të qëndroj lehtësisht mbi mesataren historike, kryesisht për shkak të presioneve më të larta inflacioniste si dhe trendit rritës së madhësisë së borxhit të jashtëm.

Sektori i ekonomive familjare dhe i ndërmarrjeve u karakterizuan me zhvillime pozitive dhe rënie më të theksuar të rrezikut. Kreditimi për ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet vazhdoi rritjen duke rezultuar në hendek pozitiv të kreditimit ndaj BPV-së për këta sektorë. Cilësia e portfolios kreditore vazhdoi trendin e përmirësimit të ndikuar nga politikat e reja për shlyerje si dhe kapaciteti më i lartë i pagesës, duke dhënë kontribut në rënie të rrezikut për stabilitet financiar. Zhvillim pozitiv për t'u theksuar për sektorin e ekonomive familjare ishte rritja e remitencave që paraqesin burim të rëndësishëm të të hyrave të sektorit. Ndërsa, treguesi i vetëm me ndikim

¹ Harta e Stabilitetit Financiar prezanton në mënyrë grafike lëvizjen e shkallës së rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut ndaj stabilitetit financiar në sektorin bankar të Kosovës si dhe mundëson krahasimin me notën mesatare historike të rrezikut për kategoritë përkatëse. Rritja e distancës nga qendra e hartës për treguesit reflekton rritje të rrezikut dhe zvogëlim të aftësisë për përballimin e goditjeve ndaj stabilitetit financiar dhe anasjelltas. Metodologjia e plotë e modelit të Hartës së Stabilitetit Financiar për Kosovën, i cili ka pësuar revidime të vazhdueshme në tregues dhe mënyrën e tyre të llogaritjes, paraqitet në Materialin Studimor të BQK-së Nr. 6.

² Ecuria e rrezikut nga treguesit e Hartës së Stabilitetit Financiar dhe kontributi i komponentëve përbërëse në nivelin përkatës të rrezikut paraqitet në Shtojcën 1.

negativ në këtë sektor ishte papunësia e cila shënoi rritje. Sektori i ndërmarrjeve u karakterizua me përmirësim në pothuajse të gjithë komponentët tjerë të tij. Indeksi i qarkullimit industrial dhe vlera e shtuar e sektorit të tregtisë në BPV-në e vendit u rritën. Besueshmëria e bizneseve, që reflekton pritjet e bizneseve për aktivitetin e përgjithshëm afarist, ishte më e lartë dhe tregoi tendencë rritëse në fund të vitit. Komponenti i vetëm që shënoi përkeqësim ishte bilanci neto i bizneseve të regjistruara dhe mbyllura gjatë kësaj periudhe.

Rreziku nga sektori qeveritar shënoi ngritje të lehtë. Zhvillimet kryesore përfshijnë rritjen e primit të rrezikut sovran, që reflekton rritjen e diferencës mes normës së bonove të thesarit të qeverisë Gjermane dhe asaj të Kosovës, si dhe rritjen e madhësisë së borxhit publik. Kosto e borxhit, në mesatare ka shënuar rënie, por tendenca rritëse në fund të vitit ka ndikuar që nota e rrezikut të rritet lehtësisht. Bilanci buxhetor në gjysmën e dytë të vitit, është përmirësuar, por suficiti më i ulët në tremujorin e tretë në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka ndikuar në rritjen e notës së rrezikut. Rritja e lehtë e rrezikut në treguesit e mësipërm pothuajse është neutralizuar nga rritja e të hyrave tatimore në këtë periudhë, që është reflektuar me nivelin ndër më të lartët të raportit të të hyrave tatimore ndaj BPV-së dhe rrjedhimisht me notën më të ulët të rrezikut në historikun e treguesit.

Zhvillimet në komponentët e treguesit të strukturës së sektorit bankar kanë qenë kryesisht pozitive, me përjashtim të rënies më të lartë të normës së kapitalizimit të disa bankave në raport me rënien e mesatares së sektorit, që ka ndikuar në rritjen e devijimit negativ ndaj normës mesatare të kapitalizimit të sektorit bankar, dhe rrjedhimisht ka kontribuar në rritjen e rrezikut të përgjithshëm. Zhvillimet pozitive në strukturën e sektorit përfshijnë rënie të shkallës së koncentrimin të aseteve të tri bankave më të mëdha, rënie të koncentrimin të portfolios kreditore të ndërmarrjeve, diversifikim më të lartë të portfolios së përgjithshme kreditore si dhe të burimeve të financimit të bankave.

Pozita e kapitalizimit dhe profitabilitetit të sektorit është përforcuar gjë që është reflektuar me rënie rreziku të treguesit. Raporti i kapitalit aksionar ndaj aseteve të sektorit ka arritur në nivelet më të larta historike, që së bashku me përmirësimin e theksuar të portfolios kreditore kanë kontribuar në rënie të konsiderueshme të rrezikut. Profiti është rritur gjatë kësaj periudhe, duke dhënë gjithashtu kontribut pozitiv. Zhvillimet të cilat kanë dhënë kontribut negativ janë rënia e normës së përgjithshme të mjaftueshmërisë së kapitalit, rënia e raportit të të hyrave të interesit ndaj aseteve të sektorit, si dhe rritja e ekspozimeve të mëdha.

Rritja e përshpejtuar e kreditimit si dhe ngadalësimi i normës së rritjes së depozitave të ekonomive familjare janë kontribuuesit kryesorë në rritjen e rrezikut të treguesit të likuiditetit dhe financimit të sektorit. Ambienti me norma të ulëta të interesit gjithashtu ka ndikuar në migrimin e depozitave drejt kategorive me maturitet më të ulët, duke ndikuar në thëllimin e hendekut të likuiditeti për asetet dhe detyrimet deri në 3 muaj, si dhe rënien e raportit të likuiditetit të sektorit. I vetmi komponentë me efekt zbutës në rrezikun e treguesit ishte rënia e pjesëmarrjes së detyrimeve të jorezidentëve në gjithsej detyrimet, që sugjeron për zhvillim pozitiv në kontekst të qëndrueshmërisë së burimeve të financimit. Duhet theksuar se niveli i rrezikut më të lartë të treguesit të likuiditetit dhe financimit krahas mesatares historike reflekton në masë të madhe natyrën e komponentëve të përfshirë në tregues si norma e rritjes së depozitave të ekonomive familjare e cila ishte e lartë në fillimet e funksionimit të sektorit dhe natyrshëm ka ndjekur trend rënës si rezultat i zhvillimit të sektorit dhe maturimit të rritjes së depozitave, si dhe raporti kredi/depozita i cili gjithashtu ka përcjellë trend natyrshëm rritës që nga fillimi i funksionimit të sektorit.

3. Ambienti i jashtëm makroekonomik dhe financiar

3.1. Zhvillimet makroekonomike globale


Ekonomia botërore, gjatë vitit 2017, ka shënuar zhvillime pozitive. Norma mesatare e rritjes ekonomike ishte 3.8 përqind (3.2 përqind në vitin 2016). Kjo rritje e aktivitetit ekonomik është mbështetur nga një varg faktorësh, ndër të tjera: përmirësimi i kushteve të financimit, politikave stimuluuese, rritja e çmimeve të naftës dhe metaleve, etj. Efektet e këtyre faktorëve kanë ndikuar në rritjen e investimeve të cilat kanë arritur nivelin prej 25.6 përqind të BPV-së nga 25.2 përqind sa ishin në vitin 2016. Rritja e investimeve ka ndikuar që të rritet edhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve për 5.0 përqind (2.2 përqind rritje në vitin 2016). **Presionet inflacioniste në nivel botëror kanë shënuar një ngritje të lehtë, nga 2.8 përqind sa ishte në vitin 2016 shkalla e inflacionit ka arritur në 3.0 përqind në vitin 2017.**

Rritja e aktivitetit ekonomik nuk ishte e koncentruar në një grup të shteteve por kishte një shtrirje me bazë të gjerë. Vendet e zhvilluara kanë shënuar një normë të rritjes prej 2.3 përqind (1.7 përqind në vitin 2016) ndërsa vendet në zhvillim kanë shënuar normë akoma më të lartë të rritjes ekonomike (4.8 përqind në vitin 2018 nga 4.4 përqind në vitin 2016). **Në mesin e vendeve të zhvilluara, ekonomia e eurozonës ka vazhduar me rritjen e qëndrueshme të aktivitetit ekonomik duke shënuar një normë mesatare të rritjes së BPV-së prej 2.3 përqind nga 1.8 përqind sa ishte në vitin 2016.** Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve në tregjet e punës dhe krijimi i vendeve të reja të punës, ka ndikuar në rritjen e të ardhurave dhe më pas të konsumit, ndërkohë që aktiviteti ekonomik është mbështetur edhe nga rritja e investimeve dhe eksporteve.

Kontribut të rëndësishëm në rritjen e aktivitetit ekonomik në eurozonë gjatë vitit 2017 ka dhënë edhe ruajta e politikës monetare lehtësuese nga ana e BQE-së, e cila ka ndikuar në përmirësimin e kushteve të financimit por edhe në ngritjen e shkallës së inflacionit. **Shkalla e inflacionit në eurozonë gjatë vitit 2017 ka arritur në 1.5 përqind, që është më afër objektivit të BQE-së prej 2 përqind krahasuar me nivelin prej 0.2 përqind në vitin 2016 (figura 13).** Ndikimi i politikave monetare ekspansioniste në nivelin e çmimeve është përkrahur edhe nga rritja e çmimeve të naftës dhe të energjisë gjatë vitit 2017.


Sa i përket vitit 2018, BQE parashikon se rritja e qëndrueshme ekonomike në eurozonë do të vazhdojë edhe në vitin 2018, e mbështetur nga efektet pozitive të masave lehtësuese monetare, zhvillimeve pozitive në tregun e punës si dhe rikuperimit ekonomik global, ndërkohë që pritet për stabilizim të

Figura 12. Norma e rritjes së BPV-së globale



Burimi: FMN (2018)

Figura 13. Norma e rritjes së inflacionit në Eurozonë



Burimi: Eurostat (2018)


çmimeve të mallrave kryesore kanë ndikuar që parashikimet për nivelin e inflacionit të jenë të njëjta me vitin 2017.

Eurozona në vitet e fundit është karakterizuar me rimëkëmbje të aktivitetit të kreditimit, si rezultat i mbështetjes nga faktorët e ofertës por edhe të kërkesës. Politika monetare akomoduese ka stimuluar zgjerimin e aktivitetit kreditues, ndërkohë që kërkesa për kredi është mbështetur nga normat e interesit të cilat janë në nivelet më të ulëta historike. **Rritja vjetore e kreditimit ndaj sektorit privat në eurozonë shënoi rritje prej 2.8 përqind në vitin 2017, një rritje e përsheptuar krahasuar me rritjen prej 2.3 përqind në vitin paraprak.** Kreditimi ndaj ndërmarrjeve shënoi rritje vjetore prej 3.1 përqind nga 2.3 përqind në vitin 2016, ndërsa kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 2.9 përqind nga 2.0 përqind në vitin 2016. Rritja e kreditimit ishte më e theksuar në Gjermani dhe Francë, përderisa në Greqi norma e kreditimit ishte negative. Për më tepër, bankat kanë vazhduar progresin në konsolidimin e bilanceve të gjendjes dhe kanë bërë progres në zvogëlimin e kredive joperformuese, të cilat megjithatë mbesin të larta në disa shtete dhe mund të paraqesin pengesë në rritjen e kreditimit (figura 14). **Edhe depozitat u karakterizuan me rritje vjetore. Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje vjetore prej 3.4 përqind në vitin 2017 (4.1 përqind rritje në vitin 2016), ndërsa depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje më të lartë prej 7.7 përqind (6.2 përqind në vitin 2016).**

Indikatorët e profitabilitetit, siç janë Kthimi në Mesataren e Aseteve dhe Kthimi në Mesataren e Kapitalit, shënuan rritje pothuajse në të gjitha vendet e eurozonës me përjashtim të Greqisë, e cila po vazhdon të karakterizohet me situatë të brishtë të profitabilitetit (figura 15).


Në vendet e Ballkanit Perëndimor, ngjashëm me eurozonën, aktiviteti ekonomik është zgjeruar gjatë vitit 2017, por me ritëm të ndryshëm ndërmjet vendeve. **Aktiviteti ekonomik në nivel rajoni vlerësohet të jetë zgjeruar me 2.8 përqind gjatë vitit 2017, mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme dhe përmirësimi të neto eksporteve që u ndikua nga rritja e kërkesës në eurozonë.** Norma më të larta të rritjes ekonomike janë shënuar në Mal të Zi dhe Shqipëri ndërsa në vendet tjera janë shënuar norma më të

Figura 14. Shkalla e KJP-ve në vendet kryesore të eurozonës në vitin 2017




Burimi: FMN (2018)

Figura 15. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar në disa prej vendeve të eurozonës, në 2017



Burimi: FMN (2018)

Figura 16. Norma e rritjes së BPV-së në vendet e rajonit në vitin 2017



Burimi: FMN (2018) dhe vlerësimet preliminare të ASK-së për Kosovën (2018)

Norma më të larta të rritjes ekonomike janë shënuar në Mal të Zi dhe Shqipëri ndërsa në vendet tjera janë shënuar norma më të

ulëta të rritjes ekonomike krahasuar me vitin 2016 (figura 16). Parashikimet e FMN-së për tërë vitin 2018 sugjerojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor do të shënojnë rritje ekonomike prej mesatarisht 3.4 përqind.

Ngritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare kanë shtuar presionet inflacioniste në vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat u reflektuan me ngritje të shkallës së inflacionit në të gjitha vendet përbërëse. **Në vitin 2017, shkalla mesatare vjetore e inflacionit në Ballkanin Perëndimor ishte rreth 1.9 përqind krahasuar me 0.2 përqind në vitin 2016.** Në sektorin bankar, kreditimi ka vazhduar të rritet dhe të jetë kontribues i rëndësishëm i rritjes së ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Kjo rritje e kreditimit u mbështet nga oferta e lehtësuar kreditore nga bankat por edhe nga rritja kërkesës për kredi. Mali i Zi dhe Kosova shënuan rritjen më të lartë me normë dyshifrore të rritjes, ndërsa norma mesatare e rritjes së kreditimit për rajonin e Ballkanit Perëndimor arriti në 6.1 përqind në vitin 2017 nga 3.8 përqind në vitin 2016. Cilësia e portfolios kreditore është përmirësuar në shumicën e vendeve, por ende mbetet e lartë me përjashtim të Kosovës që ka normën më të ulët të kredive jo-performuese. Sektori bankar në vendet e rajonit u karakterizua gjithashtu edhe me rritje të nivelit të përgjithshëm të depozitave, por me shkallë mesatare lehtësisht më të ulët se në vitin 2016 si rezultat i ngadalësimit të rritjes në Shqipëri dhe Serbi. Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina shënuan rritje dyshifrore, përderisa mesatarja vjetore e rritjes së depozitave për rajonin në tërësi ishte 6.8 përqind në 2017 (7.8 përqind në vitin 2016).

3.2. Zhvillimet në tregjet globale financiare

Zhvillimet në tregjet globale financiare ishin të favorshme dhe optimiste gjatë vitit 2017, përkundër divergjencave në politikat monetare ndërmjet vendeve. Rezerva Federale në SHBA, duke pasur parasysh rritjen e qëndrueshme të ekonomisë, ka shtrënguar politikën e sajë monetare, por që vazhdon të mbetet akomoduese dhe të mbështesë tregun e punës dhe rritjen e inflacionit. Edhe Banka e Anglisë, në përgjigje të zhvlerësimit të monedhës vendëse dhe rritjes së inflacionit, ka shtrënguar politikën e sajë monetare, duke realizuar rritjen e parë të normës bazë në 10 vitet e fundit (në 0.50 përqind nga 0.25 përqind sa ishte në vitin 2016). Në anën tjetër, BQE-ja ka vazhduar me politikën monetare akomoduese pasi që inflacioni vazhdon të mbetet nën nivelin e synuar prej 2 përqind. Divergjenca sa i përket politikës monetare janë shënuar edhe në vendet në zhvillim, mirëpo përgjithësisht bankat qendrore kanë ndjekur një politikë monetare akomoduese, si rezultat i presioneve të dobëta inflacioniste. Kjo politikë akomoduese në vendet në zhvillim ka ndikuar në një përmirësim modest të kushteve të financimit ndërkohë që edhe çmimet e aksioneve ishin në rritje gjatë vitit 2017, mbështetur nga pritjet për një përmirësim të aktivitetit ekonomik të vendeve eksportuese të naftës dhe lëndëve të tjera të para.

Normat e interesit në tregun global të parasë kanë vazhduar të shënojnë divergjenca gjatë vitit 2017. Norma e interesit të Libor-it në SHBA shënoi rritje për shkak të rritjes së normës së interesit nga ana e Fed-it. Në vitin 2017, norma e interesit të Libor-it tremujor ishte 1.26 përqind (0.74 përqind në vitin 2016). Në anën tjetër, Euribori në eurozonë ka shënuar rënie të mëtutjeshme, pasi që BQE vazhdoi me politikën monetare akomoduese. Në vitin 2017, Euribori tremujor regjistroi -0.33 përqind (-0.26 përqind në vitin 2016). Sa i përket tregjeve të kapitalit, zhvillimet kanë qenë pozitive, të karakterizuara me rikuperim të gjerë të çmimeve të aksioneve në ekonomitë e mëdha. Deri në fund të vitit 2017, STOXX 50 në eurozonë, Standard & Poor's 500 në SHBA, dhe Nikkei 225 në Japoni fituan 16.2 përqind, 16.9 përqind dhe 19.4 përqind krahasuar me vitin 2016.

Valuta euro ka shënuar vlerësim kundrejt dollarit amerikan, sterlinës britanike dhe frankut zviceran në vitin 2017. Norma mesatare e këmbimit të euros ndaj dollarit amerikan dhe frankut zviceran është vlerësuar për 2.0 përqind, ndërsa ndaj sterlinës britanike është vlerësuar për 7.0 përqind (figura 17). Forcimi i ekonomisë së eurozonës, bilanci pozitiv tregtar, si dhe sinjalizimi i BQE-së për ngadalësimin e mundshëm të programit të blerjes së aseteve, ndër tjera, kanë ndikuar në


forcimin e monedhës së euros kundrejt këtyre valutave kryesore. Ndërsa, kundrejt monedhave të rajonit si lekut shqiptar, dinarit serb dhe denarit maqedonas, euro është zhvlerësuar me 2.3, përkatësisht 1.5 përqind dhe 0.01 përqind.

Gjatë vitit 2017 çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare kanë shënuar rritje. Çmimet e naftës, të cilat kanë shënuar rritje, janë ndikuar nga një sërë faktorësh, ku përfshihen zvogëlimi i stoqeve në kushtet e rritjes së kërkesës botërore, marrëveshja e vendeve të OPEC-ut për të reduktuar ofertën e naftës dhe stabilizimit të prodhimit të naftës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çmimi i naftës 'Brent', në fund të vitit 2017, arriti vlerën prej 61.5 dollarë për fuçi, duke regjistruar një rritje vjetore rreth 22.7 përqind (figura 18). Sipas projeksioneve të Bankës Botërore, gjatë vitit 2018, vlera mesatare e çmimit të naftës 'Brent' pritet të luhet rreth vlerës 56 dollarë për fuçi, ndërkohë që gjatë vitit 2017, vlera mesatare ka qenë rreth 54.4 dollarë për fuçi. Megjithatë, ekzistojnë rreziqe të mundshme rreth këtij projeksioni, duke qenë se oferta e naftës nga vendet prodhuese mund të jetë e luhatshme duke pasur parasysh mungesën e stabilitetit politik. Gjithashtu, marrëveshja ndërmjet anëtarëve të OPEC-ut dhe anëtarëve jashtë saj mund të rezultojë në reduktime më të thella të prodhimit të naftës ose në dështim të zgjatjes së kësaj marrëveshje, të cilat mund të gjenerojnë presione rritëse apo ulëse në çmimin e naftës.

Çmimet e metaleve dhe mineraleve shënuan rritje vjetore prej 20.0 përqind në tremujorin e fundit të vitit 2017, ndërkohë që rritja për krejt vitin 2017 ishte më e lartë (rreth 24.2 përqind) (figura 19). Kjo rritje më e ngadalësuar në tremujorin e fundit të vitit është rezultat i reduktimit të kërkesës në sektorët e infrastrukturës, prodhimit dhe pasurisë së patundshme në ekonominë e Kinës.

Çmimet e arit në vitin 2017 shënuan një rritje të lehtë me 0.7 përqind, duke arritur vlerën mesatare prej 1,257.6 dollarë për ons, kryesisht si rezultat i dobësimit të monedhës së dollarit dhe kërkesës së qëndrueshme për investim. Rritja e çmimeve të metalit, sipas projeksioneve të Bankës Botërore, pritet të zbutet gjatë vitit 2018. Për shkak të ofertës së lartë, çmimi i metalit të hekurit pritet të shënojë rënie prej 11 përqind, e cila pritet të kompensohet nga rritja e çmimeve të gjithë metaleve të tjera kryesore, veçanërisht e nikelit. Rreziqe të mundshme mbi çmimet e metaleve bazë mund të vijnë nga përforcimi i kërkesës në nivel


Figura 17. Kursi i këmbimit të euros ndaj valutave kryesore



Burimi: BQK (2018)


prodhimit të naftës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çmimi i naftës 'Brent', në fund të vitit 2017, arriti vlerën prej 61.5 dollarë për fuçi, duke regjistruar një rritje vjetore rreth 22.7 përqind (figura 18).

Figura 18. Çmimi i naftës 'Brent'



Burimi: Banka Botërore (2018)

Figura 19. Çmimet e Metaleve



Burimi: Banka Botërore (2018)

global dhe reduktimet në prodhim. Ndërsa, çmimi i arit pritet të rritet me rreth 3.4 përqind, si rezultat i rritjes së kërkesës për investim. Edhe çmimet e ushqimeve kanë shënuar një ngritje të lehtë gjatë vitit 2017 (0.7 përqind), si rezultat i mbjelljeve të reduktuara të misrit dhe prodhimit të kufizuar në Amerikën Jugore për shkak të kushteve klimaterike. Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim, çmimet e ushqimeve priten të stabilizohen, me një tendencë të lehtë rritëse si pasojë e shtrengimit së ofertës së tyre.

4. Ambienti i brendshëm ekonomik

4.1. Zhvillimet makroekonomike

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me zgjerim të aktivitetit gjatë vitit 2017 kundrejt vitit paraprak. Sipas vlerësimeve preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2017, vlera nominale e BPV-së arriti në 6.3 miliardë euro, që në terma real, përkon me një rritje mesatare vjetore prej 3.7 përqind. Për vitin 2018, projeksionet e BQK-së sugjerojnë një rritje reale të BPV-së në një interval prej 4.2 përqind në 4.4 përqind.

Për dallim nga vitet paraprake, faktorët që ndikuan në rritjen e BPV-së në vitin 2017 ndryshuan me pozicionin e investimeve dhe neto eksporteve që kontribuan pozitivisht përderisa konsumi shënoi rënie. Vlen të theksohet se dinamika e aktivitetit kreditues, që rezultoi të ketë qenë në nivelin më të lartë në pesë vitet e fundit, shërbeu si katalizator i rëndësishëm në financimin e aktivitetit ekonomik në vend (konsumit dhe investimeve).


Në vitin 2017, burimet kryesore të konsumit si kreditë e reja konsumuese, remitencat, kompensimi i punëtorëve dhe mallrat konsumuese të importuara shënuan rritje.

Megjithatë, të dhënat zyrtare të publikuara nga ASK sugjeruan rënie të vlerës së konsumit të përgjithshëm, rënie që i'a atribuuan kryesisht ndryshimeve metodologjike të aplikuara në përlllogaritjen e këtij komponenti. Gjithashtu, rritja e kërkesës së jashtme si dhe rritja e çmimeve të metaleve në tregjet ndërkombëtare u reflektuan pozitivisht në rritjen reale të BPV-së, ngase ndikuan në një rritje të konsiderueshme të eksportit të mallrave dhe shërbimeve dhe përmirësimit të pozicionit të neto eksporteve (figura 20). **Në të njëjtën periudhë, rritja e kredive të reja investuese dhe IHD-ve ndikuan në përforcimin e pozicionit të investimeve private.** Sipas qasjes së prodhimit, aktiviteti ekonomik vlerësohet të jetë mbështetur kryesisht nga sektori i shërbimeve dhe ndërtimit, ashtu siç evidentohet edhe në seksionin e mëposhtëm në figurën që ilustron ndryshimin vjetor të vlerës së shtuar sipas sektorëve ekonomik.

Për vitin 2018, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se rritja pritet të mbështetet nga konsumi real privat (3.8 pikë përqindje), konsumi privat qeveritar (0.3 pikë përqindje) dhe investimet totale (3.0 pikë përqindje). Ndërsa, eksporti neto i mallrave dhe shërbimeve pritet të ketë kontribut negativ (rreth 1.1 pikë përqindje). Kontribut më të lartë në rritjen reale të BPV-së pritet të ketë stimuli i përforcuar fiskal, veçanërisht ai i gjeneruar nga shpenzimet kapitale të qeverisë. Gjithashtu, rritja e kreditimit bankar si dhe rritja e flukseve hyrëse të transferimeve nga jashtë në formë të remitencave dhe kompensimit të punëtorëve pritet të vazhdojnë të jenë burime të qëndrueshme për financimin e aktivitetit ekonomik.

Rritja e çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare dhe rritja e kërkesës së brendshme rezultuan në rritje të nivelit të çmimeve në vitin 2017. Për dallim nga viti paraprak, në vitin 2017, norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), është karakterizuar me rritje prej 1.5 përqind në vitin 2017 (figura 21). **Për vitin 2018, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit pritet të karakterizohet me një tendencë rritëse, megjithëse vlera mesatare e shënuar pritet të luhet rreth shkallës prej 1.0 përqind.**

Figura 20. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2018)

Sektori fiskal në vitin 2017 është karakterizuar me një përmirësim të lehtë të deficitit primar buxhetor. Vlera e deficitit primar në vitin 2017 ishte 59.0 milionë euro, përderisa si përqindje e BPV-së, deficitit primar ka shënuar rënie nga 1.0 përqind në 0.9 përqind. Në zvogëlimin e deficitit primar buxhetor ndikoi rritja më e lartë e të hyrave buxhetore që kryesisht i atribuohet rritjes së aktivitetit ekonomik, por edhe reformave të ndërmarra nga agjencitë e të hyrave që kanë për synim ngushtimin e hendekut tatimor. Në vitin 2017, të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore u karakterizuan me rritje, rritje që pritet të vazhdojë edhe në vitin 2018 dhe përkthehet në rritje të aktivitetit ekonomik.

Në vitin 2017, borxhi publik ka arritur në 996.4 milionë euro, një rritje vjetore prej 16.8 përqind. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.6 përqind, një rritje që i atribuohet kryesisht rritjes së borxhit të brendshëm prej 19.9 përqind (i cili ka arritur në 574.3 milionë euro), si dhe borxhit të jashtëm publik i cili ka shënuar rritje prej 12.9 përqind duke arritur në 422.2 milionë euro. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithsej borxhin publik është zvogëluar në 42.4 përqind nga 43.8 përqind sa ishte në vitin 2016.

Ekonomia e vendit vazhdon të ballafaqohet me disekuilibër kundrejt sektorit të jashtëm, megjithëse viti 2017, pozicioni i neto eksporteve vlerësohet të ketë kontribuar pozitivisht në rritjen reale të BPV-së. Përderisa vlera e shtuar nga sektorët prodhues në vend mbetet e ulët, rritja e kërkesës së brendshme dhe rritja e çmimeve të importit rezultoi në rritje të vlerës së përgjithshme të importit në Kosovë. Rritja e konsumit dhe investimeve gjatë vitit 2017 ka ndikuar në rritjen e importeve, gjë që është përkthyer në rritje të deficitit tregtar të mallrave përkundër rritjes së eksporteve. **Në vitin 2017, deficitit në tregtinë e mallrave shënoi rritje prej 7.6 përqind dhe arriti në 2.7 miliardë euro** (figura 22).³ Megjithatë, rritja e suficitit në llogaritë e shërbimeve dhe të ardhurave dytësore dhe parësore ndikoi që deficitit i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale të shënoj një rënie vjetore prej 9.0 përqind, duke shënuar vlerën prej 425.1 milionë euro apo rreth 6.6 përqind të BPV-së (7.7 përqind e BPV-së në vitin 2016).


Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 804.2 milionë euro, një rritje prej 25.9 përqind krahasuar me vitin 2016. Rritja e vlerës së eksportit të shërbimeve prej 17.7 përqind kryesisht i atribuohet rritjes së eksporteve të shërbimeve të udhëtimit dhe shërbimeve kompjuterike. Ndërkaq, vlera e importit të shërbimeve shënoi rritje prej 7.1 përqind dhe kryesisht i'u atribuua rritjes së importit të shërbimeve të udhëtimit.

Figura 21. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor



Burimi: ASK (2018)

Figura 22. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar



Burimi: ASK (2018)

³ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Llogaria e të ardhurave parësore arriti vlerën prej 84.9 milionë euro apo 14.0 përqind më shumë krahasuar me vitin 2016. Të ardhurave nga kompensimi i punëtorëve⁴, që është kategoria kryesore e të ardhurave parësore, shënuan rritje për 11.4 përqind. **Bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 6.0 përqind, që i atribuohet nivelit më të lartë të remitencave.** Flukset hyrëse të remitencave, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe të llogarisë së të ardhurave dytësore, shënuan vlerën prej 759.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.9 përqind (figura 23). Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 39.3 përqind përkatësisht 22.5 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.0 përqind e gjithsej remitencave.


Gjatë vitit 2017, IHD-të e pranuar në Kosovë u karakterizuan me një rritje vjetore prej 30.8 përqind dhe arritën vlerën prej 287.8 milionë euro. Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht tek sektori i shërbimeve financiare, patundshmërive dhe tek sektori i ndërtimtarisë, përderisa sektori i tregtisë dhe ai i industrisë shënuan rënie. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje të vlerës u karakterizua kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që njëherësh përbën edhe rreth 92 përqind të gjithsej IHD-ve, ndërsa investimet në instrumentet e borxhit shënuan rënie (figura 24).

Në fund të vitit 2017, borxhi i jashtëm i Kosovës (borxhi i jashtëm privat dhe borxhi i jashtëm publik), ishte 2.09 miliardë euro, që është për 3.8 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2016. Si përqindje e BPV-së, borxhi i jashtëm bruto arriti në 33.3 përqind, përderisa struktura e borxhit vijon të ndahet mes FMN-së (pjesëmarrje prej 11.3 përqind), Bankës Botërore (pjesëmarrje prej 9.7 përqind), si dhe kreditorëve tjerë (rreth 38.9 përqind e borxhit ndaj kreditorëve tjerë është kreditim ndërmjet kompanive) që kanë një pjesëmarrje dominuese prej 79.0 përqind.

4.1.1 Tregu i letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë vazhdon të jetë burim mjaftë i rëndësishëm për Qeverinë e Kosovës, si për financimin e projekteve investuese dhe të deficitit të buxhetit shtetëror, ashtu edhe për të paguar potencialisht garancitë shtetërore, shpenzimet e shërbimit të borxhit shtetëror, apo shpenzimet tjera të rezultuara nga një emergjencë kombëtare. Që nga fillimi i emetimit të letrave me vlerë në vitin 2012, deri në dhjetor 2017, janë emetuar letra me vlerë në shumën prej 2.09 miliardë euro, kurse të hyrat për Ministrinë e Financave kanë arritur vlerën


Figura 23. Pranimet e remitencave



Burimi: BQK (2018)

Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 39.3 përqind përkatësisht 22.5 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.0 përqind e gjithsej remitencave.

Figura 24. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve




Burimi: BQK (2018)

⁴ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshin punëtorët sezonalë apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitarë të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.


në 2.08 miliardë euro. Ndërsa, kërkesa për të investuar në letrat me vlerë ishte për 1.81 herë më e lartë se sa mjetet e kërkuara nga Ministria e Financave dhe arriti vlerën në 3.79 miliardë euro gjatë kësaj periudhe. Për më tepër, gjatë periudhës janar 2012 – dhjetor 2017 kanë maturuar letra me vlerë në shumën prej 1.51 miliardë euro.

Figura 25. Shuma e borxhit të emetuar, ndryshim vjetor



Burimi: BQK (2018)


Figura 26. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore



Burimi: BQK (2018)


Në vitin 2017, Qeveria e Kosovës ka emetuar borxh në vlerën prej 405.0 milionë euro, e cila është për 3.6 përqind më e ulët se vitin e kaluar. Pavarësisht rënies së letrave me vlerë të emetuara, që është rezultat i politikave të Departamentit të Thesarit, në kuadër të Ministrisë së Financave, kërkesa për të investuar në këto instrumente vazhdon të jetë e lartë. Shuma e ofertuar nga subjektet pjesëmarrëse në ankande, që në çdo ankand ka tejkaluar shumën e shpallur nga qeveria. Raporti i shumës së ofertuar ndaj shumës së shpallur në vitin 2017 ishte 1.64 (2.17 në vitin 2016).

Figura 27. Shuma e kërkuar dhe e emetuar e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës



Burimi: BQK (2018)

Figura 28. Shuma e kërkuar dhe e emetuar e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës



Burimi: BQK (2018)

Struktura e emetimeve të letrave me vlerë, për herë të parë dominohet nga obligacione qeveritare (me maturim ‘mbi 1 vit’), që kanë një pjesëmarrje prej 53.1 përqind në gjithsej emetimet në vitin 2017 (38.1 përqind në vitin 2016). Kurse, bonot e thesarit (me maturim ‘deri 1 vit’), të cilat në të kaluarën dominuan strukturën e letrave me vlerë në vitin 2017 kishin një pjesëmarrje prej 46.9 përqind (61.9 përqind në vitin 2016) në gjithsej letrat me vlerë. Emetimet në formë të bonove të thesarit me afat maturimi ‘prej 1 viti’ dominojnë strukturën e gjithsej letrave me vlerë (figura 27), mirëpo, fletë obligacionet qeveritare me afat maturimi ‘mbi 5 vite’, në vitin 2017 shënuan rritjen më të lartë vjetore (prej 71.4 përqind).

Figura 29. Pjesëmarrja në letrat me vlerë, sipas afatit të maturitetit






Figura 30. Pjesëmarrja në letrat me vlerë, sipas afatit të maturitetit



Norma e përgjithshme mesatare e interesit në letrat me vlerë shënoi rritje të lehtë në 0.81 përqind, krahasuar me 0.79 përqind në vitin paraprak, duke reflektuar kryesisht raportin kërkesë-ofertë në ankande. Krahasuar me vendet e rajonit, normat e interesit në letrat me vlerë

të Kosovës janë dukshëm më të ulëta, ku në vitin 2017 Shqipëria kishte një normë mesatare të interesit prej 3.12 përqind, Serbia 2.83 përqind dhe Maqedonia 2.48 përqind. Me gjithë rritjen e shënuar në vitin 2017, dy vitet e fundit janë karakterizuar me rënie të normave të interesit në të gjitha kategoritë e letrave me vlerë (figura 31). Kjo rënie mund ti atribuohet rritjes së konkurrencës në treg për investime në letra me vlerë të qeverisë së Kosovës, si produkt që ka ofruar kthime të favorshme në kushtet kur normat e interesit në tregjet e jashtme ende janë të ulëta. Po ashtu, edhe pozita e mirë e likuiditetit në sektorin bankar mund të ketë ndikuar në uljen e përgjithshme të normave të interesit në letrat me vlerë krahasuar me periudhën para vitit 2016.

Figura 31. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, sipas maturitetit



4.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve


Zhvillimet në treguesit ekonomik dhe financiarë të ndërmarrjeve sugjerojnë për performancë pozitive të sektorit të ndërmarrjeve. Qarkullimi më i lartë nga sektori i industrisë dhe tregtisë me pakicë, që përbëjnë dy sektorët ekonomik me pjesëmarrjen më të lartë në qarkullimin e gjithsej ndërmarrjeve, si dhe kontributi i rritur në vlerën e shtuar nga prodhimi nga sektorët tjerë ekonomik, sugjerojnë që performanca financiare e ndërmarrjeve vendore ka qenë më e favorshme. Indeksi i peshuar i qarkullimit industrial, që paraqet ecurinë e qarkullimit të ndërmarrjeve në katër sektorë të industrisë, është karakterizuar me rritje duke qëndruar në pikën më të lartë që nga viti bazë 2012 (figura 32). Po ashtu, qarkullimi në shumicën e sektorëve të tregtisë me pakicë ka shënuar

rritje (figura 33). Pothuajse të gjithë sektorët tjerë ekonomik kanë shënuar kontribut pozitiv në rritjen vjetore të vlerës së shtuar nga prodhimi i ndërmarrjeve. Kontributi nga sektori i agrikulturës, megjithëse pozitiv, ishte më i ulët se vitin paraprak. Ndërsa kontributi nga sektorët e tjerë me pjesëmarrje më të lartë në gjithsej vlerën e shtuar nga prodhimi, si tregtia me shumicë dhe pakicë, ndërtimtaria, dhe pasuritë e paluajtshme, është rritur ndjeshëm.

Numri i ndërmarrjeve qarkulluese si dhe vlera e qarkullimit të ndërmarrjeve të deklaruar në Administratën Tatimore të Kosovës ka shënuar rritje. Numri i ndërmarrjeve që deklarojnë qarkullim mbi zero është rritur në 39,506 në vitin 2017 nga 38,351 një vit më parë, si dhe qarkullimi i deklaruar për vitin 2017 është rritur në 10.2 miliardë euro nga 9.3 miliardë euro në vitin 2016. Në mesatare, qarkullimi për ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar qarkullim mbi zero është rritur. Megjithëse rritja e qarkullimit mund të reflektojë zhvillime tjera si rritje të formalitetit, një zhvillim i tillë mund të sugjerojë edhe për aktivitetet të shtuar nga sektori i ndërmarrjeve.


Performanca e përmirësuar e ndërmarrjeve sugjerohet edhe nga treguesi i klimës dhe ai i besueshmërisë së biznesit, të cilët u karakterizuan me vlera më të larta në vitin 2017 përkundër pasigurive politike si rezultat i zgjedhjeve lokale dhe qendrore si dhe vonesave në formimin e qeverisë.⁵ Treguesi i klimës së biznesit, i cili vlerëson situatën aktuale ekonomike (profitabilitetin) të biznesit dhe pritjet për periudhën e ardhshme gjashtëmujore, përgjithësisht ka shënuar vlera më të larta në vitin 2017 dhe ka treguar tendencë rritëse. Treguesi i besueshmërisë së biznesit, i cili ka karakter më të përgjithshëm vlerësues për gjendjen e biznesit për dallim nga treguesi paraprak që fokusohet vetëm në performancën financiare të biznesit, ka shënuar përmirësim të theksuar në vitin 2017 (figura 34). Besueshmëria e biznesit ka ndryshuar trendin rënës të vitit 2016, dhe ka shënuar vlera më të larta vjetore përgjatë katër tremujorëve. Në fund të vitit 2017, treguesi ka shënuar rritje, pas rënies në

Figura 32. Indeksi i qarkullimit industrial (2012=100)




Burimi: ASK (2018)

Figura 33. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë (2013=100)



Burimi: ASK (2018)

Figura 34. Indeksi i besueshmërisë së biznesit




Burimi: OEK (2018)

⁵ Treguesi i klimës së biznesit dhe ai i besueshmërisë së biznesit përpilohen nga Oda Ekonomike e Kosovës, si pjesë e studimit të rregullt tremujorë 'Klima e biznesit në Kosovë' i cili anketon bizneset në katër sektorë të ekonomisë: prodhim, ndërtim, shërbime dhe tregti.

tremujorin e tretë, gjë që sugjeron për optimizëm për aktivitetin ekonomik të sektorit në gjysmën e parë të vitit vijues.

Iniciativa ndërmarrëse ka shënuar rënie në vitin 2017, përkundër zhvillimeve pozitive makroekonomike si dhe lehtësimeve në procedura për fillimin e biznesit.⁶ Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara gjatë vitit 2017 ishte 9,223, që paraqet rënie vjetore prej 11.5 përqind (figura 35). Sektorët të cilët shënuan rënien më të lartë vjetore në numrin e bizneseve të regjistruara ishin prodhimi dhe tregtia me shumicë dhe pakicë, pasuar nga bujqësia. Në anën tjetër, numri i ndërmarrjeve të mbyllura gjatë kësaj periudhe ka shënuar rënie në 1,623 ndërmarrje të mbyllura nga 2,360 në vitin paraprak.

Figura 35. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2018)

Progresi i vazhdueshëm në reformat strukturore ka kontribuar në përmirësimin e faktorëve për qasje në financa për ndërmarrjet, por sfida të shumta vazhdojnë në mbesin në këtë rrafsh. Ligji për përmbauesit privat, i miratuar në vitin 2014, është amendamentuar në prill të vitit 2017 me qëllim të rritjes së efikasitetit të tij që pritet të reflektohet në përmirësime të mëtejme në zvogëlimin e rasteve gjyqësore dhe lehtësimin e realizimit të kolateralit. Qasja në kreditim, ndër tjera, është mbështetur edhe nga avancimet në Regjistrin e Kredive⁷, vendosja e pozicionit prioritar në procedura të falimentimit për kreditorët e siguruar, si dhe miratimi i kornizës ligjore për procedurat e falimentimit të korporatave. Sidoqoftë, pengesa të shumta mbesin në rrafshin rregullativ dhe institucional të cilat pengojnë performancën e biznesit dhe qasjen në financa. Niveli i lartë i informalitetit, zbatimi i dobët i kontratave, mungesa e të dhënave kadastrale, së bashku me mungesën e transparencës financiare dhe cilësinë e ulët të raportimit financiar, vazhdojnë të jenë pengesë në qasjen në financim për ndërmarrjet.⁸ Niveli i ekonomisë joformale vlerësohet të ketë shënuar rënie ndërmjet periudhës 2013 -2015, por që vazhdon të mbetet i lartë në 31.7 përqind të gjithsej BPV-së së vendit.⁹ Jo formaliteti i lartë dhe mungesa e kualitetit dhe transparencës, përveç që ndikon në kufizimin e mundësive të financimit për ndërmarrjet, ndikon edhe në kërkesat e larta për kolateral, me ç ‘rast indikator i gjithsej kredisë së sektorit bankar ndaj vlerës së kolateralit në dhjetor 2017 qëndronte afër 32 përqind.

Borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve financiare vendore dhe të jashtme ka vazhduar trendin rritës. Borxhi i brendshëm, përkatësisht borxhi ndaj sektorit bankar në vend është rritur për 11.1 përqind. Kreditë e ndërmarrjeve nga ndërmjetësit tjerë financiarë u dyfishuan, por që mbesin me peshë të vogël në gjithsej borxhin e ndërmarrjeve në më pak se 3 përqind. Borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve vazhdoi rritjen dhe arriti në 21.1 përqind të gjithsej borxhit (figura 36). Në dhjetor 2017, gjithsej borxhi i ndërmarrjeve shënoi rritje vjetore prej 11.7 përqind dhe arriti në 32.9 përqind të BPV-së së vendit.

⁶ Kosova ka shënuar progres të mëtejshëm në reforma rregullative në fushën e regjistrimit të bizneseve në periudhën qershor 2016 -qershor 2017, me ç ‘rast Banka Botërore, në Raportin e Lehtësisë së të Bërit Biznes 2018 ka renditur Kosovën në vendin e 10-të për lehtësinë në themelimin e biznesit nga gjithsej 190 shtete.

⁷ Në qershor 2017, u finalizua implementimi i projektit për avancimin e Regjistrimit të Kredive të Kosovës, i cili është plotësuar me informata të reja (normat e interesit, përqindja e mbuluar nga Fondi për Garanci Kreditorë, madhësia e biznesit, etj.), të cilat kontribuojnë, ndër tjerash, në zvogëlimin e asimetrisë së informacionit dhe përmirësimin në qasjen në financa.

⁸ Qeveria e Republikës së Kosovës (2017). *Programi për Reformë Ekonomike 2017*; Fondi Monetar Ndërkombëtar (2017). *Sfidat bankare në Ballkanin Perëndimor: Perspektivat dhe Sfidat, Nëntor 2017*.

⁹ Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (2017). *Vlerësimi i shkallës së ekonomisë joformale në Kosovë*, Nëntor 2017.


Rritja e kreditimit të ndërmarrjeve nga sektori bankar ka kontribuar në procesin e përafrimit të shkallës së ndërmjetësimit financiar të ndërmarrjeve drejt vendeve të rajonit. Raporti i kredisë së ndërmarrjeve nga bankat ndaj BPV-së arriti në 25.1 përqind në dhjetor 2017 (nga 23.4 përqind një vit më parë), por që ende vazhdon të mbetet nën potencialin e tij afatgjatë, siç sugjerohet nga hendeku negativ aktual i kreditimit ndaj BPV-së.¹⁰

Si rezultat i rritjes më të lartë të kreditimit, edhe neto pozicioni debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar shënoi rritje. Depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje më të përsheptuar vjetore dhe arritën në 581.5 milionë euro. Sidoqoftë, rritja e lartë e kreditimit për sektorin e ndërmarrjeve, që në dhjetor 2017 arriti vlerën 1,579.5 milionë euro¹¹, ndikoi që ndërmarrjet të zgjerojnë pozicionin e tyre debitor ndaj sektorit bankar. Në aspektin valutor, sektori i ndërmarrjeve ka pozicion neto kreditor ndaj sektorit bankar, si rezultat i nivelit më të lartë të depozitave në valutë krahasuar me kreditë. Sidoqoftë, pozicioni në valutë mbetet i ulët si rezultat i pjesëmarrjes së ulët të kredive dhe depozitave në valutë, në 0.1 përqind për kreditë në valutë ndaj gjithsej kredive, dhe 3.0 përqind për depozitat në valutë ndaj gjithsej depozitave.

Gatishmëria e sektorit bankar për të kredituar ndërmarrjet ka shënuar rritje të konsiderueshme në vitin 2017, me ç'rast kreditë e reja u rritën për 35 përqind, rritja më e lartë në shtatë vitet e fundit.¹² Sipas qëllimit, kreditë e reja ishin 59.6 përqind të destinuar për investime afatgjata, ndërsa pjesa tjetër prej 40.4 përqind u destinuan për financim të aktiviteteve jo-investive të ndërmarrjeve, ngjashëm me mesataren në tetë vitet e fundit. Në aspektin e marurimit, viti 2017 u karakterizua me tendencë të rritjes së kredive me maturitet më të gjatë, me ç'rast 23.8 përqind të kredive të reja ishin me maturitet 5 deri në 10 vjet. Kategoria dominuese e kredive vazhdon të jetë ajo me maturitet 2 deri në 5 vite me përfaqësim 45.6 përqind në gjithsej kreditë e reja për ndërmarrje.

Huamarrja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vitin 2017 është mbështetur edhe nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, shfrytëzimi i të cilit ka shënuar trend të vazhdueshëm të rritjes. FKGK, i cili synon rritjen e qasjes në financa për NMVM-të përmes garantimit të portfolios kreditorë të institucioneve financiare, filloi me garantimin e kredisë së parë për NMVM-të në shtator të vitit 2016. Në fund të vitit 2017, numri i kredive të bankave të garantuara nga FKGK ishte 785, shuma totale e të cilave arriti në mbi 30 milionë euro. Struktura e kredive të


Figura 36. Borxhi i ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2018)

Depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje më të përsheptuar vjetore dhe arritën në 581.5 milionë euro. Sidoqoftë, rritja e lartë e kreditimit për sektorin e ndërmarrjeve, që në dhjetor 2017 arriti vlerën 1,579.5 milionë euro¹¹, ndikoi që ndërmarrjet të zgjerojnë pozicionin e tyre debitor ndaj sektorit bankar. Në aspektin valutor, sektori i ndërmarrjeve ka pozicion neto kreditor ndaj sektorit bankar, si rezultat i nivelit më të lartë të depozitave në valutë krahasuar me kreditë. Sidoqoftë, pozicioni në valutë mbetet i ulët si rezultat i pjesëmarrjes së ulët të kredive dhe depozitave në valutë, në 0.1 përqind për kreditë në valutë ndaj gjithsej kredive, dhe 3.0 përqind për depozitat në valutë ndaj gjithsej depozitave.

Figura 37. Normat e interesit për ndërmarrjet



Burimi: BQK (2018)

¹⁰ Hendeku i kreditimit i kalkuluar me filterin Hodrick-Prescott.

¹¹ Përfshirë kreditë në valutë, të konvertuara në vlerë ekuivalente në euro.

¹² Statistikat për kreditë e reja janë dispozicion që nga vitit 2010.

garantuara është përfaqësim i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar, me ç'rast dominojnë kredite për sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, të pasuara nga sektori i shërbimeve dhe ai i prodhimit. Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë kishte përfaqësim prej 9 përqind në gjithsej portfolion e kredive të garantuara. Prospektet pozitive të zhvillimit të FKGGK-së, si në aspektin e rritjes së kapitalit dhe vlerës së garantuar të kredive, ashtu edhe në fokusimin në mbështetjen e sektorëve specifik me qasje më të vështirësuar në financa siç është sektori i bujqësisë, pritet të reflektohen në lehtësimin e kushteve të kreditimit dhe rritjen e mëtejme të kreditimit për NMVM-të në përgjithësi, dhe sektorë të caktuar në veçanti.


Kostoja e huamarrjes për sektorin e ndërmarrjeve ka vazhduar trendin rënës si rezultat i presioneve konkurruese dhe ambientit me norma të ulëta interesi që ka zbritur koston e financimit. Në fund të vitit 2017, norma mesatare e kredive të reja të sektorit bankar për ndërmarrjet ishte 6.47 përqind, për 0.4 pikë përqindje më poshtë se një vit më parë, ndërsa përgjysmë më e ulët se në vitin 2013 (figura 37). Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së portfolios kreditorë, progresi në reformat strukturore për zvogëlimin e rreziqeve në realizimin e kolateralit, qasja e mirë në financim si dhe presionet e vazhdueshme konkurruese pritet të ndikojnë në rënien e mëtejme të normave të interesit edhe në vitin në vijim.

4.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare

Borxhi i ekonomive familjare vazhdoi trendin rritës në vitin 2017. Borxhi i brendshëm ndaj sektorit bankar ka shënuar rritje prej 12.7 përqind, ndërsa borxhi ndaj institucioneve mikrofinanciare, që ka arritur në mbi 10 përqind të vlerës së borxhit ndaj sektorit bankar, është rritur për 26.8 përqind. Borxhi i jashtëm i ekonomive familjare u dyfishua dhe arriti në 6.7 përqind të gjithsej borxhit (figura 38). Në dhjetor 2017, gjithsej borxhi i ekonomive familjare është rritur për 15.6 përqind dhe shënoi 17.0 përqind të BPV-së së vendit.

Kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar për ekonomitë familjare vazhduan përsheptimin e rritjes, e cila ishte më e shprehur për kredite e reja për qëllime hipotekare të cilat rritën lehtësisht pjesëmarrjen në gjithsej kredite e reja. Gjithsej borxhi i ri ndaj bankave është rritur për 15 përqind krahas rritjes 10.8 përqind një vit më parë. Sipas qëllimit, rritja ishte më e theksuar për kredite e reja hipotekare, 28.1 përqind, përderisa kredite konsumuese shënuan rritje prej 14 përqind. Rritja më e lartë e kredive hipotekare ndikoi që pjesëmarrja e ulët e këtyre kredive në gjithsej kredite e reja për ekonomitë familjare të rritet në 17.7 përqind, rritje prej 1.8 pp. Maturiteti i kredive hipotekare gjithashtu ka shënuar tendencë pozitive të rritjes, me ç'rast dominuan dukshëm kredite me maturitet 5 deri në 10 vite si dhe shpejtuan rritjen kredite me maturitet mbi 10 vite. Kreditë e reja për ekonomitë familjare pritet të vazhdojnë rritjen në vitin vijues krahas pritjeve për rritje të kërkesës si dhe lehtësimit të kushteve dhe standardeve, si rritjes së shumës së aprovuar dhe rënies së normave të interesit.

Figura 38. Borxhi i ekonomive familjare



Burimi: BQK (2018)


Neto pozicioni kreditor i ekonomive familjare ndaj sektorit bankar shënoi rënie si rezultat i rritjes më të lartë të kreditimit në raport me rritjen e depozitave. Depozitat e ekonomive familjare arritën vlerën 2,170.7 milionë euro¹³, që paraqet rritje vjetore prej 2.3 përqind. Sidoqoftë, ritmi i rritjes së depozitave është ngadalësuar, duke rënë në nivelin më të ulët që nga operimi i sektorit (figura 39). Kreditë, në anën tjetër, vazhduan rritjen dyshifrore dhe arritën vlerën 900.8 milionë euro, duke ndikuar në ngushtimin për 4.0 përqind të pozicionit tradicionalisht kreditor që kanë ekonomitë familjare ndaj sektorit bankar. Sa i përket neto pozicionit në valutë, sektori i ekonomive familjare ka shënuar rritje të pozicionit të tij kreditor në valutë për 22.2 përqind, si rezultat i rritjes së depozitave në valutë për 1 pikë përqindje në 5.7 përqind të gjithsej depozitave, përderisa kreditimi në valutë mbetet në nivel të ngjashëm nën 0.4 përqind të gjithsej kredisë për ekonomitë familjare.

Kursimet e ekonomive familjare, në formë të depozitave të kursimeve dhe të afatizuara, kanë vazhduar rënien, në favor të rritjes së vazhdueshme të depozitave të transferueshme. Me rënien e normave të interesit në depozita në vitin 2014, me ç'rast norma e interesit në depozita të kursimit u përgjysmua ndërsa ajo në depozita të afatizuara u zvogëluar për 70 përqind (figura 40), kursimet e ekonomive familjare filluan rënien, duke lëvizur në llogari të transferueshme. Kjo për faktin se normat e ulëta të interesit rritën koston oportune të mbajtjes së kursimeve dhe afatizimit të mjeteve, ndaj dhe dekurajuan kursimin. Sa i përket vitit 2017, depozitat e kursimit shënuan rënie vjetore prej 8.9 përqind, ndërsa norma e interesit zbriti në 0.26 nga 0.28 përqind. Ndërsa depozitat e afatizuara shënuan rritje pas katër viteve rënie, përkundër ndryshimit të vogël të normës së interesit në 0.93 nga 0.91 përqind.

Kostoja e borxhit të ri të ekonomive familjare vazhdoi rënien, të ndikuar nga presionet konkurruese si dhe kushtet e favorshme të financimit. Rënia ishte lehtësisht më e theksuar në kreditë hipotekare të cilat në mesatare gjatë vitit 2017 kishin normë interesi 5.9 përqind, 0.6pp më ulët se në vitin paraprak. Kreditë konsumuese shënuan normë mesatare interesi 7.7 përqind, 0.54pp rënie vjetore. Normat e interesit për ekonomitë familjare pritet të vazhdojnë rënien, kryesisht ato hipotekare, të ndikuara nga faktorët e lartë cekur si dhe nga prospektet pozitive të rritjes ekonomike dhe nivelit të ulët të kredive jo performuese, gjë që sugjerohet edhe nga anketa e kreditimit bankar.


Burimet e të ardhurave të ekonomive familjare treguan tendencë rritëse, si rezultat i kushteve më të favorshme në tregjet e jashtme të punës si dhe përmirësimit të lehtë të kushteve në tregun e

Figura 39. Depozitat e ekonomive familjare



Burimi: BQK (2018)

Figura 40. Normat e interesit për ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2018)

¹³ Përfshirë depozitat në valutë, të konvertuara në vlerë ekuivalente në euro.

brendshëm të punës. Niveli i pagave për periudhën 2012-2016, sipas ASK-së, ka shënuar rritje si në sektorin publik ashtu edhe atë privat, ku në mesatare paga neto është ngritur nga 384 euro në vitin 2012 në 457 euro në 2016. Për vitin 2017, paga mujore neto e të punësuarve, sipas Anketës së Fuqisë Punëtore, në mesatare vazhdoi të qëndrojë në intervalin 400 deri në 500 euro. Burimet tjera të rëndësishme të të ardhurave të ekonomive familjare shënuan gjithashtu rritje në vitin 2017. Remitancat u rritën për 9.9 përqind, ndërsa kompensimi i punëtorëve¹⁴ shënoi rritje vjetore prej 11.9 përqind. Zhvillimet e favorshme në BPV-në e vendit kanë ndikuar në rritjen e lehtë të punësimit në 29.8 përqind të popullsisë në moshë pune, rritje 1.8 pp, por që kjo rritje nuk u reflektua në reduktimin e normës së papunësisë si rezultat i rritjes për 4.1pp të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore që në dhjetor 2017 arriti në 42.8 përqind. Shkalla e papunësisë në dhjetor 2017 ishte 30.5 përqind, rritje vjetore për 3.0pp.

Tabela 2. Treguesit e borxhit ndaj bankave dhe performancës së ekonomive familjare

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Borxhi i ekonomive familjare ndaj bankave (në milionë)	434.17	514.60	546.34	567.74	638.98	697.66	799.47	900.80
prej të cilave në valutë	-	3.7	3.78	3.88	3.71	3.4	2.93	3.00
Depozitat e ekonomive familjare ne banka (në milionë)	1,299.35	1,490.47	1,640.14	1,774.96	1,774.96	1,965.80	2,122.26	2,170.67
prej të cilave në valutë	93.9	117.04	104.72	116.17	97.23	102.19	100.8	122.58
Neto pozicioni ndaj bankave (Pozicioni kreditor) në milionë	865.18	975.87	1,093.80	1,207.22	1,209.33	1,268.13	1,322.79	1,269.86
Raporti i borxhit ndaj të hyrave								30% *
Mesatarja e vlerës së kredisë për të punësuar			1,804.30	1,677.70	1,975.20	2,349.50	2,409.50	2,522.10
Shkalla e varësisë ekonomike					266%	301%	274%	250%
Përballueshmëria e shpenzimeve			48.0%	44%	42%	43%	45%	43%

Burimi: BQK (2018)

*Vlerësim i përafërt. Treguesi i borxhit ndaj të ardhurave të ekonomisë familjare do të raportohet në mënyrë të rregullt dhe me metodologji konsistente nga bankat duke filluar nga viti 2018, ndaj dhe do të ofrojë informacion të krahasueshëm për analizë të trendit të këtij treguesi

Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare, e matur përmes treguesit të borxhit ndaj të ardhurave neto, në dhjetor 2017 ishte rreth 30 përqind.¹⁵ Sidoqoftë, ky tregues nuk paraqet ngarkesën e plotë të borxhit meqë konsideron vetëm borxhin nga një institucion bankar, duke mos konsideruar huamarrjen e shumëfishtë në banka si dhe nga institucionet tjera financiare, si dhe borxhin e jashtëm. Treguesi i mundshëm i ngarkesës së buxhetit të ekonomive familjare, përkatësisht të punësuarve, është shkalla e varësisë ekonomike, që paraqet numrin mesatar të personave të moshës mbi 15 vjeç (popullsia joaktive) që ‘përkrahë’ secili i punësuar. Në vitin 2017, ky tregues shënoi përmirësim të lehtë në 250 përqind nga 274 përqind në vitin 2016.¹⁶ Gjithashtu, përafrues i matjes së ngarkesës me borxh të ekonomive familjare mund të konsiderohet edhe treguesi i përballueshmërisë së shpenzimeve nga ASK. Ky tregues vlerëson kapacitetin e ekonomive familjare për të paguar në kohë pagesat e rregullta mujore si qiraja, kreditë, tatimet, shpenzimet komunale, etj. Nga 45 përqind e ekonomive familjare që dy ose më shumë herë nuk kanë mundur t’i bëjnë në kohë këto pagesa në vitin 2016, ky raport ka shënuar përmirësim të lehtë në 43 përqind në vitin 2017.

¹⁴ Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve - të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit si dhe punëtorëve kosovarë jashtë kufirit për një periudhë më pak se një vit.


¹⁵ Treguesi i borxhit ndaj të ardhurave të ekonomisë familjare do të raportohet në mënyrë të rregullt dhe me metodologji konsistente nga bankat duke filluar nga viti 2018, ndaj dhe do të ofrojë informacion të krahasueshëm për analizë të trendit të këtij treguesi.

¹⁶ Sipas ASK, shkalla projektuar e varësisë ekonomike në BE do të rritet në 122.2 përqind në vitin 2023.

5. Zhvillimet në sistemin financiar

Sistemi financiar vazhdoi trendin rritës edhe gjatë vitit 2017, ku sektori bankar dhe ai pensional zgjeruan aktivitetin konsiderueshëm. Të gjithë sektorët përbërës të sistemit financiar rritën asetet e tyre në periudhën raportuese duke arritur vlerë prej 5.91 miliardë euro dhe rritje vjetore prej 9.7 përqind. Zhvillimet pozitive të sistemit financiar kontribuan në shtrirje më të madhe të qasjes në shërbime financiare nga ana e publikut, e që gjithashtu sugjeron rritje të presioneve të konkurrencës në treg për financim dhe ofrim të shërbimeve financiare. Shkalla e ndërmjetësimit financiar, e shprehur si raport i aseteve të sistemit financiar ndaj BPV-së është rritur për 5.3 pikë përqindje, duke arritur në 94.0 përqind. Vlerësimi i ndërmjetësimit financiar për segmentet përbërëse të sistemit financiar tregon për rritje të ndërmjetësimit veçanërisht për sektorin bankar, pensional dhe atë mikrofinanciar (figura 41). Mbështetur në prospektet pozitive për aktivitetin ekonomik në vend, rajon dhe eurozonë, si dhe pritjet optimiste të dala nga Anketa e Kreditimit Bankar, trend i ngjashëm i rritjes së ndërmjetësimit financiar pritet të vazhdojë edhe përgjatë vitit 2018.

Figura 41. Pësia e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së




Burimi: BQK (2018)

Në aspektin e treguesve të shëndetit financiar, sistemi financiar u karakterizua nga nivele të larta të kapitalizimit, fitimit dhe likuiditetit.

Rritja e aseteve të sektorit bankar dhe mikrofinanciar kryesisht i atribuohet gatishmërisë së këtyre dy sektorëve në zgjerimin e aktivitetit të tyre kreditor, të mbështetur nga përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së kredive, rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i qasjes në financim. Rritja e aseteve të sektorit pensional u mundësua nga rritja e investimeve në tregjet e huaja, mbështetur nga performanca e qëndrueshme

Figura 42. Pjesëmarrja në gjithsej asetet e sistemit financiar



Burimi: BQK (2018)

e tyre dhe kthimi pozitiv financiar. Asetet e sektorit të sigurimeve po ashtu vazhduan trend pozitiv të rritjes si rezultat i rritjes së primeve bruto të shkruara si dhe rritjes së të hyrave dhe menaxhimit efikas të shpenzimeve.

Struktura e sistemit financiar nuk ka pësuar ndonjë lëvizje të theksuar gjatë periudhës raportuese. Megjithëse sektori bankar dominon asetet e sistemit financiar, pjesëmarrja e tij u zvogëlua përderisa pjesëmarrja e sektorit pensional shënoi rritje (figura 42). Numri i institucioneve financiare në vend ka mbetë pothuajse i pandryshuar, ku numri i institucioneve financiare jo-bankare bën përjashtim me shtimin e dy institucioneve mikrofinanciare dhe 4 ndihmësve financiar gjatë vitit 2017 (tabela 3).

Tabela 3. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Bankat komerciale	8	8	9	9	10	10	10	10
Kompanitë e sigurimeve	12	13	13	13	14	15	15	15
Fondet pensionale	2	2	2	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	28	34	38	39	42	44	48	52
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare	17	20	17	17	18	18	16	18

Burimi: BQK (2018)

Kapitali i huaj mbizotëron në pjesën më të madhe të segmenteve të sistemit financiar. Sektori bankar, mikrofinanciar dhe ai i sigurimeve kanë pjesëmarrje të lartë të kapitalit të huaj, përderisa sektori pensional pothuajse gjithë financimin e ka të mbështetur tek kontributet vendore (figura 43).

Institucione me origjinë nga vendet e BE-së kryesisht investuan në sektorin bankar në Kosovë, përderisa vendet e rajonit dhe veçanërisht Shqipëria, drejtuan investimet kryesisht nga sektori i sigurimeve.


Grupet bankare nga BE kanë pjesëmarrjen më të madhe në sektorin bankar në Kosovë, mirëpo edhe bankat nga vendet tjera gradualisht po rrisin prezencën e tyre. Bankat me origjinë nga vendet e BE përbëjnë 61.0 përqind të aseteve të sektorit bankar. Me një qasje më pro aktive me qëllim të depërtimit në treg, bankat me origjinë nga Turqia gradualisht rritën prezencën e tyre në 16.5 përqind të aseteve të sektorit dhe njëkohësisht ndikuan edhe në uljen e koncentrimin dhe rritjen e konkurrencës në këtë sektor. Shprehur si raport i aseteve të tri bankave më të mëdha ndaj gjithsej aseteve të sektorit, shkalla e koncentrimin bankar zbriti në 61.0 krahasuar me vitin 2010 kur kishte një shkallë të koncentrimin prej 77.8 përqind.

Sektori i sigurimeve pësoi ndryshime të theksuara në pronësi ndër vite ku ky sektor dominohet nga kompanitë vendore, pasuar nga kompanitë me origjinë nga Shqipëria. Kompanitë vendore të sigurimit përbëjnë 45.7 përqind nga 37.8 përqind në vitin paraprak dhe krahasuar me vitin 2010 kur pjesëmarrja ishte 25.2 përqind. Ndërsa, kompanitë nga Shqipëria përfaqësojnë 24.8 përqind të aseteve të sektorit të sigurimeve.

5.1. Aktiviteti bankar

Veprimtaria e sektorit bankar gjatë vitit 2017 u zgjerua më tutje e nxitur nga oferta kreditore. Asetet e sektorit bankar ishin për 6.4 përqind më të larta për dallim nga viti paraprak dhe arritën vlerën prej 3.87 miliardë euro. Ecuria e aktivitetit të sektorit në anën e aseteve u përcaktua nga rritja e aktivitetit kreditues (figura 44), i mbështetur nga oferta e lehtësuar nga ana e bankave si rezultat i rritjes së favorshme dhe të qëndrueshme të financimit, përkatësisht rritjen e depozitave të klientëve. Në kuadër të aseteve, rritje vjetore prej 12.0 përqind shënuan rezervat e bankave të mbajtura në BQK, përkundër vazhdimin të normës negative të interesit të aplikuar nga BQK mbi tepicën e rezervës obligative që bankat komerciale mbajnë në BQK. Investimet në letrat me vlerë u tkurrën për herë të parë në nëntë vitet e fundit, duke shënuar rënie vjetore për 4.7 përqind.

Figura 43. Pronësia e segmentëve përbërës të sistemit financiar, dhjetor 2017



Burimi: BQK (2018)

Investimet në instrumentet financiare ndërkombëtare u zvogëluan për 10.2 përqind, ndërsa investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës shënuan ngadalësim të rritjes në 1.7 përqind nga 5.7 përqind një vit më parë. Kjo ecuri i atribuohet deri në një masë normave të ulëta të interesit në letrat me vlerë e emetuara nga Qeveria e Kosovës, njëkohësisht edhe ambientin me kthim modest në tregjet financiare ndërkombëtare. Në kushtet e një ambienti me norma të ulëta në tregjet financiare, investimi i depozitave në aktivitetin kreditues mbetet alternativë më profitabile për sektorin bankar, gjë që rithekson një model tradicional bankar në vend dhe jap indikacion për rritje të mëtejme të aktivitetit kreditues në periudhat në vazhdim.

Rritja më e lartë e aktivitetit nga bankat vendore si dhe bankat e reja në treg kanë ndikuar në rënien e shkallës së koncentrimit në sektorin bankar. Raport i aseteve të tri bankave më të mëdha ndaj gjithsej aseteve të sektorit zbriti në 61.0 përqind nga 62.7 përqind sa ishte një vit më parë. Rënia e shkallës së koncentrimit të tregut mund të vërehet edhe përmes rënies së vazhdueshme të Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), që tregon për rënie të koncentrimit në asete, kredi, dhe depozita (figura 45). Qasja më pro aktive e bankave të reja në treg dhe atyre me peshë më të vogël dhe rritja dyshifrore e aktivitetit kreditues që i karakterizoi në tetë vitet e fundit është reflektuar në rritje të pjesëmarrjes së tyre në rreth 16 përqind, nga rreth 11 përqind sa ishin në vitin 2010. Përderisa, kahje të kundërt të pjesëmarrjes në kreditim patën tre grupet bankare të cilat dominojnë tregun mirëpo pesha e tyre në kreditim zbriti në 59.7 përqind nga 75.8 në vitin 2010.

Aktiviteti i sektorit bankar vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve (80.0 përqind). Në vitin 2017 depozitat u rritën për 6.8 përqind më shumë se vitin paraprak, dhe arritën nivelin prej 3.09 miliardë euro. Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritjen më të ulët të regjistruar që nga fillimi i operimit në vend prej 2.8 përqind, që mund të jetë dekurajim i ekonomive familjare për të investuar në këtë instrument si rezultat i normave mjaft të ulëta të interesit për depozita (1.0 përqind). Kjo mund të ketë ndikuar edhe në ecurinë e depozitave të reja të arkëtuara prej ekonomive familjare (figura 46).

Figura 44. Pjesëmarrja në strukturën e aseteve




Figura 45. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake





Figura 46. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja, në milionë euro



Depozitat e ndërmarrjeve ishin për 13.8 përqind më të larta krahas vitit të kaluar. Rritje më të theksuar shënuan depozitat e transferueshme, mirëpo për dallim nga ekonomitë familjare, rritje shënuan edhe depozitat e kursimit të ndërmarrjeve. Norma mesatare e interesit për ndërmarrjet është më e lartë për 1.7 përqind, kundrejt atyre për ekonomitë familjare që kishin një normë prej 1.0 përqind.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm ka shënuar rënie, të ndikuar kryesisht nga rënia e depozitave në bankat e jashtme si dhe nga rënia e investime në letra me vlerë. Pozicioni neto kreditor ndaj jorezidentëve u zvogëlua për 28.6 përqind, duke zbritur në 311.5 milionë euro (figura 47 dhe 48). Kërkesat ndaj jorezidentëve zënë rreth 8.0 përqind të gjithëj aseteve të sektorit bankar, ku pjesa dërrmuese e tyre janë të investuara në letra me vlerë dhe të mbajtura si depozita, që së bashku përfaqësojnë rreth 86.1 përqind të gjithëj kërkesës së jashtme.


Në anën tjetër, detyrimet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve zënë 5.8 përqind të gjithëj detyrimeve të sektorit bankar dhe kryesisht përbëhen nga depozitat e jorezidentëve që mbahen në bankat vendore, dhe linjat kreditore të shfrytëzuara nga bankat, që së bashku përbëjnë 98.9 përqind të gjithëj detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm. Sektori bankar, në përgjithësi, ka ekspozim të ulët me jorezidentët si në kuadër të kërkesës së jashtme ashtu edhe të detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm. Për më tepër, sektori bankar ka nivel mjaftë të ulët të ekspozimit në valutë të huaj, që eviton humbjet e mundshme nga ndryshimet në kursin e këmbimit kundrejt valutës euro.

5.1.1 Zhvillimet kreditore

Aktiviteti i rritur kreditues ka mbetur përcaktues kryesor në rritjen e përgjithshme të aseteve të sistemit financiar. Stoku i kredive aktive në bankat e vendit arriti në 2.49 miliardë euro, që paraqet rritje prej 11.5 përqind (figura 49). Rritja e kreditimit gjatë viti 2017, mbështetur kryesisht nga pozita e favorshme e likuiditetit të sektorit, u nxit kryesisht nga oferta e lehtësuar kundrejt të dy sektorëve të ekonomisë (ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve).


Të dhënat tregojnë se bankat u fokusuan kryesisht në kreditimin e ndërmarrjeve, konfirmuar edhe nga vlerësimet e Anketës së Kreditimit Bankar (Kutia 2), përmes përmirësimit të kushteve të

Figura 47. Pozicioni neto ndaj jorezidentëve




Burimi: BQK (2018)

Figura 48. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktivitetit me jorezidentët



Burimi: BQK (2018)

Figura 49. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2018)

kreditimit si uljen e normave të interesit në kredi, rritjen e maturitetin dhe shumës së aprovuar si dhe lehtësime në kolateralin e kërkuar. Kreditë për ndërmarrjet u rritën për 10.7 përqind dhe arritën në 1.6 miliardë euro. Në vitin 2017, kreditë e reja për ndërmarrje u shtuan për 200.6 milionë euro dhe arritën në 778.5 milionë euro (figura 50). Për më tepër, kreditë investuese u rritën për 108.9 milionë euro, në 427.9 milionë euro, pasuar nga ato me karakter jo-investues, të cilat u rritën për 75.2 milionë euro, në 290.1 milionë euro. Rritja e theksuar e financimit të projekteve investive për ndërmarrjet (mbi 50 përqind e kredive të reja) është reflektuar në treguesit ekonomik dhe financiarë të ndërmarrjeve, të cilët sugjerojnë për performancë pozitive të këtij sektori.

Sektorët kyç të ekonomisë kanë rrit financimin përmes kredive bankare.

Rritje të gjithsej kreditimit kishte për sektorin e bujqësisë, prodhimit, ndërtimtarisë e tregtisë. Kreditimi i sektorit të bujqësisë u rimëkëmb pas trendit rënës në vitin paraprak duke shënuar rritje prej 13.4 përqind, e që mund t'i atribuohet lehtësimeve për këtë sektor nga funksionalizimi i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Sektori i ndërtimtarisë shënoi rritjen më të lartë gjatë vitit prej 26.1 përqind, rritje kjo e cila mund t'i atribuohet deri në një masë aktivitetit të shtuar si rezultat i ndërtimit të autostradës “Arbën Xhaferi” (Rrugës 6), që pritet të përfundojë në vitin 2018. Sektori i prodhimit dhe ai i tregtisë shënuan rritje prej 9.3 përqind përkatësisht 6.0 përqind. Rritja e kreditimit të sektorëve kyç ekonomik është në linjë me kontributin pozitiv që sektorët përkatës dhanë në rritjen e vlerës së shtuar në BPV-në në vend.

Kreditë për ekonomitë familjare, të cilat në vitet e fundit kanë rritur peshën në strukturën e gjithsej stokut të kredive (rreth 36 përqind), për të katërtin vit me radhë shënuan rritje të konsiderueshme. Në fund të vitit 2017, vlera e kredive të destinuara për ekonomitë familjare arriti në 897.8 milionë euro, apo për 12.7 përqind më e lartë krahasuar me vitin paraprak. Rritja e kreditimit në nivel të tillë është mbështetur nga zgjerimi i kredisë së re, kryesisht për konsum dhe për blerje të shtëpive. Vlera e kredisë së re tejkaloi gjysmë miliardë euro (figura 50). Pjesa më e madhe e kredisë së re ishte e destinuar për konsum (71.9 përqind) dhe blerje të shtëpive (17.7 përqind). Këto zhvillime në kuadër të kredive për ekonomitë familjare mund të jenë ndikuar nga kushtet dhe rregullat e lehtësuara kundrejt qasjes në kredi, përmes ofrimit të normave më të favorshme të interesit (veçanërisht për kreditë hipotekare) dhe rritjes së shumës së aprovuar, lehtësimeve në kërkesën për kolateral si dhe zgjatje të aftit të maturitetit.

Sipas afatit të maturitetit, kredia me maturitet afatmesëm dominon strukturën e gjithsej kredive (42.3 përqind), por që në vitet e fundit ka zvogëluar peshën e saj në gjithsej kreditë,

Figura 50. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në milionë euro






Figura 51. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë: ndërmarrjet



kundrejt rritjes së përshpejtuar të kredisë me maturitet afatgjatë (figura 51 dhe 52).¹⁷ Kredia me maturitet afatgjatë shënoi rritje prej 28.9 përqind dhe për herë të parë arriti vlerën mbi një miliardë euro (1.04 miliardë euro), pasuar nga ato me maturitet afatshkurtër, që u rritën për 10.3 përqind dhe arritën vlerën në 1.05 miliardë euro. Kreditë me afat të mesëm maturiteti (prej 1 vit deri në 5 vite) janë më të theksuara për ndërmarrjet (figura 51), kurse për ekonomitë familjare në vitet e fundit gradualisht kjo kategori ka zvogëluar pjesëmarrjen (figura 52). Sipas Anketës së Kreditimit Bankar (kutia 2), orientimi i ekonomive familjare drejt kredive afatgjata kryesisht u nxit nga politikat kreditore të bankave, shtyrë dhe nga konkurrenca, përmes lehtësimeve të aplikuara në kreditë për blerjen e shtëpive, kreditë investuese të ndërmarrjeve, por dhe kredive afatgjata në përgjithësi. Struktura e tillë e kreditimit në ekonomi përkon në njërin anë me nevojat e financimit për ndërmarrjet për likuiditet në përmbushjen e detyrimeve afatshkurtra dhe afatmesme afariste, dhe në anën tjetër nevojave për financim të investimeve afatgjata si nevoja për financim të banimit për ekonomitë familjare.

Figura 52. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë: ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2018)

Kutia 2. Anketa e Kreditimit Bankar¹⁸

Rezultatet e fundit të Anketës së Kreditimit Bankar¹⁹ pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës shtator 2017 – shkurt 2018 (referuar si P1 2018)²⁰, si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën mars - gusht 2018 (referuar si P2 2018).

Dinamika e aktivitetit kreditues për **ndërmarrjet** gjatë kësaj periudhe, sipas anketës së kreditimit bankar, rezulton të jetë ndikuar pozitivisht nga ana e ofertës kreditore.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë lehtësuar deri në një masë standardet e aplikuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, standardet kreditore për NVM-të u lehtësuan përderisa standardet për ndërmarrjet e mëdha mbetën pothuajse të pandryshuara.

Për periudhën mars - gusht 2018, bankat deklaruan që presin lehtësim të mëtejshëm të standardeve kreditore për NVM-të. Për ndërmarrjet e mëdha po ashtu pritjet lehtësim mirëpo në një masë më të vogël (figura 53).

Faktori kryesor, i deklaruar nga bankat, që ndikoi në lehtësimin e standardeve kreditore ishte rritja e konkurrencës në tregun kreditor në vend, përmirësimi i cilësisë së kredive dhe qasja e favorshme në financim i bankave, sidomos financimi brendshëm nga depozitat.


¹⁷ Periudha afatshkurtër përfshinë maturitetin deri në 1 vit, afatmesme përfshinë maturitetin prej 1 deri në 5 vite, dhe periudha afatgjatë përfshinë maturitetin mbi 5 vite.

¹⁸ Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me bankat që operojnë në Kosovë. Anketa realizohet dy herë në vit, duke përfshirë periudhën mars – gusht dhe periudhën shtator – shkurt.

¹⁹ Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatëse të çdo banke në gjithsej portfolion kreditore të sektorit bankar. Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie.

²⁰ Periudhës shtator – shkurt të cilto vit i referohemi si 'periudha e parë' – P1, ndërsa periudhës mars – gusht të cilto vit i referohemi si 'periudha e dytë' – P2.

Figura 53. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve




Burimi: BQK (2018)

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat po ashtu raportuan të kenë lehtësuar kushtet dhe rregullat e kreditimit për ndërmarrjet. Për NVM-të, bankat lehtësuan kushtet e kreditimit përmes uljes së normës mesatare të interesit, zgjatjes së maturitetit të kredive të aprovuara, zvogëlimit të kërkesës për kolateral, rritjes së madhësisë së kredive të aprovuara dhe uljes së ngarkesave tjera përveç interesit. Po ashtu, për kreditë e ndërmarrjeve të mëdha, bankat deklaruan të kenë ulur normën e interesit, zgjatur maturitetin e kredive të aprovuara, zvogëluar deri në një masë ngarkesat tjera përveç normës së interesit dhe rritur madhësinë e shumës së kredive të aprovuara (figura 54).

Për periudhën mars - gusht 2018, bankat presin lehtësim të kushteve në përgjithësi, përveç shtrëngim të lehtë në një prej kushteve të kreditimit për të dy kategoritë e ndërmarrjeve. Më konkretisht, si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha bankat deklaruan rritje të ngarkesave të tjera përveç normës së interesit. Gjithsesi, norma mesatare e interesit në kredi për të dy kategoritë pritet të vazhdoj trendin rënës, po ashtu madhësia e shumës së kredive të aprovuara pritet të rritet për të dy kategoritë.

Figura 54. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve




*Vizat e ndërprera paraqesin vlerën e pritur respektive për periudhën mars - gusht 2018 (P2 2018)
Burimi: BQK (2018)

Gjatë periudhës raportuese, bankat deklaruan rënie të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet. Indeksi i cili tregon kërkesën për kredi ishte i ngjashëm si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha, i cili tregoi rënie të kërkesës për kredive nga të dy kategoritë (figura 55).

Në kuadër të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, pati rënie të kërkesë për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, ndërsa për financimin e investimeve fikse kishte rritje të kërkesës.

Figura 55. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK (2018)


Për periudhën mars - gusht 2018, bankat presin përmirësim të kërkesës për kredi, përdërisa deklaruan që presin rritje të theksuar të kërkesës për kredi si nga ana e NVM-ve ashtu edhe nga ndërmarrjet e mëdha.

Në kuadër të kërkesës për kredi, bankat raportuan për përmirësim të ngjashëm të cilësisë së aplikacioneve të pranuar si nga ndërmarrjet e mëdha ashtu edhe nga NVM-të.

Dinamikat e aktivitetit kreditues për **ekonomitë familjare** gjatë periudhës raportuese nuk u reflektuan në masë të madhe në rezultatet e kësaj ankete, ku standardet kreditore mbeten pothuajse të pandryshuara ndërsa kërkesa për kredi kishte rënie të theksuar për njërën kategori. Konkretisht, standarde kreditore të pandryshuara u aplikuan për kreditë konsumuese njëjtë edhe për kreditë për blerjen e shtëpive (figura 56).

Bankat presin ecuri të ngjashme të standardeve kreditore edhe në gjashtë muajt e ardhshëm (mars - gusht 2018) ku lehtësim në masë të vogël pritet të ketë për kreditë për blerjen e shtëpive dhe për kreditë konsumuese.


Figura 56. Standardet kreditore të aplikuar në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2018)

Përmirësimi i kushteve të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese për blerjen e shtëpive u realizua përmes uljes së normës së interesit, rritjes së madhësisë së kredive të aprovuara dhe uljes së kërkesës për kolateral (figura 57). Kushtet për kreditë konsumuese kryesisht u përmirësuan përmes uljes së normës mesatare të interesit mirëpo në një masë më të ulët se sa për kreditë për blerjen e shtëpive, po ashtu bankat rritën madhësinë e shumës së aprovuar të kredive dhe ulën kërkesës për kolateral.


Figura 57. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare



*Vizat e ndërprera paraqesin vlerën e pritur respektive për periudhën mars - gusht 2018 (P2 2018)
Burimi: BQK (2018)

Në gjashtë muajt e ardhshëm, bankat kanë deklaruar se presin që kushtet e kreditimit përgjithësisht të lehtësohen për ekonomitë familjare për të dy kategoritë, veçanërisht për kreditë për blerjen e shtëpive ulja e normës së interesit do të jetë më e madhe se sa për kreditë konsumuese. Po ashtu bankat pritet të rrisin madhësinë e kredive të aprovuara për të dy kategoritë. Ndërsa, ngarkesat tjera përveç normës së interesit pritet të rriten për të dy kategoritë.

Figura 58. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2018)

Bankat raportuan rënie të theksuar të kërkesës për kredi konsumuese, po ashtu kërkesa për kredi për blerjen e shtëpive kishte rënie të lehtë (figura 58). Rënia e kërkesës nga ekonomitë familjare për kreditë konsumuese i atribuohet kërkesës së rënë për financimin e shpenzimeve tjera përveç blerjes së shtëpive dhe besueshmërisë së konsumatorëve e cila mbeti pothuajse e pandryshuar. Përderisa, bankat deklaruan se zhvillimet pozitive në tregun e pasurive të paluajtshme ndikuan në rritje të kërkesës për blerjen e shtëpive. Gjithashtu, cilësia e aplikacioneve të pranuar, për kredi për blerje të shtëpive, rezultoi të jetë përmirësuar.

Për periudhën mars - gusht 2018, bankat presin rritje të kërkesës për kredi për blerjen e shtëpive, ndërsa kërkesë të pandryshuar për kreditë konsumuese.

Sa i përket afatit kohor, si kreditë afatshkurtra ashtu edhe kreditë afatgjata kanë qenë të pandikuara nga ana e ofertës kreditore ku për kreditë e të dy afateve kohore bankat deklaruan standarde kreditore pothuajse të pandryshuara. Përderisa, kërkesa si për kreditë afatshkurtra ashtu edhe për kreditë afatgjata pati rënie. Këto rezultate janë në linjë me ecuritë e kërkesës për kredi.

Bankat deklaruan për rritje të gjithsej financimit në periudhën raportuese, më saktësisht si burim kryesor të financimit i deklaruan depozitat, e veçanërisht depozitat afatshkurtra nga ekonomitë familjare. Ngjashëm, bankat presin rritje të qasjes në financim përmes depozitave të ekonomive familjare, mirëpo në gjashtë muajt e ardhshëm nga depozitat afatgjata.

6. Rreziqet e sektorit bankar

Sektori bankar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017 ka operuar në një ambient përgjithësisht të favorshëm, me rreziqe të ulëta dhe kapacitet të kënaqshëm për përballimin e goditjeve të mundshme. Me qëllim të matjes dhe vlerësimit të kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit, është ndërtuar indeksi i stabilitetit të sektorit bankar. Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas.²¹ Sipas indeksit të agreguar të rrezikut, sektori bankar në mesatare ka shënuar rënie të ekspozimit ndaj rrezikut krahasuar me vitin paraprak, ndikuar kryesisht nga dinamika e rrezikut kreditor. Po ashtu edhe rreziku i profitabilitetit dhe ai i kapitalit kontribuuan në rënie e rrezikut të sektorit, përderisa likuiditeti shënoi rritje të rrezikut krahasuar me vitin paraprak. Rritja e vazhdueshme e mospërputhjeve të afateve të maturimit si rezultat i zgjatjes së afateve të maturimit në anën e asetëve (kryesisht të kreditimit) dhe e rritjes së depozitave të transferueshme në anën e detyrimeve, ka ndikuar lehtësisht në rritjen e rrezikut të likuiditetit, gjë që jep indikacione që bankat duhet kujdesur për menaxhim adekuat të likuiditetit në të ardhmen. Përderisa indikatorët e tjerë japin sinjale për rënie rreziku, nuk duhet injoruar faktin se rritja e vazhdueshme e kreditimit në të ardhmen do ta ndikon adekuatshmërinë e kapitalit për shkak se do të rriten asetet me peshë rreziku. Për më tepër kapitali do të jetë edhe nën presionin e profitabilitetit në një ambient të rënies së vazhdueshme të normave të interesit në kredi, por që në një masë do të kompensohet nga efekti i rritjes së volumit të kreditimit.

Figura 59. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriterëve të rreziqeve










Figura 60. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar



²¹ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9

Tabela 4. Rreziqet e sektorit bankar

Rreziqet	Indikatorët	2014	2015	2016	2017	Kahja e rrezikut	Interpretimet
Rreziku Kreditor	Raporti i kredive joperformuese (KJP) ndaj gjithsej kredive (%)	8.3%	6.2%	4.9%	3.1%		Rreziku kreditor u zvogëlua edhe më tutje, si rezultat i rënies më të lartë të kredive joperformuese që u ndikua nga përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditorë dhe procesi i shlyerjeve të kredive të humbura nga bilancet e bankave. Poashtu rënia e stokut të KJP-ve ka ndikuar në rritjen e raportit të mbulueshmërisë me provizione.
	Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione (%)	114.4%	115.1%	127.6%	149.7%		
	Ekspozimet e mëdha kreditorë/Kapitalit i Klasit të parë (%)	97.1%	67.3%	69.5%	88.9%		
Rreziku i Profitabilitetit	Të hyrat neto nga interesi (në milion euro)	149.5	163.3	160.3	159.7		Profitabiliteti i sektorit bankar është nën presione të ambientit të normave të ulëta të interesit. Në rritjen e profitit këtë vit kanë ndikuar të hyrat neto nga jo-interesi. Përmirësimi i kualitetit kreditor ka ndikuar në zvogëlimin e nevojës për shpenzime të provizioneve, duke dhënë efekt favorizues në profitin e bankave. Mirëpo ky faktor konsiderohet me efekt afatshkurtër (one time effect). Megjithatë rritja e përsheptuar e kreditimit bankar ka potencial për ndikim më afatgjatë në profitabilitetin e bankave.
	Të hyrat neto nga jo-interesi (në milion euro)	16.2	47.5	17.7	41.7		
	Shpenzimet/Të hyrat	75.4%	60.3%	67.3%	64.6%		
	Kthimi Mesatar në Kapital (ROE)	22.5%	29.1%	19.7%	21.3%		
Rreziku i Tregut	Hendeku ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit (në milion euro)	795	1,740	1,538	1,735		Hendeku ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit është zgjeruar. Pjesëmarrja më e lartë e financimit afatshkurtër krahas investimeve afatgjata e rrit rrezikun ndaj rritjes së mundshme të normave të interesit në kuptimin e rifinancimit duke shkakuar në këtë situatë presione në të hyrat neto nga interesi.
	Pozicionet e hapura në valutë të huaja ndaj kapitalit të klasit të parë (%)	1.9%	1.9%	4.6%	1.2%		
Rreziku i Solvencës	Kapitali rregullator/Asetet me peshë rreziku (%)	17.8%	19.0%	17.8%	18.1%		Raporti i kapitalit rregullator shënoi rritje si rezultat i bazës së fortë të kapitalit në kushtet e nivelit të lartë të profitit të realizuar gjatë vitit dhe atij të bartur nga vitet paraprake.
	Kapitali i Klasit të parë/Asetet me peshë rreziku (%)	14.6%	16.6%	15.8%	16.2%		
	Ekuiteti/Asete	10.2%	11.7%	12.1%	12.6%		
Rreziku i Likuiditetit	Raporti kredi/depozita (%)	74.2%	74.7%	77.0%	80.3%		Indikatorët e likuiditetit tregojnë për pozitë të mirë financiare të sektorit bankar si dhe për potencial të zgjerimit të aktivitetit kreditor. Raporti i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra u zvogëlua si rezultat i rritjes së detyrimeve afatshkurtëra (ndikuar nga rritja e depozitave të transferueshme) dhe i rënies së asetëve likuide (ndikuar nga rritja e kreditimit afatgjatë).
	Raporti i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra (%)	43.6%	44.9%	41.5%	37.9%		
	Hendeku i Likuiditetit (në milion euro)	(0.0)	398.1	405.1	463.8		
		Rrezik në rritje	Rrezik i ulët	Rrezik mesatar			

Burimi: BQK (2018)

6.1. Rreziku kreditor


Cilësia e portfolios kreditore ka vazhduar përmirësimin, ndikuar nga procesi i shlyerjes së kredive joperformuese nga bilanci e bankave, si dhe nga faktorët tjerë ekonomik e strukturorë që kanë përmirësuar aftësinë paguese dhe mbledhëse të borxheve. Raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive të sektorit bankar u zvogëluar në 3.1 përqind nga 4.9 përqind në vitin 2016. Rënia e stokut të kredive jo performuese për 29.0 përqind dha efekt më të lartë në rënien e raportit të KJP-ve se sa rritja e stokut të kredive prej 11.5 përqind (figura 61). Në këtë mënyrë përmirësimi i kualitetit kreditor gjatë këtij viti erdhi kryesisht si rezultat i pastrimit të bilanceve të bankave nga kreditë jo performuese, proces ky i nxitur nga masat e ndërmarra në ndryshimin e rregullores së BQK-së, ku nga mesi i vitit 2017 u përcaktuan afatet specifike brenda të cilave bankat duhet të realizojnë procesin e shlyerjes nga bilanci, të kredive të klasifikuara në kategorinë 'humbje'.²²

Vetëm gjatë vitit 2017 vlera e kredive të shlyera ishte 27.4 milionë euro, që në terma absolut ka ndikuar në zvogëlimin e gjithsej kredive jo performuese për 24.6 përqind. Origjinimet e kredive jo performuese gjatë periudhës patën efekt rritës prej 16.7 përqind në gjithsej stokun e kredive jo performuese ndërsa kthimi i kredive të kategorizuara si jo performuese dhanë kontribut zbritës prej 22.8 përqind (figura 62).

Faktorë tjerë si rritja e aktivitetit ekonomik dhe përmirësimi i vazhdueshëm i faktorëve stukturorë kanë ndikuar gjithashtu në përmirësimin e cilësisë së portfolios kreditore(figura 62). Një pjesë e efektit të rënies së KJP-ve mund t'i atribuohet edhe faktorëve të tjerë si performanca e mirë financiare e sektorit të ndërmarrjeve²³ gjatë këtij viti që mund të ketë kontribuar në aftësinë paguese të këtyre huamarrësve. Po ashtu aktiviteti i përmbaresëve privat ka mundësuar lehtësimin dhe përsheptimin e procesit të kthimit të kredive, ndërsa avansimi në reformat strukturore për lehtësim në realizimin e kolateralit ka ndikuar në rritjen e konfidencës së bankave dhe rrjedhimisht rritjen e vëllimit të kredive të lëshuara nga bankat. Rrjedhimisht këta faktorë janë reflektuar në origjinime më të ulëta të kredive joperformuese dhe rikuperim të tyre gjatë periudhës.


Cilësia e portfolios kreditore në Kosovë mbetet në nivelin më të mirë në rajon. Kosova ndër vite qëndron me raportin më të ulët të kredive jo performuese krahasuar me vendet e rajonit (figura 63). Përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore në vitin 2017 ka

Figura 61. Rritja vjetore e kredive dhe kredive joperformuese



Burimi: BQK (2018)

Figura 62. Efekti i procesit të shlyerjeve (write-offs)



Burimi: BQK (2018)

²² BQK 2017, Rregullorja mbi Menaxhimin e Rrezikut Kreditor, neni 18.

²³ Për më tepër lexo kapitullin II, Ndërmarrjet si dhe pjesën e Anketës së kreditimit bankar.


ndikuar në përmirësimin e mëtejshëm të pozicionit, me ç'rast norma e KJP-ve në dhjetor 2017 ishte përgjysmë më e ulët se në Maqedoni, vendi i dytë me cilësinë më të mirë të portfolios kreditore në rajon.

Ekspozimet kreditore me kalsifikim më të lartë kreditor, kreditë standarde, kanë vazhduar trendin e rritjes së pjesëmarrjes në portfolion kreditore, dhe në fund të vitit 2017 përfaqësonin 94 përqind të gjithsej kredive. Kreditë standarde, të cilat përfshijnë ekspozimet kreditore pa vështirësi, me vonesa më pak se 30 ditë, ose plotësisht të mbuluara me kolateral, në vazhdimësi kanë rritur pjesëmarrjen. Në dhjetor 2017, kreditë me klasifikim më të lartë kreditor si kreditë “standard”, “nënstandard” dhe “vrojtuese” rritën peshën e tyre për 1.5, 0.1 dhe 0.2 pikë përqindje, respektivisht, në favor të zvogëlimit të peshës së kredive me klasifikim të ulët si “të dyshimta” dhe “të humbura” për 0.5 dhe 1.3 pikë përqindje (figura 64).

Segmenti më i kredituar dhe njëkohësisht më i ngarkuar nga kreditë jo performuese është segmenti i ndërmarrjeve, megjithëse kualiteti i tyre kreditor është përmirësuar gjatë vitit 2017. Ky segment përfaqëson rreth 63.5 përqind të gjithsej portfolios kreditore për vitin 2017. Raporti i kredive jo performuese për ndërmarrje u zvogëlua në 4.1 përqind nga 5.5 përqind sa ishte në vitin paraprak, si rezultat i rënies së stokut të kredive jo performuese prej 29.1 përqind (figura 65).


Sipas aktivitetit ekonomik, pothuajse të gjithë sektorët janë karakterizuar me përmirësim të portfolios kreditore dhe rënie të normës së KJP-ve. Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë normën më të lartë të kredive jo performuese. Raporti i KJP-ve për sektorin e tregtisë, i cili përfaqëson sektorin më të kredituar, në vitin 2017 zbriti në 4.5 përqind nga 6.0 përqind në vitin paraprak. Ndërsa sektori me normën më të lartë të KJP-ve është sektori i bujqësisë me 8.2 përqind, njëjtë si vitin paraprak. Ky sektor që përfaqëson sektorin më strategjik të ekonomisë është një ndër sektorët më pak të kredituar, ku vetëm 1.8 përqind e gjithsej stokut të kredive janë të destinuara për bujqësi. Më pas është sektori i energjisë me normë të KJP-ve prej 5.2 përqind dhe ai i prodhimit me 4.2 përqind (figura 66). Cilësia e portfolios kreditore dhe norma e KJP-ve për ndërmarrjet është përmirësuar edhe në rast të përjashtimit të efektit të

Figura 63. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit




Burimi: BQK (2018)

Figura 64. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave



Burimi: BQK (2018)

Figura 65. Kreditë joperformuese



Burimi: BQK (2018)

shlyerjeve, duke sugjeruar për origjinime më të ulëta të kredive jo performuese dhe rikuperim të tyre gjatë periudhës, si rezultat i performancës më të mirë ekonomike të ndërmarrjeve.²⁴ Rritja e shfrytëzimit të FKPK, i cili garanton deri në 50% të kryegjësë së kredisë për NVM-të duke lehtësuar qasjen në financa dhe mbuluar një pjesë të rrezikut të tyre kreditor, pritet të reflektohet në rritjen e kreditimit për sektorët më pak të kredituar për shkak të rrezikut më të lartë kreditor.

Segmenti i ekonomive familjare që ndër vite karakterizohet me raport të ulët të kredive jo-performuese, gjatë vitit 2017 shënoi pothuajse përgjysmim të raportit. Ekonomitë familjare shënuan rënie të theksuar të stokut të kredive jo performuese, prej 44.3 përqind, që rezultoi në rënie e raportit të KJP-ve në 1.3 përqind nga 2.5 përqind sa ishte një vit më parë (figura 67). Në përmirësimin e cilësisë së portfolios kreditorë kontribut kanë dhënë faktorët rregullativ si procesi i shlyerjes së kredive të humbura nga bilancet e bankës i ndërmarrë gjatë këtij viti. Megjithatë edhe faktorë të tjerë si, zhvillimet e favorshme në tregun e punës dhe të pagave, rritja e të hyrave nga remitancat potencialisht mund të kenë rritur aftësinë paguese të ekonomive familjare, që është reflektuar në rënie e raportit të KJP-ve.

Niveli i provizionimit të sektorit është rritur tutje përkundër rënies së vlerës së provizioneve, si rezultat i përmirësimit më të theksuar të cilësisë së portfolios kreditorë. Niveli i lartë i provizionimit të sektorit bankar jep kontribut në ruajtjen e interesave të depozitorëve, kreditorëve dhe të stabilitetit të sektorit bankar. Rënia e stokut të kredive jo-performuese në vitet e fundit, është duke e zvogëluar nivelin e provizioneve që duhet ndarë për mbulim të humbjeve të mundshme nga kreditë. Në vitin 2017, stoku i kredive jo performuese shënoi rënie të theksuar prej 29.0 përqind, ndërsa vlera e provizioneve për humbje të mundshme nga kreditë u zvogëlua për 16.8 përqind. Rrjedhimisht, raporti i mbulimit me provizione u ngrit në 149.7 përqind nga 127.6 përqind sa ishte në vitin 2016 (figura 67). Sektori bankar mban nivel të lartë të provizioneve, të cilat tejkalojnë edhe kërkesat rregullatore. Provizionet e tepërta përbëjnë 33.6 përqind të gjithsej stokut të provizioneve të mbajtura. Raporti i mbulimit të kredive jo performuese neto nga provizionet për humbje nga kreditë²⁵ ndaj kapitalit rregullator është përmirësuar gjithashtu. Ky raport u zvogëlua në 1.2 përqind nga 1.9 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor ka shënuar rënie në këtë periudhë, ndikuar nga përmirësimi i cilësisë në të gjithë sektorët si dhe nga rritja e mbulueshmërisë me provizione. Kushtet e favorshme makroekonomike të reflektuara në performancë më të mirë të

Figura 66. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve





Figura 67. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione



²⁴ Rënia e KJP-ve pjesërisht mund ti atribuohet edhe ndërrimit metodik të kalkulimit, ku nga viti 2017 nuk përfshihen në llogaritje mjetet jashtëbilancore.

²⁵ Kreditë joperformuese neto përfaqësojnë vlerën e kredive joperformuese që mbetet pasi ti zbriten provizionet për këto kredi.

sektorit të ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, si dhe masat rregullatore të ndërmarra për shlyerje të kredive të humbura kanë përforcuar pozitën kreditore të sektorit dhe kanë ndikuar në rënien e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor. Rënia e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor pritet të manifestohet pozitivisht në dinamikat e kreditimit në periudhën në vijim, gjithashtu krahas prospekteve pozitive për rritjen ekonomike në vend.

Kutia 3. Ndryshimet në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor

Në vitin 2017, BQK ka amandamentuar nenin për shlyerjet në kuadër të **Rregullores për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor**, me qëllim të përcaktimit të standardit të njëjtë të kushteve dhe kriterëve të shlyerjeve të kredive në kuadër të sektorit bankar.

Rregullorja e amandamentuar për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor, e cila ka hyrë në fuqi në fund të muajit qershor 2017, në nenin 18 të saj trajton Shlyerjet, duke specifikuar çartë kushtet dhe afatet e shlyerjeve të kredive, për dallim nga rregullorja e shfuqizuar e cila për pjesën e shlyerjes së kredive nuk ka specifikuar kushtet dhe afatet ndaj dhe shlyerjet e kredive në kuadër të sektorit bankar nuk kanë pasur një trajtim të njëjtë nga të gjithës bankat.

Ndryshimi në trajtimin e shlyerjeve, përveç që do të ndikojë në sigurimin e barazisë në trajtimin e shlyerjeve në kuadër të sektorit, pritet të ndikojë gjithashtu në rritjen e nivelit të shlyerjeve dhe përmirësimin e portfolios kreditore të mbajtur nga bankat. Efektet në nivelin e shlyerjeve ishin të vërejtshme në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2017, i cili u karakterizua me rritje të theksuar të shlyerjeve dhe njëherit rënie të normës së kredive jo performuese ndaj gjithsej kredive. Megjithëse norma e KJP-ve në sektorin bankar të Kosovës ishte në nivel të ulët edhe para aplikimit të ndryshimeve në nenin e shlyerjeve, një masë e tillë pritet të ketë efekt pozitiv në parandalimin e grumbullimit të humbjeve në të ardhmen.

Ndryshimet rregullative në proces


Rregullorja për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor pritet të pësojë ndryshime tjera gjatë vitit 2018, që kanë të bëjnë me fushën e provizionimit të ekspozimeve kreditore të bazuar në modelin e humbjeve të pritura. Këto ndryshime do të jenë rezultat i procesit të ndryshimeve rregullative nga BQK drejt përafrimit me Standardet Ndërkombëtare të Provizionimit dhe Klasifikimit të ekspozimeve kreditore, përkatësisht me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar - Instrumenet Financiare (SNRF 9).²⁶ BQK është duke analizuar zhvillimet më të fundit dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në fushën e provizionimit të ekspozimeve kreditore. Zbatimi cilësor i SNRF 9 për shkak të kompleksitetit, kërkon ndryshime dhe ka ndikim në procese, sisteme dhe në qeverisjen e vetë bankave duke përfshirë edhe nevojën e zhvillimit të resurseve njerëzore në fushën e ndërtimit dhe validimit të modeleve. Në këtë kontekst, BQK është në komunikim të afërt me bankat duke përcjellë procesin dhe sfidat drejt përafrimit me SNRF 9 dhe në një periudhë të afërt planifikon të amandamentoj **Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor**, **Rregulloren për kreditë jo-performuese dhe ristrukturimet**, si dhe udhëzime tjera për të përfshirë këto ndryshime. Zbatimi i SNRF 9 do të mundësojë qasje më të avancuar dhe me perspektivë më parashikuese për vlerësimin e rrezikut kreditor dhe njohjen e humbjeve kreditore, që pritet të rezultojë në njohjen më të hershme të humbjeve si dhe në rritjen e kërkesave për provizione për mbulim nga humbjet e mundshme.

²⁶ <https://www.bis.org/fsi/summary/ifrs9.htm>

6.1.1 Ekspozimet e mëdha kreditore

Shkalla e ekspozimit kreditor është rritur në 88.9 përqind nga 69.5 përqind sa ishte në vitin paraprak, por që mbetet dukshëm nën nivelin maksimal rregullator.²⁷ Rritja vjetore e vlerës së ekspozimeve të mëdha për 44.0 përqind ndikoi në rritjen e shkallës së ekspozimit, përdërisa kapitali i klasit të parë u rrit për 12.6 përqind (figura 68). Në aspektin e ndikimit nga bankat individuale, një bankë që operon si degë e bankës së huaj kishte kontribut të theksuar në rritjen e ekspozimeve të mëdha kreditore. Po qe se do të përjashtoheshin nga llogaritja degët e bankave të huaja²⁸, atëherë shkalla e ekspozimit kreditor të sektorit bankar do të zvogëlohej në 46.0 përqind për vitin 2017 (50.3 përqind në vitin 2016).

Figura 68. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2018)

Koncentrimi i rrezikut kreditor, i shprehur si raport ndërmjet vlerës së ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të këtyre ekspozimeve, është zvogëluar. Vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha²⁹ u zvogëluar në 6.2 milionë euro nga 8.4 milionë euro si rezultat i efektit më të madh të rritjes së numrit të ekspozimeve se sa i rritjes së vlerës së ekspozimeve të mëdha. Ndërsa raporti i tri ekspozimeve më të mëdha ndaj gjithsej ekspozimeve shënoi rënie në 53.7 përqind nga 57.5 përqind. Shkalla e ekspozimeve të mëdha kreditore të gjithsej sektorit bankar ngritet në masë të madhe nga bankat që operojnë si degë bankare në Kosovë, të cilat gjithashtu kanë ndjeshmëri më të lartë në analizën e qëndrueshmërisë ndaj goditjeve të mundshme në ekspozimet e mëdha kreditore. Rezultatet e skenarit të dështimit të tre dhe pesë kredi marrësve më të mëdhenj në secilën bankë, tregojnë se sektori do të qëndronte në kufi të kërkesës rregullatore për kapital, ndërsa 2 degë të bankave të huaja dhe një bankë me rëndësi sistemike do të rezultonin të nënkapitalizuar në rastin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj. Kjo dëshmon që sektori, përkundër që qëndron nën nivelin maksimal rregullator të ekspozimeve kreditore, është i ndjeshëm ndaj goditjeve të mundshme në këto pozicione, sidomos degët e bankave të huaja.³⁰

6.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit

Profiti i sektorit bankar të Kosovës shënoi rritje vjetore prej 13.1 përqind, ndikuar nga rritja e të hyrave nga tarifat dhe komisionet, si dhe rënia e shpenzimeve për provizione. Vlera e profitit neto arriti në 85.4 milionë euro (figura 69). Të hyrat neto nga jo-interesi shënuan rritje të theksuar nga viti paraprak, duke arritur të jenë më të larta për 23.95 milionë euro (apo për 135.3 përqind më të larta). Të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rritje vjetore për 16.0 përqind, dhe ishin ndër faktorët kryesorë të rritjes së profitit krahas rënies së shpenzimeve për provizione (figura 70). Këto të fundit u zvogëluar për 10.3 milionë euro, duke zbritur në vlerën prej 6.3 milionë euro në dhjetor 2017. Rënia e shpenzimeve për provizione është në linjë me përmirësimin e kualitetit kreditor, kushteve të favorshme ekonomike dhe stokut të lartë të provizioneve që bankat kanë mbajtur ndër

²⁷ Raport i gjithsej Ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj Kapitalit të Klasit të parë. Ekspozim i madh kreditor, përcaktuar sipas rregullorës së BQK-së mbi Ekspozimet e Mëdha, konsiderohet çdo ekspozim ndaj një personi të vetëm ose grup të ndërlidhur personat vlera e të cilit tejkalon 10% të kapitalit të klasit të parë të bankës. Ndërsa të gjitha ekspozimet e mëdha kreditore së bashku nuk mund të tejkalojnë më shumë se 300% të kapitalit të klasit të parë.

²⁸ Këtu duhet pasur parasysh që degët e bankave të huaja janë të përjashtuara nga kufizimet rregullative dhe kontrolli i ekspozimeve të mëdha bëhet në raport me kapitalin e klasit të parë të bankave amë.

²⁹ Raporti i gjithsej ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të ekspozimeve.


³⁰ Duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, këto banka nuk janë subjekt i rregullativës për kufizim të raportit të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë të bankës por ndaj kapitalit të klasit të parë të bankave amë, prandaj edhe vlera e ekspozimeve të mëdha kreditore është më e lartë tek këto banka.

vite për mbrojtje nga humbjet e kredive. **Profiti i sektorit bankar të Kosovës shënoi rritje vjetore prej 13.1 përqind, ndikuar nga rritja e të hyrave nga tarifat dhe komisionet, si dhe rënia e shpenzimeve për provizione.** Vlera e profitit neto arriti në 85.4 milionë euro (figura 69). Të hyrat neto nga jo-interesi shënuan rritje të theksuar nga viti paraprak, duke arritur të jenë më të larta për 23.95 milionë euro (apo për 135.3 përqind më të larta). Të hyrat nga tarifat dhe komisionet shënuan rritje vjetore për 16.0 përqind, dhe ishin ndër faktorët kryesorë të rritjes së profitit krahas rënies së shpenzimeve për provizione (figura 70). Këto të fundit u zvogëluan për 10.3 milionë euro, duke zbritur në vlerën prej 6.3 milionë euro në dhjetor 2017. Rënia e shpenzimeve për provizione është në linjë me përmirësimin e kualitetit kreditor, kushteve të favorshme ekonomike dhe stokut të lartë të provizioneve që bankat kanë mbajtur ndër vite për mbrojtje nga humbjet e kredive.

Rënia e vazhdueshme e kostos së financimit përmes depozitave nuk e kompensoi mjaftueshëm rënien e të hyrave nga aktiviteti kreditor duke ndikuar që të hyrat neto nga interesi edhe këtë vit të shënojnë rënie. Megjithatë, krahasuar me rënien prej 1.9 përqind në vitin paraprak, këtë vit rënia ishte më e ulët, për 0.4 përqind (figura 71). Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlu në 6.8 përqind, rënie prej 0.7 pikë përqindje, ndërsa ajo në depozita u ngrit lehtësisht në 1.04 përqind, ngritje për 0.3 pikë përqindje.³¹ Presionet e konkurrencës për zvogëlim të normave të interesit në kredi ndikuan në rënien vjetore të të hyrave nga interesi prej 1.0 përqind, por sektori bankar menaxhoi të ngadalësoj ritmin e rënies përmes rritjes së aktivitetit kreditor.


Po ashtu shpenzimet për interesa vazhduan trendin rënës, por me ritëm më të ngadalësuar (rënie 6.3 përqind këtë vit krahasuar me 19.6 përqind vitin paraprak) si rezultat i ngushtimit të hapësirës për zvogëlim të mëtejme të normave të interesit në depozita.

Figura 69. Struktura e profitit të sektorit bankar, në milionë euro




BQK: Burimi (2018)

Figura 70. Kontribuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit



Burimi: BQK (2018)

Figura 71. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit



Burimi: BQK (2018)

³¹ Duke qenë se rreth 90 përqind e të hyrave dhe shpenzimeve nga interesi realizohen nga aktiviteti ndërmjetësues, atëherë të hyrat neto nga interesi ndikohen direkt nga ndryshimet në normat e interesit në kredi dhe depozita (figura 57 dhe 58).


Margjina neto e interesit u zvogëlua në 5.0 përqind, për 0.5 pikë përqindje, si rezultat i rënies më të theksuar të normës së interesit në kredi (figura 72). Norma mesatare e interesit në depozita u zvogëlua me ritëm më të theksuar që nga viti 2014 krahasuar me zvogëlimin e normës së interesit në kredi, duke ndikuar që margjina neto e interesit në vitin 2014 dhe 2015 të rritet për 0.1 dhe 0.2 pikë përqindje. Në dy vitet e fundit ky efekt pozitiv i lëvizjes së normave të interesit është zvogëluar, duke lënë hapësirë që rënia e normës së interesit në kredi të zvogëlojë margjinën neto të interesit.

Profiti i sektorit pritet të ballafaqohet me presionin e ngushtimit të hapësirës për zvogëlim të kostos së financimit përmes depozitave dhe presionet e vazhdueshme të konkurrencës për zvogëlim të kostos së ndërmjetësimit. Norma veçse e ulët e interesit në depozita si dhe pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme (rreth 60 përqind e gjithsej depozitave) të cilat nuk kanë shpenzime interesi, bën që mundësitë për efekte pozitive në realizimin e profitit nga menaxhimi i shpenzimeve për interesa, të jenë të kufizuara. Prandaj, duke pasur parasysh këtë dhe deklaratimet e bankave në anketën e kreditimit bankar që sinjalizojnë për mundësinë e rënies së mëtejme të normave të interesit në kredi, pozita aktuale e lartë e profitabilitetit do të ballafaqohet me presione rënëse të cilat mund të nxisin bankat të hulumtojnë mënyra të reja për gjenerim profiti.

Përpjekjet e bankave për rritje të efikasitetit në menaxhimin e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, si dhe në përshtatjen e modelit të biznesit ndaj nevojave të tregut pritet të


intensifikohen si rezultat i presioneve konkurruese. Ngushtimi i margjinës së interesit si dhe avancimet teknologjike në sektorin e financave do t'i shtojë presionet e bankave në Kosovë për avancimin e proceseve dhe modeleve të tyre të biznesit me qëllim të rritjes së efikasitetit në menaxhimin e kostove dhe sigurimit të burimeve të reja për gjenerim të të hyrave. Bankat veçse kanë shtuar përpjekjet për zvogëlimin e shpenzimeve operative duke i racionalizuar aktivitetet dhe zvogëluar degët, krahas ndërmarrjes së veprimeve strategjike për inkurajimin e rritjes së përdorimit të shërbimeve të automatizuara dhe atyre elektronike. Kjo e fundit mund të ketë qenë një ndër

Figura 72. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit




Burimi: BQK (2018)

Figura 73. Struktura e të hyrave të sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)

Figura 74. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar




Burimi: BQK (2018)

faktorët që kanë ndikuar në rritjen e çmimeve për tarifa dhe komisione, sidomos për shërbimet e kryera brenda bankës.

Indikatorët e profitabilitetit u rritën si rezultat i rritjes së profitit dhe vazhdojnë të qëndrojnë në nivelin më të lartë në rajon. Kthimi mesatar në asete dhe kapital i sektorit bankar të Kosovës arriti në 2.6 përqind, përkatësisht 21.3 përqind nga 2.3 përqind dhe 19.7 përqind një vit më parë (figura 75). Këto nivele janë mjaft mbi mesataren e rajonit që shënoi normë të kthimit në asete prej 1.6 përqind dhe normë të kthimit në kapital prej 12.5 përqind.³²

Figura 75. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK (2018)

6.2.1 Rreziku ndaj luhatjeve të normave të interesit

Rritja e vazhdueshme e kreditimit nga bankat në njërin anë si dhe rritja e pjesëmarrjes së depozitave të transferueshme dhe të atyre me afat më të shkurtër maturimi, ka rritur ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të ndryshimeve në norma të interesit. Rreziku manifestohet në kuptimin e gjenerimit të të hyrave nga ri-investimi i mjeteve dhe krijimi i shpenzimeve për refinancimin e aktiveteve kur mospërputhjet e afateve të maturimit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve janë të mëdha (figura 76). Bilanci i gjendjes së sektorit bankar në Kosovë karakterizohet kryesisht me norma fikse interesi, andaj sektori është i ndikuar nga lëvizjet e normave të interesit kryesisht në maturim të këtyre pozicioneve. Rritja e mundshme e kostos së financimit, ndikuar nga presionet e konkurrencës në tërheqjen e depozitave apo nga rritja e mundshme e normave të interesit në nivel global në afat të mesëm, mund të ndikoj në rritjen e presionit të shpenzimeve të sektorit, meqë kategoria kryesore e aseteve, kreditë, janë kontraktuar me normë fikse të interesit dhe kanë maturitet më të gjatë. Kjo situatë do të nxitë nevojën për ndryshime eventuale në strukturën e aseteve dhe detyrimeve të sektorit për menaxhim efektiv të rrezikut.

Figura 76. Hendeku kumulativ i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit



Burimi: BQK (2018)


Krahasuar me vitin paraprak hendeku u zgjerua në të gjitha afatet e maturimit, përveç në afatin '31-90 ditë' që u ngushtua. Hendeku pozitiv për afate të maturimit mbi 3 muaj u zgjerua më tej, ndërsa u thellua në vlerë negative për afatin e maturimit '1-30 ditë', si rezultat i rritjes së aseteve me afat më të gjatë maturimi krahas rritjes së detyrimeve me afat më të shkurtër maturimi (figura 77). Kjo do të thotë se sektori në afat të shkurtër të maturimit do të përballlej me rrezik për rritje të mundshme të normës së interesit që do të afektonte koston e refinancimit. Rritja e hendekut kumulativ në vlerë pozitive nënkupton se një sinjal për rritje të normave të interesit në treg do të ishte e favorshme në kuptimin e gjenerimit të të hyrave nga ri-investimi i mjeteve që maturojnë, por në të njëjtën kohë do të rritej rreziku i përballimit të kostove dhe mundësive të refinancimit. Duhet theksuar se rritja e mundshme e normave të interesit mund të ketë efekt pozitiv të drejtpërdrejtë në

³² Në vendet e rajonit përfshihen Shqipëria, Serbia, Bosna dhe Hercegovina dhe Maqedonia. Mali i Zi nuk është përfshirë në mungesë të të dhënave.

të ardhurat nga interesi nga investimet në letra me vlerë dhe instrumente tjera, përderisa vlerësimi i efektit nga rritja në normën e ndërmjetësimit financiar është më problematik ngase ndikon kërkesën për kredi si dhe mund të nënkuptoj rritje të ngarkesës për huamarrësit.

Analiza e sensitivitetit të sektorit ndaj rritjes së mundshme të normës së interesit sugjeron për ekspozim të ulët të sektorit bankar ndaj këtij rreziku. Rezultatet sugjerojnë që një rritje e mundshme e normave të interesit në pozicionet bilancore me ndjeshmëri ndaj normave të interesit nuk do të rezultonte në humbje për sektorin. Kjo pasi që asetet me ndjeshmëri ndaj normave të interesit janë më të larta se detyrimet për periudhën 1 vjeçare, dhe nën supozimin se të njëjtat instrumente që maturojnë do të mund të ri-investohen me normë më të lartë, sektori rezulton me efekte pozitive në të hyra.


Figura 77. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit



6.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja

Pozicioni i agreguar neto i hapur në valuta të huaja u zvogëluar gjatë vitit, duke e ulur më tej ekspozimin, edhe ashtu mjaft të ulët, ndaj rrezikut të ndryshimit të valutës. Pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat e huaja shënoi rënie në 5.6 milionë euro ekuivalente nga 18.4 milionë euro, që konsiston në 1.2 përqind të kapitalit të klasit të parë (4.6 përqind në vitin 2016) (figura 78). Kjo nënkupton se ekspozimi i sektorit bankar u zvogëluar edhe në kuptimin e mospërputhjeve valutore, si rezultat që asetet në valutë të huaj ekuivalente në euro u rritën mirëpo u mbizotëruan nga rritja e detyrimeve në valuta të huaja ekuivalente në euro. Këto lëvizje ndikuan që hendëku ndërmjet aseteve dhe detyrimeve në valutë të huaj të zvogëlohet në 0.01 përqind të gjithë aseteve të sektorit nga 0.2 përqind sa ishte një vit më parë.

Figura 78. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë



Sipas valutave të veçanta, pozicioni neto i disagreguar ndaj kapitalit të klasit të parë u zvogëluar për dollarin amerikan dhe funtën britanike ndërsa për frankun zviceran dhe valutat tjera të agreguara shënoi rritje. Detyrimet në dollar amerikan dhe funtë britanike u rriten ndjeshëm duke tejkalar kështu asetet në këto valuta. Kjo do të thotë se sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të zhvlerësimit të mundshëm të euros ndaj këtyre dy valutave në kohën e maturimit pasi që vlera e detyrimeve ekuivalente në euro do të rezultonte më e lartë dhe rrjedhimisht do të ndikonte në rritje të kostos së financimit në valutë. Ndërsa pozicionet e aseteve në frankun zviceran tejkalar detyrimet në këtë valutë.

Raporti i pozicioneve neto të hapura për çdo valutë individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën nivelin maksimal prej 15 përqind të lejuar sipas rregullores përkatëse. Prandaj, luhatjet valutore kanë ndikim marginal në gjendjen financiare të

sektorit, marrë parasysh nivelin mjaft të ulët të pozicioneve në valuta të huaja. Kjo dëshmohej edhe përmes stres testit që sugjeron nivel të ulët të ndjeshmërisë së pozitës kapitale të sektorit ndaj luhatjeve në kurset e këmbimit.

Rreziku i tërthortë kreditor nga ekspozimi në valutë mbetet i ulët ngase kreditë në valutë mbeten në nivel të papërfillshëm. Kreditë në valutë të huaj përbëjnë vetëm 0.2 përqind të gjithë kredive, pavarësisht rritjes prej 1.1 milionë euro të portfolios kreditorë në valutë gjatë kësaj periudhe. Depozitat në valutë gjithashtu kanë pjesëmarrje të ulët, 4.8 përqind, pavarësisht rritjes prej 19.2 milionë euro që shënuan këtë vit (figura 79).

6.4. Kapitali


Pozita e kapitalit të sektorit vazhdon të reflektoj qëndrueshmëri të lartë. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u ngrit në 18.06 përqind nga 17.83 përqind (figura 80). Kjo rritje reflekton bazën e fortë të kapitalit rregullator, 90 përqind e të cilit është kapital i klasit të parë, që kryesisht rezultojnë nga profiti i lartë i realizuar dhe ai i mbajtur, e që njëherit jep indikacion që bankat janë të orientuara në krijimin e kapitalit kryesisht brenda aktivitetit të tyre (mbajtjes së profitit si ekuitet).

Kapitali rregullator shënoi rritje prej 11.7 përqind, duke kontribuar në rritjen e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit për 2.1 pikë përqindje (figura 80). Rritje shënuan pothuajse të gjitha kategoritë e kapitalit rregullativ (figura 81). Shpërndarja e dividitës nga bankat që e ndikon kapitalin përmes reduktimit të fitimit të pashpërndarë, ishte faktori i vetëm me efekt reduktues në kapital rregullativ.

Rritja e kreditimit gjatë këtij viti, ka ndikuar në rritjen e ekspozimit të sektorit ndaj aseteve me peshë rreziku. Rritja prej 10.3 përqind e aseteve me peshë rreziku kontribuoi në rënien e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit për 1.9 pikë përqindje. Rrjedhimisht efekti më i lartë i rritjes së kapitalit rregullator se i aseteve me peshë rreziku e ngriti treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit për 0.2 pp (figura 81).


Sipas bankave individuale, disa nga bankat që kanë zgjeruar aktivitetin e tyre kreditor janë përballur më rënie të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit si rezultat i rritjes më të lartë të aseteve me peshë rreziku. Megjithatë këto banka nuk janë përballur me rritje të profilit të rrezikut, shprehur përmes raportit të aseteve me rrezik ndaj gjithë aseteve.

Figura 79. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj



Burimi: BQK (2018)

Figura 80. Kapitalizimi i sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)


Perfomanca e mirë financiare e sektorit bankar ka përforcuar nivelin e kapitalizimit të sektorit shprehur edhe përmes levës financiare. Indikator i levës financiare (raporti i ekuitetit ndaj asetëve) u ngrit në 12.6 përqind nga 12.1 përqind sa ishte në vitin paraprak, duke sugjeruar zgjerim të financimit të aktivitetit përmes kapitalit aksionar në raport me financiminin përmes borxhit (figura 82).

Në kuadër të asetëve të peshuara me rrezik, rritje shënuan si asetet e peshuara për rrezik kreditor, ashtu edhe ato të destinuar për rrezik operacional. Duke qenë se modeli i biznesit të sektorit bankar është kryesisht aktiviteti kreditor, 91.6 përqind e kërkesave kapitale për rreziqe janë destinuar për rrezikun kreditor ndërsa 8.4 përqind për atë operacional (figura 82). Në vitin 2017 asetet me peshë të rrezikut kreditor u rritën për 247.0 milionë euro (apo 10.8 përqind rritje vjetore), duke arritur në 2.5 miliardë euro. Kategoritë që shënuan rritje ishin ato me peshë rreziku 75%, që konsistojnë 97.8 përqind kredi residenciale dhe të ndërtimit të pasurive të paluajtshme. Po ashtu edhe asetet me peshë rreziku 100% që dominojnë gjithsej APR-të, kanë shënuar rritje prej 9.7 përqind mirëpo pesha e tyre në gjithsej APR-të është zvogëluar lehtësisht për shkak të rritjes së bazës së gjithsej asetëve me peshë rreziku (figura 83). Këto lëvizje janë në linjë me zhvillimet në bilanc të gjendjes të rritjes së kreditimit afatgjatë (kreditë me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ zgjeruan pjesëmarrjen në gjithsej kreditë për 4.6 pikë përqindje).

Pothuajse 90.0 përqind e gjithsej kredive ndaj klientëve për vitin 2017, janë të peshuara më rrezik 100%, përderisa 70.5 përqind e kredive ndaj institucioneve tjera financiare janë të peshuara me rrezik prej 20% (figura 83).


Niveli i mbajtjes së kapitalit për rrezik operacional ka shënuar rritje të qëndrueshme ndër vite krahas rritjes së vazhdueshme të ekspozimit ndaj këtij rreziku. Revolucionin digjital ka

Figura 81. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit




Burimi: BQK (2018)

Figura 82. Struktura e kapitalit rregullator



Burimi: BQK (2018)

Figura 83. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej asetëve të sektorit



Burimi: BQK (2018)

ndikuar në çdo aspekt, përfshirë këtu edhe ndikimin në sistemin financiar duke nxitur adoptimin gjithnjë e më shumë të sistemeve të avansuara të teknologjisë dhe të krijimit të infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara. Këtyre zhvillimeve u janë ekspozuar edhe bankat në Kosovë të cilat posaçërisht në vitet e fundit kanë investuar mjaft në ofrimin e shërbimeve elektronike bankare. Mbështetja gjithnjë e më madhe në shërbime të digjitalizuara po e rrit shkallën e rrezikut ndaj gabimeve në sisteme të teknologjisë informative apo dhe sulmeve të mundshme kibernetike. Ngjarje të tilla përveç që shkaktojnë humbje materiale krijojnë pasiguri dhe humbje besimi të klientëve ndaj bankave dhe sistemit financiar në përgjithësi. Prandaj mbikëqyrja dhe vlerësimi i rrezikut operacional është çështje shumë e rëndësishme nga pikëpamja e stabilitetit financiar pasi që rreziku operacional njëkohësisht mund të paraqes rrezik sistemik për shkak të humbjeve dhe panikut që mund të përhapet. Në vitin 2017, kërkesat për ndarje të kapitalit për mbulimin e humbjeve të mundshme operationale qëndruan në vlerën prej 231.6 milionë euro, për 4.7 përqind më e lartë se në vitin paraprak. Sidoqoftë, menaxhimi i rrezikut operacional vlerësohet adekuat, duke mos pasur raste të materializimit të tij, si dhe duke ndarë kapitalin për mbulimin e këtij rreziku në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore.

Rezultatet e stres test sugjerojnë se sektori bankar mbetet i qëndrueshëm në të gjithë skenarët e supozuar të goditjeve në pozitën kapitale.


Kutia 4. Korniza rregullative mbi kërkesat për kapital

Kriza globale financiare e vitit 2008 ka nxitur rishikimin dhe avancimin e kornizës rregullative ndërkombëtare, si dhe atyre në nivel nacional, për mbrojtjen e sistemit financiar nga rreziku sistemik. BQK është në proces gradual të përafritimit të kornizës së saj rregullative me standardet ndërkombëtare të Bazelit dhe direktivat e rregulloreve të Bashkimit Evropian.

Nga shtatori i vitit 2014, ka filluar projekti specifik për adaptimin dhe implementimin e kornizës rregullative të njohur si Korniza e Bazelit për Kapitalin (eng. Basel Capital Framework). Aktualisht BQK është në përfundim të procesit të adaptimit të plotë të kërkesave të Shtyllës së Parë të Bazelit, dhe njëkohësisht në proces të vazhdueshëm të avancimit të adaptimit të kërkesave të Shtyllës së Dytë dhe të Tretë. Harmonizimi i plotë i rregullativës ekzistuese për mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave me Kornizën e Bazelit për Kapital dhe rregulloren e BE-së 575/2013 si dhe Direktivën e BE-së 2013/36, sipas strategjisë së BQK-së, është paraparë të finalizohet përgjatë periudhës 2015 – 2019.


Në kuadër të këtij projekti, në vitin 2017 është vazhduar me përgatitjen e ndryshimeve të **Rregulloreve për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave**, me anë të së cilës ri definohet kapitali rregullativ si dhe përcaktohen kërkesat për kapital ndaj rrezikut kreditor përmes aplikimit të qasjes së standardizuar për peshim me rrezik të ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor, përcaktohen kërkesat për adaptimin e teknikave të zbutjes së rrezikut kreditor, si dhe kërkesat për kapital për rrezikun e tregut dhe atë operacional.

Figura 84. Struktura e APR-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2018)

Figura 85. Klasat e asetëve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2018)

Këto ndryshime kryesisht përfshijnë rishikimin e kërkesave për kapital dhe elementeve përbërëse të kapitalit me qëllim të ngritjes së cilësisë së kapitalit, që do të mundësojë që ekspozimet e bankave të mbulohen me bazë të kapitalit të kualitetit më të lartë përmes instrumenteve financiare që kanë mundësi më të mëdha abosorbuese të humbjeve. Definicioni i kapitalit është bërë sipas kornizës Bazel III.³³ Niveli i përgjithshëm i kapitalit rregullativ që do të kërkohet mbetet i njëjtë në 12% të gjithësej mjeteve të peshuara me rrezik, mirëpo kompozicioni i tij ka ndryshuar. Kapitali i klasit të parë (Tier 1) është klasifikuar në kapitalin bazë të klasës së parë (CET 1), i cili në çdo kohë duhet të jetë në së paku 4.9% të mjeteve të peshuara me rrezik. Në kapitalin e klasit të parë është shtuar edhe kapitali shtesë i kapitalit bazë (ang. Capital conservation buffer), që së bashku me kapitalin bazë në çdo kohë duhet të jenë në së paku 9% të mjeteve të peshuara me rrezik. Kjo ndikon që kërkesa për kapital të klasit të parë të rritet në 9% të mjeteve të peshuara me rrezik, nga 8% sa është aktualisht.

Në aspekt të ndryshimeve në mjetet e peshuara me rrezik, ndër tjera, BQK është në proces të vlerësimit të ndryshimit të peshës së ekspozimeve kreditore të garantuara përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, me qëllim të mbështetjes së kreditimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Peshat aktuale e kredive të garantuara nga FKGK është në nivelin 50%,³⁴ që përkon me faktin se 50% e ekspozimit garantohej nga FKGK. Sidoqoftë, me qëllim të rritjes së qasjes në financa dhe stimulimit të sektorit, është duke u shqyrtuar mundësia për zvogëlimin e peshës së rrezikut të ekspozimeve kreditore të garantuara nga FKGK, gjë që pritet të rezultojë në shfrytëzueshmëri më të lartë të fondit si dhe përkrahje të kreditimit për sektorë më produktiv të ekonomisë.

Njëkohësisht, është duke u punuar në drejtim të harmonizimit të kërkesave rregullative me dokumentin e Bazel III mbi treguesin e leverazhit për sektorin bankar, me ç'rast ka hartuar **Rregulloren mbi Treguesin e Leverazhit**, e cila pritet të aprovohet gjatë këtij viti. Përmes aplikimit të treguesit të leverazhit, i cili është tregues i thjeshtë i kapitalit që nuk bazohet në rrezik, synohet të kufizohet ekspozimi ndaj rrezikut eventual të rritjes së ekspozimeve bilancore dhe jashtë bilancore të bankave përmes emetimit të tepërt të instrumenteve të borxhit që mund të destabilizojnë sektorin financiar dhe ekonominë. Sipas Rregullore së Treguesit të Leverazhit, bankat obligohen që këtë tregues, që përfshinë raportin e masës së kapitalit³⁵ ndaj masës së ekspozimit, ta mbajnë në nivelin minimal prej 3%. Aktualisht BQK obligon bankat që treguesin e leverazhit ta mbajnë në nivelin minimal 7%, por mënyra e llogaritjes ndryshon. Raporti aktual i leverazhit është i barabartë me totalin e ekuitetit ndaj totalit të mjeteve. Analiza e ndikimit të ndryshimit të treguesit të leverazhit tregon se edhe me ndryshimet në mënyrën e llogaritjes, niveli aktual i leves së sektorit mbetet i ngjashëm me rënie të lehtë të treguesit sipas metodologjisë së re të llogaritjes.

Rregullore tjetër e cila është në proces të përfundimit është **Rregullorja mbi Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit** (angl. the Internal Capital Adequacy Assessment Process: ICAAP). Kjo rregullore, që është kërkesë e Shtyllës së Dytë të Kornizës së Bazelit për Kapital, synon përcaktimin e procesit të vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës me qëllim të menaxhimit të rrezikut, përcaktimit të strategjive të rrezikut dhe planifikimit të kapitalit. Adaptimi i kësaj rregullore do të ndikojë në ngritjen e kapaciteteve si për vlerësim të rrezikut nga vetë bankat, ashtu edhe për monitorim të rrezikut dhe kërkesave për kapital nga mbikëqyrësi, duke ndikuar në avancimin e procesit për ruajtje të stabilitetit financiar. Procesi i draftimit të rregulloreve të ndërlidhura me kërkesat e kapitalit ka qenë gjithëpërfshirës, si dhe janë kryer vlerësimet për ndikimin që këto rregullore mund të kenë për secilën bankë individuale si dhe në sektorin bankar në përgjithësi. Rezultatet e vlerësimit të ndikimit sugjerojnë se bankat posedojnë kapacitete adekuate për adaptimin e ndryshimeve pa ndonjë ndikim negativ në treguesit përkatës dhe performancën e tyre financiare. Gjithashtu është punuar në ngritjen e kapaciteteve për sigurimin e aplikimit efektiv të rregulloreve, të cilat pritet të aprovohen në të ardhmen e afërt, me një periudhë kalimtare 6 deri në 9 muaj të hyrjes në fuqi. Hyrja në fuqi e këtyre rregulloreve pritet të ndikojnë në rritjen e qëndrueshmërisë së stabilitetit financiar të sektorit përmes mundësimit të mbikëqyrjes më prudente të bankave, rritjes së cilësisë së kapitalit dhe rritjes së aftësisë së sektorit për mbrojtje ndaj rreziqeve. Gjithashtu, hyrja në fuqi e rregulloreve do të shoqërohet me rishikim të kërkesave minimale të publikimit të informacionit nga bankat, të cilat do të ndikojnë në rritjen e transparencës dhe disiplinës së tregut.

³³ Në kapitalin bazë të klasës së parë, apo në fitimin e mbajtur, është mundësuar të përfshihen edhe fitimet e fundvitet nën kushtin që ato janë verifikuar nga auditor i jashtëm apo nga BQK gjatë ekzaminimeve.

³⁴ Në mungesë të vlerësimit kreditor të FKGK nga agjencionet kredibile për vlerësim kreditor, përcaktimi i peshës së rrezikut të ekspozimeve kreditore të garantuara nga FKGK është në diskrecionin e BQK-së.

³⁵ Masa e kapitalit përfshinë kapitalin e Klasit të parë sipas Rregullore së re të Adekuatshmërisë së Kapitalit, ndërsa masa e ekspozimit përfshinë ekspozimet bilancore, derivative, të transaksioneve të letrave me vlerë, dhe zërat jashtë-bilancorë.

6.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit


6.5.1 Financimi bankar

Struktura e financimit të sektorit bankar dominohet nga financimi prej sektorit jo-bankar, kryesisht depozitave të cilat vazhduan rritjen. Në vitin 2017, depozitat përbënin 80.0 përqind të financimit, përdërisa vetëm depozitat e sektorit jo-bankar (ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare) konsistojnë në 88.9 përqind të gjithsej depozitave, gjë që tregon se financimi ndër-bankar është në nivel shumë të ulët dhe se bankat janë shumë pak të ekspozuara ndaj financimit në sektorin e jashtëm (figura 86). Gjithsej depozitat shënuan rritje vjetore prej 6.8 përqind duke arritur në vlerën prej 3.1 miliardë euro. Ndërsa vetëm depozitat e sektorit jo-bankar arritën në 2.8 miliardë euro, dhe u rritën me normë vjetore prej 3.9 përqind.

Depozitat e ekonomive familjare, të cilat paraqesin burimin kryesor të financimit, vazhduan rritjen pavarësisht mbizotërimit të normave të ulëta të interesit në treg. Trendi i rritjes vazhdoi edhe këtë vit, megjithëse me ritëm më të ngadalësuar prej 2.3 përqind nga 8.0 përqind në vitin 2016 (figura 87). Stoku i depozitave të ekonomive familjare arriti në 2.2 miliardë euro. Pjesa më e madhe e tyre ishin depozita të transferueshme (38.4 përqind), të cilat me rritjen e tyre vjetore prej 6.8 përqind kontribuan në rritjen e gjithsej depozitave të ekonomive familjare (figura 88).


Depozitat e ndërmarrjeve përsheptuan trendin e rritjes për 1.1 pikë përqindje, në 10.4 përqind rritje vjetore, të mbështetur nga performanca pozitive financiare e ndërmarrjeve si dhe rritja e lehtë e normave të interesit. Stoku i depozitave të ndërmarrjeve arriti në 581.5 milionë euro, me pjesëmarrje 18.8 përqind në gjithsej depozitat. Rritja e depozitave të ndërmarrjeve u ndikua kryesisht nga rritja e depozitave të transferueshme prej 7.8 përqind, për shkak të efektit të bazës. Depozitat e afatizuara u karakterizuan me rritje më të lartë, 30.8 përqind, që mund të jetë ndikuar nga rritja e lehtë për 0.14 pikë përqindje e normës së interesit për këto depozita, e cila arriti në 1.73 përqind.

Figura 86. Struktura e financimit




Burimi: BQK (2018)

Figura 87. Struktura e depozitave



Burimi: BQK (2018)

Figura 88. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit




Burimi: BQK (2018)

Struktura e gjithsej depozitave sipas afatit të maturimit dominohet nga depozitat e transferueshme, të cilat shënuan rritje edhe këtë vit, me normë vjetore prej 11.4 përqind. Depozitat e transferueshme arritën në 60.4 përqind të gjithsej depozitave në vitin 2017 (figura 89). Në kuadër të gjithsej depozitave 38.4 përqind përbëhet nga depozitat e transferueshme të ekonomive familjare. Gjithsej depozitat e afatizuara shënuan rritje vjetore prej 6.5 përqind, për të dytin vit me radhë ndërsa depozitat e kursimit shënuan rënie vjetore prej 7.1 përqind. Mbizotërimi i normave të ulëta të interesit mbi depozita të kursimit dhe të afatizuara po reflekton dekurajim të kursimit tek ekonomitë familjare.

Afatet e maturimit të depozitave dhe kredive theksojnë mospërputhjet strukturore ndërmjet tyre, të cilat janë më të shprehura tek afatet ‘deri në 1 vit’ dhe ‘mbi 1 vit deri në 2 vite’. Përderisa depozitat me afat maturimit ‘deri në 1 vit’ dominuan dhe zgjeruan pjesëmarrjen në 45.0 përqind të strukturës së depozitave të afatizuara, kreditë me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ janë ato që kanë pjesëmarrjen më të lartë (prej 36.3 përqind) në gjithsej kreditë dhe të cilat në vitin 2017 zgjeruan tutje pjesëmarrjen e tyre (figura 89).

Figura 89. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive



Burimi: BQK (2018)


Pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme dhe rritja e tyre ndër vite në një rën anë, dhe në anën tjetër rritja e kreditimit afatgjatë ka rritur presionet për financim të qëndrueshëm të bankave, që mund të manifestohet në presione të konkurrencës në sistemin bankar sa i përket lëvizjeve të normave të interesit. Presionet e konkurrencës për zvogëlim të normave të interesit në kredi për stimulim të aktivitetit kreditor, njëkohësisht mund të krijojë presione për rritje të normave të interesit në depozita nga disa banka me qëllim të nxitjes së kursimeve për të siguruar financim më stabil.

6.5.2 Rreziku i Likuiditetit

Sektori bankar vazhdon të mbajë pozitë të kënaqshme të likuiditetit. Indikatorët kryesor të likuiditetit japin sinjale pozitive për stabilitet të likuiditetit bankar. Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të bankave, vazhdon të përfaqësohet nga depozitat, të cilat tejkalojnë kreditë për 124.5 përqind, megjithatë ky tregues u zvogëlua për 5.4 pikë përqindje, nën ndikimet e zgjerimit të aktivitetit kreditues (figura 90).

Asetet likuide qëndrojnë në nivele të larta dhe ndonëse raporti i tyre ndaj detyrimeve afatshkurtra u zvogëlua gjatë vitit, raporti më i lartë se minimumi rregullator³⁶ tregon për potencial të zgjerimit të aktivitetit kreditues. Në vitin 2017 raporti i aseteve likuide

Figura 90. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)

³⁶ Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra është i definuar në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit prej 25% (neni 17. Norma e likuiditetit)

ndaj detyrimeve afatshkurtra u zvogëlua në 37.9 përqind nga 41.5 përqind në vitin 2016. Ky rezultat u ndikua nga rritja e detyrimeve afatshkurtra prej 6.3 përqind dhe rënia e aseteve likuide prej 2.8 përqind, çka reflekton zhvillimet në bilancin e gjendjes të rritjes së kreditimit afatgjatë dhe të depozitave afatshkurtra. Po ashtu edhe raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve qëndroi në 28.7 përqind (31.7 përqind në vitin 2016), si rezultat i rritjes së gjithsej aseteve prej 7.4 përqind (figura 91).


Rënia e aseteve likuide gjatë periudhës rezultoi nga rënia vjetore prej 31.9 përqind e depozitave dhe plasmaneve në bankat vendore, me afat maturimi deri në 30 ditë. Po ashtu bonot e thesarit të Republikës së Kosovës dhe fletë obligacionet e qeverive të huaja shënuan rënie vjetore prej 19.3 përqind, respektivisht 28.3 përqind. Ndërsa rritje shënuan letrat me vlerë të institucioneve financiare ndërkombëtare, fletë obligacionet e qeverisë së Kosovës dhe bilanci i rezervave me BQK-në.

Rezervat e likuiditetit të bankave komerciale vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 53.4 përqind. Nga gushti i vitit 2016, BQK ka aplikuar normë negative të interesit mbi tepriçën e rezervës së obliguar që bankat komerciale në vend i mbajnë në bankën qendrore, në linjë me zhvillimet ndërkombëtare si dhe vendimin e BQE-së për aplikim të normave negative në depozita. Aplikimi i normës negative ndikoi tepriçën e rezervës menjëherë në muajin vijues, ku në shtator të vitit 2016 teprica u zvogëlua për 29.9 përqind (figura 92).³⁷ Megjithatë, nuk janë vërejtur efekte afatgjata të masës së normës negative në nivelin e tepriçës së rezervës, potencialisht për shkak të mundësive të kufizuara për ruajtje apo edhe investim të mjeteve si rezultat i normave të ulëta të interesit.

Ambienti i normave të ulëta të interesit është duke stimuluar ekonomitë familjare të zhvendosin depozitat e tyre në favor të maturitetit afatshkurtër, që krahas trendit të përshpejtimit të kreditimit afatgjatë rezultoi në theksimin e mospërputhjeve të maturitetit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve në vitin 2017. Depozitat e ndërmarrjeve e posaqërisht të ekonomive familjare janë burim i financimit të aktivitetit të rritur kreditor të bankave. Mospërputhjet e afateve të maturimit ndërmjet investimeve dhe financimit po rriten në kushtet kur depozitat e transferueshme janë rritur dhe afatet e maturimit të kredive janë zgjatur, lëvizje kjo që rritë ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit.


Hendeku kumulativ i likuiditetit u zgjerua në 463.8 milionë euro nga 405.1 milionë euro një vit më parë. Në këtë rezultat ka ndikuar rritja e hendekut pozitiv ndërmjet aseteve dhe detyrimeve me afat

Figura 91. Indikatorët e likuiditetit



Burimi: BQK (2018)

Figura 92. Rezervat e likuiditetit




Burimi: BQK (2018)

³⁷ Teprica e likuiditetit karakterizohet me efekte të sezonalitetit. Tendanca për rritje të nivelit të rezervave të tepërta të likuiditetit vërehet gjatë muajve të tremujorit të tretë dhe në muajin dhjetor të viteve përkatëse. Teprica e rezervës në tremujorin e tretë të këtij viti ishte për 44.0 përqind më e lartë se në tremujorin e dytë, ndërsa në dhjetor teprica ishte për 43.4 përqind më e lartë se në muajin nëntor.

maturimi 1-5 vite, vlera e të cilit shënon 1.1 miliardë euro. Rreth 36.4 përqind e gjithsej asetëve kategorizohen në afatin '1-5 vite' në raport me detyrimet e këtij afati që përbëjnë vetëm 9.3 përqind të gjithsej detyrimeve.

Hendeku negativ rezulton vetëm në afatin e maturimit '1-7 ditë', vlera e të cilit qëndron në -1.7 miliardë euro. Në këtë kategori të afatit të maturimit bëjnë pjesë 72.3 përqind e gjithsej detyrimeve, ndërsa asetet konsistojnë 18.8 përqind. Rrjedhimisht mospërputhjet e afateve të maturimit të zërave bilancor janë më të theksuarat në kategoritë e maturimit '1-7 ditë' dhe '1-5 vite' (figura 93). Kjo situatë paraqet sfida për menaxhimin e likuiditetit të bankave dhe në të ardhmen mund të kufizoj mundësitë në favor të kreditimit afatgjatë.

Figura 93. Hendeku i likuiditetit*



6.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza stress-test³⁸

Sipas rezultateve nga testi i goditjeve në portfolion kreditor, pozita kapitale e sektorit bankar paraqitet përgjithësisht e qëndrueshme, me shumë pak ndjeshmëri edhe ndaj skenarit të rëndë ku është supozuar situatë ekstreme e përkeqësimit të ekonomisë (tabela 5). Gjithsesi, sektori bankar rezulton profitabil dhe me provizione mjaftueshëm të ndara për mbulimin e humbjeve që rezultojnë nga rritja e kredive jo performuese nën situatat e supozuara të goditjeve në ekonomi. Në skenarin e moderuar dhe të rëndë ku supozohet se normat e interesit do të rriten, e që kryesisht do të afektonin kreditë dhe depozitat (për shkak të pjesëmarrjes së lartë të tyre në bilancin e gjendjes), vetëm disa banka të vogla do të pësonin humbje, përderisa sektori do të paraqitej stabil. Megjithatë, këtu ekziston rreziku se në kohë krize mundësia për ri-investimin e mjeteve të maturuara kufizohet dhe në të njëjtën kohë rritet rreziku i mbingarkesës së huamarrësve me interes më të lartë, mirëpo ky rrezik nuk është marrë parasysh në analizën stres test.

Rezultatet nga testi i goditjeve në pozitën e likuiditetit sugjerojnë se sektori bankar posedon kapacitet financiar për të përballuar situatat e supozuara të tërheqjes së një shume të konsiderueshme të depozitave. Në të gjithë skenarët e supozuar, pozita e likuiditetit e shumicës së bankave rezulton e qëndrueshme (tabela 5).

6.6.1 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve makroekonomike dhe financiare në portfolion kreditor dhe pozitën kapitale

Analiza stres-test për rrezikun kreditor ka vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar për periudhën e ardhshme një vjeçare ndaj tronditjeve të mundshme në portfolion kreditor si dhe në pozitën kapitale, të cilat mund të paraqiten nga zhvillimet e pafavorshme makroekonomike. Analiza është realizuar përmes aplikimit të tri skenarëve: skenarit bazë, të moderuar dhe atij të rëndë (tabela 5).

³⁸ Stress Test nuk përfaqëson një model parashikimi, por përmban skenarë të supozuar të goditjeve makroekonomike dhe financiare me qëllim të matjes së rezistencës së sektorit bankar ndaj këtyre goditjeve negative, pa paragjykimë që situata të tilla mund të ndodhin apo priten të ndodhin në të ardhmen.

Tabela 5. Supozimet për skenarët e rrezikut kreditor

Indikatorët	Skenari bazë	Skenari i moderuar	Skenari i rëndë
	Supozimet		
BPV (norma e rritjes reale, %)	4.5	0.5	-2.5
Kredia (norma e rritjes së kreditimit, %)	10.0	5.0	0.0
Ndryshimi në normë të interesit në pozicionet neto të bilancit me ndjeshmëri ndaj NI (pp.)	n/a	+ 1 pp.	+ 2 pp.
Devaluimi i EUR ndaj valutave tjera (pp.)	n/a	10	20
Tronditjet në profit: Profitit * (1 - marzhi reduktues%)	n/a	50	60

Burimi: BQK (2108)

Skenari bazë mbështetet në zhvillimet makroekonomike të pritshme. Në këtë skenar, aktiviteti ekonomik në vend parashikohet të ketë një rritje pozitive prej 4.5 përqind. Rritja ekonomike supozohet se do të shoqërohet me rritje të lartë dyshifrore të kreditimit dhe njëkohësisht do të ndikojë në përmirësim e portfolios kreditorë³⁹ (tabela 5 dhe 6). Po ashtu këto zhvillime pritet që të përmirësojnë tutje performancën e sektorit bankar në aspektin e kapitalizimit.

Tabela 6. Koeficienti i elasticitetit të normës së KJP-ve

Përshkrimi	Elasticiteti	Reagimet e normës së KJP-ve		
		Skenari bazë	Skenari i moderuar	Skenari i rëndë
Rritja reale e BPV-së (%)	-0.56 pp	-2.52 pp		
Zgjerimi i hendekut të prodhimit	0.80 pp		2.56 pp	4.96 pp
Rritja e normës së interesit në kredi (pp)	0.20 pp		0.20 pp	0.40 pp

Burimi: BQK (2018)

Megjithatë, profiti është supozuar të mbetet pothuajse i njëjtë me këtë vit mbi arsyetimin se ë hyrat nga interesi në kredi mund të rriten nga efekti i rritjes së vlerës së kredisë por ky efekt mund të kufizohet nga presionet e vazhdueshme për rënie të normave të interesit në kredi, ndërsa të hyrat nga jo-interesi nuk priten që të vazhdojnë të rriten për shkak të hapësirës së kufizuar për rritje të mëtejme të tarifave dhe komisioneve. Në anën tjetër shpenzimet e jo-interesit priten të bien për shkak të zvogëlimit të nevojës për provizione shtesë si rezultat i përmirësimit të portfolios kreditorë, por shpenzimet e interesit mund të rriten për shkak të presioneve të konkurrencës për rritje të normave të interesit në depozita. Rrjedhimisht efektet e rritjes dhe rënies së përbërësve të profitit do ta përjashtojnë njëra tjetrën duke na lënë të supozojmë se profiti mbetet afër nivelit të vitit aktual. Në këtë skenar nuk është përfshirë rreziku që vie nga tregu. Kjo duke u bazuar në deklaratimet nga bankat se normat e interesit në kredi pritet që të bien lehtësisht⁴⁰, ndërsa norma e interesit në asete tjera, që kryesisht ndikohen nga vendimet e BQE-së, si interesi mbi depozitat që mbahen në bankat evropiane,

³⁹ Efekti i rritjes ekonomike në cilësinë e portfolios kreditorë do të llogaritet përmes një koeficienti të elasticitetit të kredisë jo-performuese ndaj BPV-së prej 0.56 pikë përqindje. Koeficienti është matur në bazë të modelit empirik Vector Error Correction, me seri kohore nga viti 2006 deri në dhjetor 2017. Rezultati i modelit ka sygjyeruar se një rritje e BPV-së reale me 1% do të ulë raportin e kredisë jo performuese me 0.56 pikë përqindje.

⁴⁰ Anketa e kreditimit bankar.

kanë dhënë sinjale se nuk do të zvogëlohen tutje. Prandaj në këto kushte është supozuar që normat e interesit do të mbahen të njëjta me vitin aktual.

Rezultatet në bazë të këtyre supozimeve sugjerojnë për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së portfolios kreditore. Raporti i kredive jo performuese do të zbriste në 0.6 përqind nga niveli aktual prej 3.1 përqind. Pozita kapitale po ashtu do të përforcohej si rezultat i rritjes së kreditimit dhe performimit të kredive, ku TMK (Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit) e sektorit do të ngritet në 22.6 përqind nga niveli aktual prej 18.0 përqind (figura 94 dhe tabela 6⁴¹).


Në skenarin e moderuar supozohet se në vitin 2018 do të ketë rritje ekonomike prej 0.5 përqind, që është shumë më e ngadalësuar se viti 2017 (tabela 6). Ngadalësimi i rritjes ekonomike mendohet se do të ketë efekte dekurajuese, duke shkaktuar mosshfrytëzim të kapaciteteve, rrjedhimisht zgjerim të hendekut të prodhimit.⁴² Rritja e ngadalësuar ekonomike do të shoqërohet edhe me tkurrje të rritjes së kreditimit, zhvlerësim të valutës euro kundrejt valutave të tjera e aplikuar në pozicionet neto në valutë dhe rritje të normës së interesit e aplikuar në hendekun e bilancit të gjendjes më ndjeshmëri ndaj normave të interesit (Δ Të hyrat neto nga interesi = Hendekui \times Δ NI).

Këto zhvillime do ta përkeqësojnë deri në një masë cilësinë e portfolios kreditore dhe performancën e sektorit. Nën ndikimin e këtyre supozimeve, raporti i kredive jo performuese të sektorit do të rritet për 2.76 pikë përqindje, apo në nivelin 5.8 përqind nga niveli aktual 3.1 përqind. Humbjet e sektorit do të arrinin vlerën prej 23.3 milionë euro (figura 95). Këto humbjet do t'i ngarkohen direkt kapitalit, që si rezultat do ta zbrisnin treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në 17.8 përqind për vitin 2018 (figura 94). Në nivel të bankave individuale,

dy banka do të përballëshin me probleme kapitalizimi, TMK e të cilave do të zbriste në 10.2 përqind dhe 6.9 përqind, respektivisht, që është nën minimumin rregullator. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të arrijnë vlerën prej 9.9 milionë euro (tabela 6). Këto dy banka nuk kanë rëndësi të përgjithshme sistematike dhe veprojnë si degë të bankave amë, që sipas rregullativës në fuqi, kërkesat minimale për kapital janë të kufizuara në bazë të kapitalit të bankave përkatëse amë, prandaj edhe interpretimi i rezultateve për këto banka merret më i rezervuar.


Në skenarin e rëndë është vlerësuar ndjeshmëria e sektorit bankar ndaj zhvillimeve negative ekstreme makroekonomike dhe financiare, që zakonisht karakterizohet me përkeqësim të

Figura 94. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit, sipas skenarëve



Burimi: BQK (2018)

Figura 95. Rezultatet e stress testit për rrezikun kreditor-humbjet dhe rikapitalizimi



Burimi: BQK (2018)

⁴¹ Një bankë që operon si degë e bankës së huaj ka nivel aktual të kapitalit nën 12 përqind. Për degët e bankave amë, sipas rregullativës në fuqi, kërkesat minimale për kapital janë të kufizuara në bazë të kapitalit të bankave përkatëse amë

⁴² Ndikimi i këtyre zhvillimeve në cilësinë e portfolios kreditore është llogaritur përmes koeficientit të elasticitetit të kredive jo-performuese ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8pp. Material kërkimor i FMN-së, i papublikuar, 'CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise', Korrik 2009.

investimeve, dekurajim të kërkesës së brendshme, rënie të të ardhurave, dobësim të aftësisë paguese të huamarrësve. Ky skenar është realizuar duke aplikuar supozimin së rënia ekonomike do të jetë 2.5 përqind, dhe kjo rënie do të reflektohej në përkeqësimin e cilësisë së portfolios kreditorë, e llogaritur në bazë të koeficientit të reagimit të normës së KJP-ve ndaj hendekut të prodhimit.⁴³ Si pasojë e tronditjeve në sektorin real, është supozuar që kreditimi nuk do të shënojë rritje në vitin vijues. Zhvlerësimi i valutës euro ndaj valutave tjera është supozuar më i lartë se në skenarin e moderuar. Po ashtu në këtë skenar është supozuar rritje më e lartë e normave të interesit në pozicionet bilancore, se në skenarin e moderuar (tabela 7). Praktikrat dëshmojnë se në kohë krize reagimi fillestar i kreditorëve do të ishte rritja e normave të interesit për shkak të rritjes së rrezikut. Ndërsa si kundërpërgjigje kërkesa për huamarrje do të zvogëlohej për shkak të pasigurisë që krijohet për të investuar e që rrjedhimisht në fazë të mëvonshme do të krijonte presione për zvogëlim të normave të interesit me qëllim të stimulimit të aktivitetit ekonomik. Megjithatë, supozimi i rritjes së normave të interesit në këtë skenar është mbështetur në situatën aktuale të mundësive tashmë të kufizuara të sektorit bankar për zvogëlim të mëtejme të normave të interesit në burimet e financimit si dhe duke u bazuar në faktin se autoriteti monetar i unionit evropian ka dhënë sinjale se mundësia për zvogëlim të mëtejme të normave të interesit është shumë e vogël. Analiza mbështetet në gjendje statike 1 vjeçare të bilancit të gjendjes, prandaj konsiderohet se të njëjtat instrumente që maturojnë brenda një viti do të ri-investohen dhe rifinancohen me norma të interesit të supozuara në këtë skenar. Në analizë nuk konsiderohet mundësia e realizimit të kolateralit, riprogramimit të kredive apo rritja e kapitalit nga burime të tjera, duke qenë se efikasiteti dhe mundësia e realizimit të këtyre veprimeve është shumë e pasigurt në kohë krize.

Profiti supozohet se do të pësojë tronditje si rezultat i mos rritjes së kreditimit dhe rritjes së shkallës së dështimit të kredive ekzistuese. Këto supozime janë reflektuar në llogaritjen e profitit për vitin 2018 ashtu që për bazë është marrë profiti neto pas tatimit të realizuar gjatë vitit 2017, ndaj të cilit pastaj është aplikuar tronditje (marzh reduktues) prej 60 përqind dhe janë zbritur të hyrat që do të realizoheshin po qe se nuk do të rriteshin KJP-të.⁴⁴

Në skenarin e rëndë portfolio kreditorë do të përkeqësohet, ku pjesëmarrja e kredive jo performuese ndaj gjithsej kredive do të rritet për 5.36 pikë përqindje, në 8.4 përqind. Humbjet e sektorit do të arrinin vlerën prej 69.1 milionë euro. Megjithatë, niveli i lartë i provizioneve të mbajtura nga bankat individuale bën që sektori të paraqitet më rezistent ndaj goditjeve të supozuara në këtë skenar, sa i përket pozicionit të kapitalit. Niveli i kapitalizimit pas goditjes rezulton 16.5 përqind për vitin 2018, që është mjaftueshëm mbi kërkesat rregullative (figura 94). Për më tepër edhe supozimi i rritjes së normave të interesit ka dhënë efekte pozitive në të hyrat neto nga interesi, duke u mbështetur në faktin se sektori ka hendek pozitiv të bilancit me ndjeshmëri ndaj normave të interesit dhe nën supozimin se të njëjtat pozicione do të ri-investohen, atëherë si rrjedhje të hyrat e sektorit do të jenë më të larta pavarësisht efekteve të tjera negative që mund të ketë ky supozim (p.sh. rritja e kostos për huamarrësit). Efekti i zhvlerësimit të euros në të hyrat e sektorit paraqitet në nivel të ulët por pozitiv për shkak të pozicionit të hapur neto pozitiv që kishte sektori gjatë vitit aktual. Kjo do të thotë se zhvlerësimi i mundshëm i euros ndaj valutave tjera do të sillte të hyra më të larta ngase vlera neto ekuivalente në euro do të rezultonte më e lartë.

Në nivel të bankave individuale, dy banka që nuk janë me rëndësi të përgjithshme sistemike dhe veprojnë si degë të bankave të huaja, do të përballëshin me probleme kapitalizimi, TMK e të cilave do të ju zbriste në 8.7 përqind dhe 6.1 përqind, respektivisht. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të ishin gjithsej 14.2 milionë euro (figura 95).

⁴³ Meqenëse sensitiviteti i kredive jo-performuese ndaj BPV-së është llogaritur bazuar në të dhënat kur vendi ka pasur vetëm periudha të rritjes ekonomike, kjo nuk do të thotë se me të njëjtën magnitudë do të reagoje norma e KJP-ve në rrethana të rënies ekonomike. Prandaj në skenarin e rëndë ku është supozuar rënie ekonomike, sensitiviteti i KJP-ve është bazuar në koeficientin e reagimit ndaj hendekut të prodhimit dhe jo ndaj BPV-së.

⁴⁴ Vlerësimi i të hyrave të 'humbura' si pasojë e rritjes së KJP-ve është bërë fillimisht duke llogaritur ex-post normën e përgjithshme të interesit në kredi për secilën bankë, e cila më pastaj është shumëzuar me vlerën e shtuar të KJP-ve.

Skenari i rrezikut nga dështimi i ekspozimeve të mëdha kreditore: në këtë skenar është vlerësuar qëndrueshmëria e bankave ndaj dështimit të mundshëm të tre dhe pesë kredi marrësve më të mëdhenj. Supozimi i dështimit të tre kredi marrësve më të mëdhenj do të ndikonte që niveli i kapitalizimit në nivel sektori të bie në 13.9 përqind dhe humbja të arrijë në 137.3 milionë euro. Dy banka që veprojnë si degë të bankave të huaja⁴⁵ do të përballëshin me humbje të larta, TMK e të cilave do të binte në nivele negative. Kjo do të thotë se këto dy banka duhet të sigurojnë 83.9 milionë euro për të arritur kapitalin në nivelin e kërkuar. Dështimi i pesë kredi marrësve më të mëdhenj do ta përkeqësonte edhe më tej gjendjen në këto dy banka si dhe një bankë me rëndësi të përgjithshme sistematike do të paraqitej e nën-kapitalizuar. Humbjet do të arrinin në gjithsej 186.1 milionë euro dhe TMK e sektorit do të zbriste në kufirin rregullator, në 12.0 përqind. Të tri bankave të nën-kapitalizuara do të ju nevojiteshin 114.9 milionë euro shtesë për ngritje të kapitalit (figura 95 dhe tabela 7). Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori nuk ka përqendrim të lartë të ekspozimeve kreditore, mirëpo mund të thuhet që degët e bankave të huaja ndikojnë dukshëm në rritjen e shkallës së ekspozimeve të mëdha kreditore të gjithsej sektorit.

Tabela 7. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik kreditor

Përshkrimi	Numri i bankave me TMK<12%	Norma e kapitalizimit			Norma e KJP-ve			Mjetet shtesë të nevojshme për rikapitalizim (në mijëra euro)
		niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	
Nivelet aktuale (para goditjeve)		152.3	10.2	18.0	4.6	0.6	3.1	
Rezultatet e skenarëve								
Skenari bazë: Rënia e KJP për 2.52pp, rritja e kreditimit për 13%		142.2	10.8	22.6	2.1	(2.5)	0.6	
Skenari i moderuar: Rritja e NPL për 2.72pp, ngadalësimi i rritjes vjetore të kreditimit për 5pp., rritja e normës së interesit për 1pp. e aplikuar në hendekun e bilancit me ndjeshmëri ndaj NI, përshtatja e pozicioneve në valutë në bazë të devalvimit të EUR për 10pp.	2	148.8	6.9	17.8	7.4	2.8	5.8	9,882.9
Skenari i rëndë: Rritja e NPL për 5.32pp, stagnimi i kreditimit, rritja e normës së interesit për 2pp. e aplikuar në hendekun e bilancit me ndjeshmëri ndaj NI, përshtatja e pozicioneve në valutë në bazë të devalvimit të EUR për 20pp.	2	157.6	6.1	16.5	10.0	5.4	8.4	14,196.6
Dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenj	2	149.8	(23.9)	13.9	50.7	0.6	11.2	83,898.3
Dështimi i pesë kredimarrësve më të mëdhenj	3	149.8	(37.3)	12.0	69.5	0.6	13.5	114,947.0

Burimi: BQK (2018)

6.6.2 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve në pozitën e likuiditetit

Testi i qëndrueshmërisë së pozitës së likuiditetit të sektorit bankar ka për qëllim që të vlerësojë aftësinë financuese të bankave për të përballuar mungesën e likuiditetit të shkaktuar nga situatat ekstreme.

Testi është mbështetur në dy skenarë hipotetik që vlerësojnë mjaftueshmërinë e mjeteve likuide të bankave për të përballuar tërheqjet e një vlere të depozitave brenda 5 ditësh si dhe përballimin e rrezikut nga dështimi i depozitave të koncentruara. Skenarët janë mjaftë konservativ për faktin se nuk është marrë parasysh mundësia që bankat të plotësojnë një pjesë të nevojave të likuiditetit përmes burimeve të jashtme të financimit.

Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore

Në këtë skenar është konsideruar tërheqja e depozitave të ndara sipas strukturës dhe subjekteve, në nivele të ndryshme të tërheqjeve në baza ditore (tabela 8), për pesë ditë radhazi. Pas çdo dite ndahen 5% të depozitave nga depozitat e mbetura për qëllime të operimit të bankës në ditët vijuese. Kjo nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind do të përgjysmohej. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e

⁴⁵ Duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, këto banka nuk janë subjekt i rregullatave për kufizim të raportit të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë të degës bankare, por ndaj kapitalit të klasit të parë të bankave amë, prandaj edhe vlera dhe shkalla e ekspozimeve të mëdha kreditore është e lartë tek këto institucione.

shndërrimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, ndërsa e mjeteve jo-likuide do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës.

Tabela 8. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit

Tërheqja e depozitave	Supozimet për tërheqjet kohore	Niveli i tërheqjes së depozitave
Ekonomitë familjare - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Ndërmarrjet - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	9.0%
Subjektet e tjera - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Depozitat e kursimit	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Depozitat e afatizuara	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Pesë depozitorët më të mëdhenj	Brenda ditës	100.0%
Njëzet depozitorët më të mëdhenj	Brenda ditës	100.0%

Burimi: BQK (2018)


Këto nivele të supozuara të tërheqjeve ditore janë bazuar në eksperiencat e sektorit bankar të vendeve të rajonit, të cilat kanë përjetuar situatat të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave, si pasojë e pasigurive në masë të shkaktuara nga destabiliteti politik dhe rrethana të krizave të tjera financiare të ndodhura në periudha të ndryshme. Prandaj, përderisa Kosova nuk ka historik të ngjarjeve të tilla, bazuar në praktikat e vendeve të rajonit është supozuar që në situata krize ky nivel i tërheqjeve do të mund të materializohej.

Rezultatet e skenarëve sugjerojnë që bankat do të mund të përballonin tërheqjen e depozitave sipas niveleve të përcaktuara, në baza ditore deri në ditën e tretë. Në ditën e tretë probleme me likuiditet do të paraqiteshin në një bankë në vlerë 3.0 milionë euro. Pas ditës së katërt të tërheqjeve, edhe dy banka të tjera do të kishin probleme likuiditeti, duke përfshirë këtu një bankë me rëndësi të përgjithshme sistemike. Vlera e mjeteve likuide në mungesë për këto tri banka do të arrinte në 29.3 milionë euro. Ndërsa situata do të përkeqësohej pas ditës së pestë ku numri i bankave me mungesë të mjeteve do të rritej në shtatë, dy nga të cilat janë me rëndësi të përgjithshme sistemike (figura 96). Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në sektorin bankar në ditën e pestë do të arrinte në 38.4 përqind, dhe mungesa e mjeteve likuide në këto gjashtë bankat do të arrinte në 103.6 milionë euro (tabela 8).

Skenari 2: Tërheqja e depozitave nga depozitarët më të mëdhenj

Pozita e likuiditetit të bankave rezulton të jetë në gjendje që të përballojë humbjet nën supozimet e skenarit mbi tërheqjet e mundshme të depozitave nga pesë depozitarët më të mëdhenj në secilën bankë. Ndërsa nën supozimin se njëzet depozitarët më të mëdhenj të secilës bankë do të tërheqin depozitat e tyre brenda ditës, atëherë gjendja e likuiditetit do të dobësohej në dy banka. Mungesa e mjeteve për këto dy banka do të arrinte në 6.2 milionë euro (figura 97). Rezultatet e këtij skenari

Figura 96. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -Skenari 1



Burimi: BQK (2018)

përgjithësisht sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimit të financimit, që janë depozitat si përbërës kryesor i detyrimeve.

6.6.2.1 Niveli përbalues i tërheqjes së depozitave para se pozita e likuiditetit të arrijë nivelet kritike

Problemet me likuiditet për tërë sektorin bankar do të paraqiteshin në rast të tërheqjes së 24.8 përqind të depozitave brenda ditës, që nënkupton se sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e afër një të katërtës (1/4) së gjithsej depozitave pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë (figura 97 dhe tabela 9). Ndërsa në nivel të bankave, banka me pragun më të ulët të tërheqjeve qëndron në 16.0 përqind, ndërsa banka me më të lartin në 57.0 përqind (si rezultat i nivelit të lartë të mjeteve likuide që posedon kjo bankë).

Figura 97. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit - Skenari 2




Tabela 9. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit

Rezultatet e skenarëve të rrezikut kreditor	Numri i bankave me mungesë të mjeteve likuide	Niveli i depozitave të tërhequra (%)	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Raporti Kredi/Depozitë
Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore në fund të ditës së pestë	7	-38.4%	(103,568.9)	129.4%
Skenari 2.1: Tërheqja e depozitave nga 5 depozitorët më të mëdhenjë	0	-9.0%	-	87.7%
Skenari 2.2: Tërheqja e depozitave nga 20 depozitorët më të mëdhenjë	2	-14.4%	(6,237.4)	93.2%
Pragu - Tërheqja e depozitave deri në nivelin kritik të likuiditetit		-24.8%	(2,415.7)	106.1%

Burimi: BQK (2018)

7. Institucionet financiare jo-bankare

7.1 Sektori Pensional

Aktiviteti i sektorit pensional


Ecuria pozitive e kontributeve të reja dhe kthimi bruto në investimet e aseteve nga ana e fondeve ndikuan që ky sektor të rritet gradualisht ndër vite. Vlera e aseteve të sektorit pensional u karakterizua me një rritje vjetore prej 16.0 përqind, duke arritur në 1.65 miliardë euro (figura 98). Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) përfaqëson pjesën më të madhe të aseteve të sektorit (99.5 përqind), ndërsa pjesa e mbetur menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Arkëtimet e reja shënuan rritje vjetore prej 5.4 përqind, vlera e të cilave arriti në 160.3 milionë euro nga rreth 49,6 mijë kontribuues të rinj këtë vit (figura 99).

Struktura e aseteve të FKPK-së vazhdon të dominohet nga investimet në tregun e jashtëm, të cilat kryesisht mbahen në formë të fondeve të përbashkëta, të cilat diversifikojnë rrezikun përmes investimit në aksione dhe bono të thesarit të qeverive të huaja. Deri në dhjetor 2017, portfolio investuese në tregjet e huaja u rrit për 13.4 përqind, e që i atribuohet performancës dhe kthimit në investime më të mirë në tregjet ndërkombëtare të aksioneve në të cilat investon fondi.

Investimet jashtë vendit ulën lehtësisht pjesëmarrjen në 89.8 përqind (91.9 përqind në dhjetor 2016), ndërsa investimet brenda vendit rritën pjesëmarrjen në 10.2 përqind (8.1 përqind në dhjetor 2016) (figura 99). Në kuadër të investimeve brenda vendit, pjesëmarrja nga letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës u zhvendos drejt mbajtjes së certifikatave të depozitit në banka komerciale. Pesa e letrave me vlerë zbriti në 56.8 përqind (68.5 përqind në dhjetor 2016), ndërsa e certifikatave të depozitit u rrit në 30.2 përqind (17.4 përqind në dhjetor 2016). Niveli i investimeve në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës përveç se varet nga kërkesa, varet edhe nga shumica e ofruar e Qeverisë si dhe nga konkurrenca në ankande. Prandaj në varësi të këtyre faktorëve si dhe strategjisë investuese të FKPK-së, mund të arsyetohet deri në një masë ecuritë në investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Në dhjetor 2017, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 7.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.8 përqind (12.6 përqind në dhjetor 2016). Arkëtimet e reja, arritën vlerën në 502.4 mijë euro nga 3,002 kontribuues të rinj, që përkon me një rritje vjetore prej 1.2 përqind, megjithëse më të ngadalësuar se në vitin paraprak që kishte rritje prej 7.6 përqind (figura 100).


Figura 98. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK (2018)

Vlera e të cilave arriti në 160.3 milionë euro nga rreth 49,6 mijë kontribuues të rinj këtë vit (figura 99).

Figura 99. Struktura e investimeve të sektorit pensional



Burimi: BQK (2018)


Pjesa më e madhe e aseteve të FSKP-së vazhdon të investohet jashtë vendit me 87.1 përqind të gjithsej aseteve. Strategjia investive jashtë vendit përqendrohet kryesisht në formë të aksioneve (78.9 përqind), letrave me vlerë (17.5 përqind), letrave komerciale (1.6 përqind) dhe para të gatshme (2.0 përqind). Në anën tjetër, strategji tjetër u ndoq për investimet në Kosovë, të cilat zvogëluan pjesëmarrjen e tyre në 12.9 përqind, nga 17.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Mundësitë e investimit në tregun e brendshëm janë deri diku të kufizuara andaj edhe investimet janë të shpërndara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (69.7 përqind), depozita (25.6 përqind) dhe para të gatshme (4.7 përqind).

7.1.1 Performanca financiare e sektorit pensional

Sektori pensional shënoi performancë pozitive financiare në vitin 2017 si rezultat i kthimit pozitiv në investime, rritjes së kontributeve të reja dhe rritjes së çmimit të aksionit të sektorit. Kthimi në investime i FKPK-së në dhjetor 2017 arriti vlerën 102.6 milionë euro, që është për 38.0 milionë euro më i lartë se në vitin paraprak (figura 101).


FKPK mbylli ditën e fundit të vitit 2017 me çmim më të lartë të aksionit krahasuar me vitin paraprak. Më saktësisht, çmimi i aksionit arriti në 1.465 euro në krahasim me 1.376 euro në dhjetor 2016. Performanca e investimeve të aseteve të ndërmarra nga sektori pensional u ndikua nga luhatjet pozitive si rezultat i lehtësirave fiskale dhe rritjes së BPV-së përtej parashikimeve, e që rrjedhimisht ndikuan pozitivisht në tregjet financiare në SHBA. Ndërsa, tregu i obligacioneve qeveritare në eurozonë gjatë tremujorit të katërt u karakterizua me rënie të normave të interesit. Ky zhvillim u ndikua nga vendimi i BQE-së për të vazhduar programin e lehtësimit sasior edhe gjatë vitit 2018 por në vlerë të reduktuar, përkundër që Eurozona përjetoi rritjen më të shpejtë ekonomike në dekadën e fundit. Megjithatë, zhvillimet pozitive në SHBA dhe strategjia investuese ndikuan në performancë të mirë të sektorit pensional, duke siguruar rritje të vlerës së kthimit në investime.

Figura 100. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale




Burimi: BQK (2018)

Figura 101. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës



Burimi: BQK (2018)

Figura 102. Performanca financiare e Fondit Sllveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK (2018)

Ngjashëm, edhe FSKP shënoi kthim pozitiv nga investimet mirëpo më të ulët se sa vitin paraprak. Në dhjetor 2017, kthimi bruto nga investimet arriti në 528.5 mijë euro, që është për 176.2 mijë euro më i ulët se kthimi i regjistruar një vit më parë (figura 102). Ndërsa, çmimi i aksionit të FSKP-së në ditën e fundit të vitit 2017 ishte më i lartë se vitin paraprak, 1.655 euro krahasuar me 1.584 euro në vitin 2016.


7.2 Sektori i Sigurimeve

7.2.1 Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Ngjashëm me sektorin bankar, sektori i sigurimeve u karakterizua me rritje të aktivitetit dhe profitabilitetit në periudhën raportuese. Megjithatë, krahasuar me rajonin dhe vendet e BE-së, sektori i sigurimeve mbetet në fillimet e zhvillimit, duke reflektuar potencial për zhvillim të mëtutjeshëm.

Me një pjesëmarrje prej 3.0 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, pjesëmarrje pothuajse e pandryshuar në pesë vitet e fundit, sektori i sigurimeve është sektori i katërt për nga madhësia. Niveli i ndërmjetësimit prej 1.4 përqind (primet e shkruara bruto në raport me BPV-në) vlerësohet si relativisht i ulët⁴⁶, indikator ky që mbeti pothuajse i pandryshuar në tre vitet e fundit kryesisht si rezultat i rritjes më të lartë të BPV-së kundrejt primeve të shkruara të sektorit të sigurimeve. Ndërsa, niveli i densitetit, që paraqet primet e shkruara për kokë banori, është karakterizuar me rritje (figura 103).

Figura 103. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK (2018)

Ndërlidhja në mes sektorit të sigurimeve dhe segmenteve tjerë të sistemit financiar është ende në nivel të ulët, gjë që minimizon mundësitë e shpërndarjes së rreziqeve në segmentet tjerë të sistemit financiar të Kosovës. Ndërlidhja më e lartë e sektorit të sigurimeve qëndron me sektorin bankar, për shkak që 52.5 përqind e aseteve të këtij sektori gjenden në bankat komerciale në formë të depozitave.

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e sigurimit 'jo-jetë' i cili përfaqëson 87.8 përqind të aseteve të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga asetet e kompanive të sigurimit 'jetë'. Strukturë kjo e kundërt me strukturën e sektorit të sigurimeve në vendet anëtare të BE-së. Numri i kompanive të sigurimit mbeti i pandryshuar, i cili deri në dhjetor 2017 ishte 15, prej të cilave 12 janë kompani të sigurimit jo-jetë dhe 3 kompani të sigurimit 'jetë'.

Figura 104. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë (Dhjetor 2017)



Burimi: BQK (2018)

⁴⁶ Në BE, ky tregues qëndron në rreth 9 përqind, sipas Autoritetit Evropian për Sigurime dhe Pensione (EIOPA). EIOPA – Raporti i Stabilitetit Financiar_Qershor 2018


Kompanitë me pronësi të huaj vazhdojnë të dominojnë tregun e sigurimeve, 8 nga kompanitë kanë pronësi të huaj dhe 4 prej tyre vendore. Pjesëmarrja e aseteve të menaxhuara nga kompanitë e sigurimeve me pronësi të huaj arriti në 54.3 përqind të gjithëj aseteve nga 50.2 përqind një vit më parë. Sa i përket origjinës së pronësisë së huaj, 24.8 përqind e aseteve të sektorit janë në menaxhim të katër institucioneve me origjinë nga Shqipëria. Nga Sllovenia veprojnë dy kompani të cilat menaxhojnë 16.0 përqind të aseteve të sektorit. Ndërsa me pronësi shumicë nga Austria veprojnë dy kompani të cilat menaxhojnë 13.6 përqind të gjithëj aseteve të sektorit (figura 104).

Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve mund të konsiderohet e ulët, sidomos në krahasim me shkallën e koncentrimit të tregut bankar. Indeksi Herfindahl-Hirschman i kalkuluar për asetet e kompanive të sigurimeve rezulton 770 pikë në dhjetor 2017 (774 pikë në dhjetor 2016). Shprehur përmes pjesëmarrjes së tri kompanive më të mëdha në gjithëj asetet e sektorit të sigurimeve, shkalla e koncentrimit qëndroi në 31.6 përqind, një nivel i ngjashëm me vitin paraprak.

Asetet e sektorit të sigurimeve arritën vlerën 176.8 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 9.3 përqind (figura 105). Asetet e kompanive të sigurimeve 'jo-jetë' u rritën për 6.7 përqind (5.6 përqind në dhjetor 2016), përderisa asetet në kuadër të sigurimit 'jetë' shënuan rritje vjetore prej 31.5 përqind (8.3 përqind në dhjetor 2016).


Ambienti i normave të ulëta të interesit në letrat me vlerë të Kosovës dhe politikat konservative për investimin e aseteve nuk kanë qenë në favor të ndryshimit të strukturës së aseteve të sektorit të sigurimeve, strukturë që mbetet e dominuar nga paraja e gatshme dhe depozitat. Rrjedhimisht në dhjetor 2017, pesha e tyre qëndroi në nivel të ngjashëm me vitin e kaluar prej rreth 55.2 përqind të gjithëj aseteve. Kjo strukturë e aseteve sugjeron se aktivi i kompanive të sigurimeve përmban përqindje të lartë të aseteve me likuiditet të lartë. Përderisa, struktura e investimeve të kompanive të sigurimit, e cila vazhdon të jetë konservative, përbëhet nga investimet në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës e të cilat zvogëluan pjesëmarrjen në 11.9 përqind nga 12.4 përqind në dhjetor 2016 (figura 106). Kthimi i ulët nga letrat me vlerë, si pasojë e normave të ulëta të interesit, zvogëlon motivimin e kompanive të sigurimit kundrejt investimit të aseteve në instrumentet financiare në fjalë.

Figura 105. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK (2018)

Figura 106. Struktura e aseteve të sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK (2018)

Në kuadër të detyrimeve dhe burimeve vetanake, rezervat teknike kryesojnë strukturën e përgjithshme. Vlera e rezervave teknike (pjesëmarrje prej 64.3 përqind) ishte më e ulët për 5.7 përqind krahas vitit paraprak (figura 107). Performanca pozitive, rrjedhimisht fitimi i realizuar gjatë vitit 2017 po ashtu rritja e kapitalit aksionar në këtë sektor ndikoi që kapitali vetanak të jetë për 55.8 përqind më i madh se sa në vitin paraprak. Në kuadër të detyrimeve, rritja e llogarive të pagueshme prej 22.6 përqind u reflektua në rritje të theksuar të detyrimeve tjera.

Vlera e gjithsej primeve të shkruara të sektorit deri në dhjetor 2017 arriti në 86.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.9 përqind. Struktura e primeve të shkruara dominohet nga primet e sigurimit 'jo-jetë' të cilat përfaqësojnë 97.1 përqind të gjithsej primeve të shkruara. Në dhjetor 2017, këto prime arritën vlerën 84.2 milionë euro, një rritje vjetore prej 4.1 përqind. Pjesa e mbetur prej 2.9 përqind e gjithsej primeve të shkruara përbëhet nga primet e sigurimit 'jetë', të cilat shënuan rënie vjetore prej 3.4 përqind (figura 108).

Figura 109. Struktura e primeve bruto të shkruara



Burimi: BQK (2018)

Produkti i cili dominon tregun e sigurimeve vazhdon të mbetet ai i Përgjegjësive ndaj Palës së Tretë, duke mos reflektuar ndryshim të theksuar të strukturës së gjithsej primeve të shkruara në sektor. Kategoria e Përgjegjësive ndaj Palës së Tretë (PPT) gjatë vitit 2017 kishte një pjesëmarrje prej 53.3 përqind të gjithsej primeve, megjithëse kishte një rënie marginale prej 0.3 pikë përqindje në peshën e kësaj kategorie në gjithsej primet e shkruara (figura 109). Pothuajse të gjitha kategoritë e primeve shënuan rritje në vitin 2017.

Figura 107. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve






Figura 108. Primet bruto të arkëtuara



Burimi: BQK (2018)

Figura 110. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2018)

Prej tyre rritjen më të lartë e shënoi kategoria PPT+ prej 15.7 përqind, primet për sigurimet 'kasko' shënuan rritje prej 11.2 përqind, aksidentet personale dhe shëndeti 4.3 përqind. Përderisa, primet për dëmtimet në pasuri nga zjarri ishin kategoria e vetme e cila shënoi rënie prej 6.7 përqind.

Dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) deri në dhjetor 2017 arritën vlerën 46.0 milionë euro, një rritje vjetore prej 17.8 përqind (figura 110). Në kuadër të dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve, rritjen më të lartë e kishin sigurimet jo-jetë të ndikuara kryesisht nga rritja e dëmeve të paguara për produktin e detyrueshëm të auto përgjegjësise si dhe dëmet për dëmtimet në pasuri nga zjarri si dhe rreziqe tjera (figura 111). Përderisa, rritja e dëmeve të paguara të sigurimit jetë ishte marginale. Dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) kryesisht mbetën të ngjashme me vlerat e vitit paraprak.

Rritja më e lartë e dëmeve të paguara krahas rritjes së vlerës së primeve të shkruara rezultoi në rritje të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara e që nënkupton që më shumë se gjysma e primeve të realizuara gjatë vitit të dedikohen për mbulimin e dëmeve. Në dhjetor 2017, ky raport u rrit në 53.0 përqind krahasuar me 46.7 përqind sa ishte në dhjetor 2016.


7.2.2 Performanca financiare e sektorit të sigurimeve

Rritja e të hyrave neto nga primet kundrejt rënies së dëmeve të ndodhura dhe menaxhimit efikas të shpenzimeve rezultuan në përmirësimin e gjendjes së sektorit të sigurimeve, të karakterizuar me rezultat pozitiv financiar. Të hyrat neto nga primet të sektorit të sigurimeve gjatë vitit 2017 shënuan rritje vjetore prej 4.7 përqind, ndërsa shpenzimet operative dhe financiare shënuan rënie vjetore prej 7.1 përqind si dhe dëmet e ndodhura u zvogëluan për 47.1 përqind. Si rezultat i rënies më të theksuar të shpenzimeve dhe dëmeve të ndodhura kundrejt rritjes së të hyrave, sektori i sigurimeve këtë vit regjistroi profit neto prej 6.4 milionë euro, që paraqet përmirësim të theksuar krahasuar me humbjen prej 26.0 milionë euro të shënuar në vitin paraprak. Deri në dhjetor 2017, sigurimi 'jo-jetë' shënoi profit neto prej 6.2 milionë euro (humbje prej 26.3 milionë në dhjetor 2016), ndërsa sigurimi jetë regjistroi rënie të fitimit neto duke zbritur në 198.7 mijë euro (fitim prej 351.4 mijë euro në dhjetor 2016).

Në performancën pozitive të sektorit të sigurimeve kontribuoi rritja e pagesës së dëmeve nga disa kompani të sigurimeve 'jo-jetë', që në mënyrë direkte kanë ndikuar në zvogëlimin e provizioneve teknike, që u pasqyrua në rënien e shpenzimeve dhe realizimin e fitimit. Ndikim në rezultat pozitiv financiar kishin po ashtu masat e ndërmarra nga ana e BQK-së përmes hyrjes në fuqi të Rregullores për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia dhe menaxhimin e shpenzimeve të siguruesve në fillim të vitit 2017, e cila rezultoi të jenë efektive në zvogëlimin dhe kufizimin e shpenzimeve duke marrë parasysh rënien e shpenzimeve të të gjithë sektorit të sigurimeve gjatë këtij viti. Po ashtu, kontribut dha edhe ndryshimi në legjislacionin sekondar të BQK-së në përputhje me kërkesat ligjore, sa i përket Rregullores së Fondit të Kompensimit. Të gjithë faktorët e lartpërmendur ndikuan në zvogëlimin e shpenzimeve dhe rrjedhimisht në realizimin e profitit.

Rreziku i likuiditetit u zvogëlua për sektorin e sigurimeve kryesisht si pasojë e rritjes së vazhdueshme të aseteve likuide si komponentë dominues në strukturën e aseteve të kompanive të sigurimit. Rritja vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj prej 8.3

Figura 111. Ndryshimet në vlerën e primeve dhe dëmeve, sipas produkteve



Burimi: BQK (2018)

përqind, dhe rënia prej 5.7 përqind e rezervave teknike të sektorit të sigurimeve ndikuan në rritjen e nivelit të likuiditetit. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave u rrit në 104.3 përqind në dhjetor 2017, nga 90.7 përqind në dhjetor 2016). Po ashtu, rritja më e përshpejtuar e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj bëri që raporti ndërmjet kësaj të fundit ndaj gjithsej detyrimeve të rritet në 91.3 përqind nga 83.1 në dhjetor 2016.

Sektori i sigurimeve u karakterizua po ashtu me përmirësim të nivelit të kapitalizimit, i shprehur përmes raportit të detyrimeve në gjithsej detyrimet dhe kapitalin e sektorit. Ky raport ka rënë në 73.5 përqind në dhjetor 2017 nga 81.4 përqind një vit më parë e që nënkupton mbështetje më të ulët të sektorit në financimin e aseteve nga detyrimet e tjera dhe më shumë nga kapitali si formë më e qëndrueshme e financimit.

7.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar

7.3.1 Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar

Rritja e aseteve, kryesisht e ndikuar nga rritja e konsiderueshme e kredive të këtij sektori, rezultuan në rritje të përshpejtuar të aktivitetit të sektorit mikrofinanciar. Asetet e sektorit arritën vlerën 192.4 milionë euro në dhjetor 2017, që korrespondon me rritje vjetore prej 28.6 përqind (figura 112). Në tregun vendor operojnë 18 institucione mikrofinanciare,⁴⁷ nga të cilat 13 kanë pronësi të huaj dhe përfaqësojnë 95.6 përqind të gjithsej aseteve të sektorit.

Indeksi Herfindahl-Hirschman për asetet rezultoi me 1,489 pikë në dhjetor 2017, që paraqet rritje të koncentrimin nga periudha e njëjtë e vitit paraprak (1,398 pikë). Ndërsa, pjesëmarrja e aseteve të tri institucioneve më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit u ngrit në 55.9 përqind nga 53.2 përqind sa ishte në dhjetor 2016.

Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar dominohet nga kreditë që përbëjnë 74.8 përqind të gjithsej aseteve të sektorit. Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha janë lizingjet me pjesëmarrje prej 13.8 përqind (figura 113).

Krahas vitit paraprak, pesha e lizingjeve në gjithsej asetet e sektorit është më e ulët, përderisa pesha e kredive u rrit. Sa i përket detyrimeve, aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht nga huamarrjet të cilat përbëjnë 73.8 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit, ndërsa vetëm financimi nga sektori i jashtëm përbënë 68.0 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit. Gjatë këtij viti, huamarrjet nga sektori i jashtëm patën rritje të theksuar edhe pse më e ngadalshme në krahasim me vitin paraprak. Huamarrjet nga sektori i

Figura 112. Asetet e sektorit mikrofinanciar





Figura 113. Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar në vitin 2017



⁴⁷ Këtu përfshihen edhe pesë institucione financiare jo-bankare që kryejnë aktivitete të kredidhënies, lizingut dhe faktoringut.

jashtëm shënuan rritje vjetore prej 30.6 përqind krahasuar me 60.1 përqind në vitin paraprak, dhe arritën vlerën prej 130.9 milionë euro.

Vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në dhjetor 2017 arriti në 143.9 milionë euro, që paraqet rritje të përsheptuar vjetore prej 32.1 përqind e që është e ngjashme me rritjen e vitit paraprak. Përsheptimi i rritjes së kreditimit u mbështet nga rritja e burimit të financimit të institucioneve mikrofinanciare, kryesisht nga sektori i jashtëm dhe nga rritja e kapitalit vetanak i ndikuar nga fitimi i vitit dhe fitimi i mbajtur.

Rritja më e shpejtë e vlerës së aprovuar të kredive krahas rritjes së numrit të kredive, gjë që mund të sugjeroj për rritje të kapacitetit absorbues të huamarrësve. Ky raport në mes gjithsej vlerës së kredive ndaj numrit të kredive, i cili pasqyron shumën mesatare të kredisë së aprovuar, u ngrit në 2,966 euro në krahasim me shumën prej 2,764 euro në dhjetor 2016.


Gjatë këtij viti, institucionet mikrofinanciare u orientuan në një masë më të madhe drejt kreditimit të ndërmarrjeve. Më saktësisht, kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan normë më të lartë të rritjes prej 44.1 përqind, krahasuar me kreditë ndaj ekonomive familjare të cilat u rritën për 26.2 përqind. Megjithatë baza më e lartë e kredive ndaj ekonomive familjare kontribuoi në rritjen e gjithsej kreditimit.

Kreditë ndaj ekonomive familjare në dhjetor 2017 përfaqësuan 64.0 përqind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar. Sipas afatit të maturimit, kreditë e ekonomive familjare me afat maturimi ‘mbi 2 deri në 5 vite’ në vazhdimësi kanë rritur pjesëmarrjen dhe këtë vit përfaqësojnë 50.5 përqind të gjithsej kredive ndaj ekonomive familjare. Ngjashëm me kreditë e ekonomive familjare, kreditë e lëshuara për ndërmarrjet vazhdojnë të kenë kryesisht maturim ‘mbi 2 deri në 5 vite’, dhe për vitin e dytë me radhë dominon kreditë ndaj ndërmarrjeve (figura 114).

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Për dallim nga sektori bankar, ku kreditë për bujqësinë paraqesin kategorinë me pjesëmarrjen më të ulët, tek institucionet mikrofinanciare bujqësia gëzon mbështetjen më të madhe duke përfaqësuar 26.6 përqind të gjithsej kredive ndaj ndërmarrjeve.


Kategoritë tjera me qasje të lartë në financim mikrofinanciar janë kreditë e destinuar për shërbime tjera dhe kreditë për sektorin e ndërtimitarisë (figura 115).

Figura 114. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit



Burimi: BQK (2018)

Figura 115. Struktura e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik, dhjetor 2017



Burimi: BQK (2018)

Sa i përket ecurisë, kreditë për sektorin e shërbimeve të tjera regjistruan rritjen më të lartë vjetore. Rritje më të theksuar të kreditimit kishte edhe sektori i industrisë, ndërtimtarisë dhe tregtisë. Ndërsa, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë shënoi ngadalësim të rritjes vjetore kundrejt vitit paraprak (figura 116).


Aktiviteti i lizingut në institucionet mikrofinanciare shënoi rritje. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar u rrit në 26.6 milionë euro, një rritje vjetore prej 10.2 përqind (figura 117). Kontributin më të madh në rritjen e gjithsej lizingjeve e kishin lizingjet ndaj ekonomive familjare, vlera e të cilave ishte për 11.2 përqind më e lartë se në dhjetor 2016.

Lizingjet për ekonomitë familjare përbëjnë kategorinë kryesore me pjesëmarrje prej 52.2 përqind në strukturën e përgjithshme të lizingjeve. Në kuadër të lizingjeve për ekonomitë familjare, lizingjet hipotekare, që përfaqëson kategorinë dominuese, shënuan rritje për 8.0 përqind nga rritja prej 7.0 përqind në vitin paraprak. Lizingjet tjera po ashtu regjistruan rritje vjetore prej 44.4 përqind në krahasim me rritjen prej 19.0 përqind një vit më parë. Lizingjet për ekonomitë familjare vazhdojnë të dominohen nga lizingjet afatgjata ‘mbi 10 vite’ të cilat kanë pjesëmarrje prej 51.3 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 33.3 përqind.

Në kuadër të lizingjeve për ndërmarrjet, lizingjet tjera, të cilat edhe dominojnë lizingjet për ndërmarrjet, u karakterizuan me rritje prej 15.3 përqind, e që dhanë kontributin në rritjen e gjithsej lizingjeve të ndërmarrjeve. Përderisa, lizingjet hipotekare dhe për pajisje shënuan rënie të theksuar prej 60.9 përqind, përkatësisht 24.2 përqind kryesisht për shkak të vlerës së vogël. Sipas maturitetit të lizingjeve për ndërmarrjet, pjesën më të madhe e përbëjnë lizingjet afatmesme ‘mbi 2 deri në 5 vite’ me pjesëmarrje prej 82.0 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘deri në 1 vit’ me pjesëmarrje prej 12.6 përqind.

Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar shënoi rritje gjatë vitit, duke arritur në 22.6 përqind në dhjetor 2017 (figura 118). Me rritje të normës mesatare të interesit në kredi u karakterizuan edhe sektori i ekonomive familjare edhe ai i ndërmarrjeve.


Figura 116. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2018)


Lizingjet për ekonomitë familjare përbëjnë kategorinë kryesore me pjesëmarrje prej 52.2 përqind në strukturën e përgjithshme të lizingjeve.

Figura 117. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2018)


Figura 118. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2018)

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare u rrit në 24.2 përqind në dhjetor 2017. Ndërsa, mesatarja e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve arriti në 20.8 përqind nga (figura 118). Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve mban normën mesatare të interesit më të ulët prej 19.0 përqind. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë shënoi rritje për 0.1 pikë përqindje, e po ashtu qëndron në nivelin më të lartë në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve. Ndërsa, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë regjistroi rritje për 0.5 pikë përqindje (figura 119).

Figura 119. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2018)

7.3.2 Performanca e sektorit mikrofinanciar


Sektori mikrofinanciar u karakterizua me performancën më të mirë financiare në pesë vitet e fundit, gjë që është reflektuar në rritjen e fitimit. Në dhjetor 2017, profiti i realizuar arriti vlerën prej 7.4 milionë euro, krahasuar me profitin prej 4.0 milionë euro të vitit paraprak. Rritja e profitit ishte rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave në krahasim me rritjen që shënuan shpenzimet.

Të hyrat e sektorit mikrofinanciar shënuan rritje prej 28.8 përqind krahasuar me 18.6 përqind në dhjetor 2016, kryesisht e ndikuar nga rritja e të hyrave nga interesi. Shpenzimet po ashtu shënuan rritje prej 17.9 përqind, për dallim nga rritja prej 12.3 përqind deri në dhjetor 2016 (figura 120). Të gjitha kategoritë e shpenzimeve u karakterizuan me rritje, mirëpo kontributin më të madh në rritjen e gjithsej shpenzimeve e kishin shpenzimet nga interesi që shënuan rritje prej 35.3 përqind.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar ka shënuar përmirësim krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave të sektorit mikrofinanciar në krahasim me rritjen e shpenzimeve. Në dhjetor 2017, ky indikator u zvogëlua në 76.9 përqind, nga 83.4 përqind në vitin paraprak.

Profiti i realizuar deri në dhjetor 2017 ndikoi në përmirësimin e treguesve të profitabilitetit ku Kthimi në Mesataren e Aseteve (KMA) arriti në 4.3 përqind (2.9 përqind në vitin 2016), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) në 16.6 përqind (10.6 përqind në vitin 2016) (figura 121).

Figura 120. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2018)

Sektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kredive joperformuese. Në dhjetor 2017, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë u zvogëlua në 2.5 përqind, në krahasim me normën prej 2.9 përqind sa ishte në dhjetor 2016, si rezultat i rënies së vlerës së kredive joperformuese krahas rritjes së stokut të kredive. Mbulueshmëria me provizione u zvogëlua për 9.9 pikë përqindje, megjithatë niveli i mbulueshmërisë mbetet mjaft i lartë në 190.3 përqind krahasuar me nivelin prej 200.2 përqind në dhjetor 2016 (figura 122).


Sektori i ndihmësve financiar përbënë numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, mirëpo menaxhon pjesën më të vogël të aseteve të sistemit financiar (0.3 përqind në dhjetor 2017). Ky sektor përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Vlera e aseteve të ndihmësve financiar në dhjetor 2017 arriti në 15.8 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 24.5 përqind. Po ashtu, të hyrat e ndihmësve financiar shënuan rritje vjetore prej 30.5 përqind duke arritur në 7.6 milionë euro. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiar dominohet nga të hyrat nga transferet (pjesëmarrje 71.7 përqind në dhjetor 2017), të cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 15.3 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 53.3 përqind duke arritur në 4.5 milionë euro. Megjithatë baza më e lartë e vlerës së të hyrave ndikoi që neto fitimi të rritet në 3.1 milionë euro nga 2.9 milionë euro sa ishte në dhjetor 2016.

Figura 121. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2018)

Figura 122. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore



Burimi: BQK (2018)

8. Infrastruktura Financiare në Kosovë

8.1. Sistemi i Pagesave

Sistemet e pagesave luajnë rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi, duke marrë parasysh që funksionimi efikas dhe i sigurt i tyre paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Një ndër hapat me rëndësi që BQK ka ndërmarrë gjatë këtij viti në fushën e sistemit të pagesave është implementimi i një sistemi tërësisht të ri ndërbankar të pagesave, i quajtur ATS (Automat Transfer System/Sistem i Transferit Automatik). Ky sistem i cili nga data 1 korrik 2016 ka zëvendësuar sistemin SEKN (Sistemin Elektronik të Kliringut Ndërbankar), përbëhet nga dy komponente të cilat do të mundësojnë transferimin e fondeve në kohë reale (komponenti RTGS- Real Time Gross Settlement) dhe procesimin e pagesave në grup dhe shuma të vogla (komponenti ACH - Automated Clearing House).

Numri i transaksioneve të përpunuara nga ATS gjatë vitit 2017 arriti në 11.7 milionë (11.6 milionë në vitin 2016), duke shënuar rritje vjetore prej 1.0 përqind. Kurse, në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara arriti në 11.6 miliardë euro (10.7 miliardë euro në 2016), që paraqet një rritje vjetore prej 9.2 përqind. Pagesat prioritare masive vazhdojnë të përfaqësojnë kategorinë me pjesëmarrjen më të lartë në numrin e transaksioneve të realizuara ndërbankare (tabela 10). Këto pagesa përfaqësojnë 5.0 milionë transaksione të realizuara (apo 42.7 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa nga institucionet qeveritare (siç janë pagat dhe pensionet). Më pas vijnë pagesat masive të rregullta, që përfaqësojnë 4.2 milionë transaksione të realizuara (apo 36.0 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa në të cilat përfitues janë institucionet e qeverisë dhe përfshijnë pagesën e tatimeve, taksave, doganës etj., ndërsa 0.9 milionë janë pagesat xhiro dedikuar kryesisht pagesave të shërbimeve publike (faturat e kompanive të shërbimeve publike, institucioneve qeveritare si shërbimi doganor dhe Agjensioni Kosovar i Pronave) (tabela 10).

Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së, në përqindje

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	2016	2017	2016	2017
Të rregullta	11.2%	12.1%	22.7%	11.2%
Prioritare	0.6%	0.9%	21.0%	35.0%
Të rregullta - masive	35.2%	36.0%	6.2%	5.9%
Prioritare - masive	40.4%	42.7%	7.9%	8.1%
Pagesat giro	12.2%	7.8%	10.8%	10.2%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	8.5%	6.8%
Debitim direkt	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%
Bankë-bankë	0.0%	0.1%	22.8%	22.8%
Te kthyer	0.1%	0.3%	0.0%	0.1%

Burimi: BQK (2018)

Ndërsa sa i përket vlerës së transaksioneve, pagesat prioritare janë kategoria me pjesëmarrjen më të lartë në transaksionet e realizuara, dhe arritën vlerën në 4.1 miliardë euro, pasuar nga kategoria bankë – bankë, që arritën vlerën prej 2.7 miliardë euro në vitin 2017.

Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare⁴⁸ në dhjetor 2017 arrin në 1.97 milionë, që paraqet një rritje vjetore prej 4.9 përqind.

Llogaritë bankare E-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', kanë vazhduar të rriten. Në dhjetor 2017 numri i gjithsej llogarive E-banking ishte 301.8 mijë, duke shënuar rritje vjetore prej 30.7 përqind (tabela 11). Poashtu, numri dhe vëllimi i transaksioneve përmes shërbimit E-banking është rritur.

Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016	Dhjetor 2017
Numri i degëve bankare	45	45	45	45
Numri i nëndegëve bankare	223	210	207	183
Numri i ATM-ve	498	540	522	512
Numri i POS-ve	9,349	9,705	10,589	11,501
Numri i llogarive 'e-banking'	157,761	187,297	230,905	301,841

Burimi: BQK (2018)

Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking gjatë vitit 2017 arriti në 3.4 milionë, një rritje vjetore prej 16.9 përqind, ndërsa vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 8.5 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 26.6 përqind.

Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë rezidente me një pjesëmarrje prej 98.2 përqind. Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë 82.5 përqind të gjithsej llogarive përdërisa pjesa e mbetur prej 17.5 përqind nga llogaritë afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jo-rezidentëve dominohet nga llogaritë individuale me pjesëmarrje prej 91.8 përqind, përdërisa llogaritë afariste kanë një pjesëmarrje prej 8.2 përqind.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme u rrit për 7.7 përqind në vitin 2017. Në kuadër të kartelave, numri i kartelave me funksion debiti arriti në 926,209 kurse me funksion krediti në 164,740. Numri i kartelave të debitit u karakterizua me rritje vjetore prej 8.1 përqind, përdërisa kartelat e kreditit me rritje vjetore prej 5.3 përqind. Pjesëmarrjen më të lartë në kartelat e debitit dhe kreditit në dhjetor 2017 e kishin kartelat Visa (72.4 përqind përkatësisht 80.8 përqind), pasuar nga kartelat Master Card (25.6 përqind përkatësisht 18.6 përqind).

Infrastruktura bankare në vend është zgjeruar në kontekst të rrjetit së pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale) përdërisa numri i bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) është zvogëluar krahasuar me dhjetor 2016 (tabela 11). Përkundër zvogëlimit të numrit të bankomatëve, numri i tërheqjeve përmes ATM-ve është rritur në 13.8 milionë (12.3 milionë deri në dhjetor 2016), me një qarkullim prej 1.9 miliardë euro (1.6 miliardë deri në dhjetor 2016) (tabela 12). Rrjedhimisht, vlera e tërheqjes së parave përmes ATM-ve ndaj gjithsej transaksioneve me kartela arriti në 61.9 përqind në vitin 2017, që tregon për nivel të lartë të përdorimit të parasë së gatshme. Rritja e numrit të ATM-ve, të cilët mundësojnë depozitim të parave në llogaritë të klientëve, ka ndikuar që vlera e depozitimeve të rris pjesëmarrjen në 29.3 përqind të gjithsej vlerës së transaksioneve me kartela përmes terminaleve, nga 1.1 përqind sa ishte tri vite më parë (tabela 12).

⁴⁸ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

Tabela 12. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje

Përshkrimi	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016	Dhjetor 2017
ATM tërheqje në para të gatshme	78.9%	70.8%	63.4%	61.9%
ATM depozitime	1.1%	10.5%	26.5%	29.3%
Kredit transference nëpërmjet ATM	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Tërheqje cash në terminale POS	1.1%	1.2%	0.3%	0.2%
Pagesa me kartela në terminale POS	18.9%	17.5%	9.9%	8.5%

Burimi: BQK (2018)

Në të njëjtën periudhë, numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në терминаlet POS arriti në 7.6 milionë në vlerë prej 260.7 milionë euro. Vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela në vitin 2017 arrit në 8.5 përqind.

Kutia 5. Korniza rregullative në funksion të stabilitetit financiar

Korniza rregullative për likuidimin e bankave

Në vitin 2017 është themeluar grupi punues brenda BQK-së për propozimin e ndryshimeve në Ligjin për Banka, i cili në kapituj të veçantë do të përfshijë edhe rregullimin e procesit të likuidimit të bankave sipas Direktivës së BE-së 2014/59. Përveç ndryshimit të ligjit, do të draftohen edhe rregulloret e reja për procesin e rimëkëmbjes dhe likuidimit të bankave. Me kornizën e re rregullative do të rregullohet në mënyrë adekuate procesi i rimëkëmbjes dhe likuidimit të bankave problematike të cilat mund të kenë efekte negative në stabilitetin e sektorit financiar, ndaj dhe korniza ligjore do t'i shërbejë BQK-së si instrument shtesë në ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit. Finalizimi i kësaj kornize rregullative pritet të bëhet në një periudhë të afërt.

Korniza rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme

Gjatë vitit 2017, BQK ka filluar me projektin e rishikimit të kornizës rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme, në funksion të përditësimit të kërkesave për të përmirësuar praktikën e vlerësimit të pronave të paluajtshme nga ana e institucioneve financiare në përputhje me standardet e reja të Evropës (European Valuation Standards - EVS 2016). Në kuadër të këtij projekti, BQK është duke punuar në amandamentimin e Rregullores mbi Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, përmes të cilës do të përcaktohen kërkesat dhe standardeve minimale që duhet të zbatohen nga institucionet financiare të licencuara nga BQK-ja gjatë vlerësimit të pasurive të paluajtshme të cilat përdoret si kolateral për kreditë e lëshuara, si dhe identifikimi i transaksioneve të pasurive të paluajtshme që kërkojnë shërbimet e një vlerësuesi të licencuar.

Në kuadër të këtij projekti, gjatë vitit 2017 është filluar edhe me amandamentimin e Rregullores për Programin e Licencimit të Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme, të organizuar nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Odën Ekonomike, në funksion të adaptimit të kërkesave të nevojshme për implementimin e kontrollit të cilësisë, bazuar në standardet e reja të lartcekura, në mënyrë që të ndikohet në përmirësimin e cilësisë së vlerësimeve të pronave të paluajtshme.

Vlerësimi adekuat i pasurive të patundshme është faktorë shumë i rëndësishëm për monitorimin e rrezikut të kredisë në sektorin bankar marrë për bazë që pasuria e paluajtshme është forma mbizotëruese e kolateralit për kreditë e lëshuara, si dhe potencialin ekzistues për rritjen e kredive hipotekare. Zhvillimi i kornizës rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme si dhe rregullimin e profesionit të vlerësuesve të pronave konform standardeve ndërkombëtare pritet të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së vlerësimit të pronave, si dhe në sigurimin e informacionit për monitorimin e rrezikut kreditor si dhe vlerësimin e akumulimit të mundshëm të rrezikut sistematik.

Korniza rregullative për sistemin e pagesave me rëndësi sistematike

Qëndrueshmëria e infrastrukturës financiare është komponentë shumë e rëndësishme e sigurimit të stabilitetit financiar. Në kuadër të infrastrukturës financiare, vëmendja përqendrohet në veçanti në mbikëqyrjen e

infrastrukturës financiare me rëndësi sistemike për shkak të potencialit të saj në nxitjen e krizave sistemike dhe efekteve potenciale në mosfunksionimin e sistemit financiar dhe të ekonomisë në tërësi. Banka për Rregullime Ndërkombëtare dhe Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve për Letra me Vlerë, në vitin 2012 kanë publikuar raport me Parimet për Infstrukturat e Tregut Financiar, me të cilin janë vendosë standard të reja ndërkombëtare për sistemet e pagesave me rëndësi sistemike si dhe për komponente tjera të rëndësishme të infrastrukturës financiare.⁴⁹

Në këtë kontekst, BQK gjatë vitit 2017, ka filluar punën në draftimin e Rregullorës për Mbikëqyrjen e Sistemeve të Pagesave me Rëndësi Sistemike si dhe Metodologjinë për vlerësimin e sistemeve të pagesave. Të dy këto dokumente janë përgatitur në formë draftit duke u bazuar në parimet e lartë cekura për infrastrukturën e tregut financiar si dhe dokumentet përkatëse rregullative të Bankës Qendrore të Evropës për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e sistemeve të pagesave të rëndësishme sistemike. Finalizimi dhe implementimi i rregullores dhe dokumenteve përcjellëse pritet të fillojë në një të ardhme të afërt, duke dhënë kontribut në rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit të pagesave përmes garantimit të strukturave efikase në menaxhimin e rreziqeve ndaj infrastrukturës së tregut financiar në përgjithësi dhe sistemit të pagesave në veçanti, si dhe në sigurimin e qeverisjes efikase të korporatave për mbrojtjen ndaj rreziqeve përkatëse.

⁴⁹ Bank for International Settlements and International Organization of Securities Commissions. *Principles for financial market infrastructures*. April 2012, <https://www.bis.org/cpmi/publ/d106.pdf>

9. Korniza për Makroprudencë

Në vitin 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore i cili mandaton BQK-në për përpilimin dhe implementimin e politikave për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, ka adaptuar Politikën për Makroprudencë, e cila tashmë është publikuar në faqen zyrtare të BQK-së.

Në përpjekje për të rritur transparencën në lidhje me Politikën për Makroprudencë dhe vendimet përkatëse, BQK do të publikojë analizë të rregullt të rrezikut sistemik dhe ecurisë së treguesëve të politikës për makroprudencë.

9.1. Identifikimi dhe Vlerësimi i Rrezikut Sistemik

Rreziku sistemik nënkupton rrezikun e ndërprerjeve të konsiderueshme të ofrimit të shërbimeve financiare, të cilat manifestohen me pasoja të rëndësishme negative për stabilitetin financiar dhe ekonominë në tërësi. Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut sistemik duhet të bëhet konform natyrës dy dimensionale të rrezikut sistemik: atë të kohës si dhe të strukturës. Dimensi i kohës nënkupton identifikimin dhe vlerësimin e mundësisë së akumulimit të rrezikut sistemik në kohë, ndërsa aspekti strukturorë nënkupton vlerësimin e rrezikut ndaj sistemit që rrjedh nga ndërlidhjet ndërmjet akterëve financiarë dhe koncentrimin në tregje e sektorë të caktuar.

Banka Qendrore e Kosovës në vazhdimësi monitoron dhe vlerëson rreziqet e përgjithshme ndaj stabilitetit financiar përmes metodave dhe modeleve të ndryshme, të cilat komplementohen me gjykim profesional. Analizat e rrezikut sistemik përfshijnë zhvillimet në sektorët kryesorë të ekonomisë ndaj të cilëve ekspozohet sektori financiar, si dhe zhvillimet brenda vet sektorit financiar dhe implikimet për stabilitetin e tij. Përveç analizës së treguesve kryesorë të zhvillimeve në sektorët përkatës, BQK ka zhvilluar dhe adaptuar disa modele për vlerësimin e rreziqeve. **Modeli i Hartës së Stabilitetit Financiar** analizon zhvillimet në tetë dimensione të rrezikut ndaj stabilitetit financiar siç janë: zhvillimet e jashtme dhe të brendshme makroekonomike, gjendja dhe zhvillimet e agjentëve kryesorë ekonomikë si ndërmarrjet, ekonomitë familjare, dhe qeveria, si dhe gjendja dhe zhvillimet në treguesit e brendshëm të rrezikut të sektorit financiar si kapitalizimi, likuiditeti dhe struktura e sektorit bankar.

Modeli i Stres-testit është një nga veglat kyçe për identifikimin e brishtësive aktuale në sektorin financiar dhe rreziqeve potenciale sistematike në vitin vijues. BQK ka të zhvilluar **modelin e Identifikimit të Bankave me Rëndësi Sistematike**, i cili është avancuar në vazhdimësi dhe së fundi është adaptuar konform udhëzimeve të fundit të Autoritetit Bankar Europian (angl: *European Banking Authority*). Modeli i bankave me Rëndësi Sistematike është instrument tipik i politikës makroprudenciale i cili vlerëson rrezikun e shpërndarjes së efekteve negative të një institucioni sistematik në tërë sistemin.

Model tjetër tipik i politikës makroprudenciale, të cilin BQK ka avancuar së fundmi është edhe **Modeli i Kapitalit Shtesë Kundërciklik**. Kapitali shtesë kundërciklik përbën një ndër instrumentet kryesore të politikës makroprudenciale për të adresuar pro-ciklikalitetin në sektorin financiar dhe për të forcuar qëndrueshmërinë e sistemit bankar duke rritur kërkesat për kapital në kohën kur kreditimi është në fazën e rritjes përtej fundamentaleve të ekonomisë. Avancimet në model janë realizuar në linjë me udhëzimet e Komitetit të Bazelit si dhe praktikën e unifikuar të mënyrës së kalkulimit të Hendekut të Kreditimit. Avancimet janë thelbësore dhe me implikime të rëndësishme për nevojat për kapital shtesë kundërciklik për rastin e Kosovës. BQK do të punojë me përkushtim në avancimin e modeleve ekzistuese si dhe zhvillimin e instrumenteve tjera në funksion të arritjes së objektivave të Politikës Makroprudenciale. Modelet dhe Instrumentet do të kalibrohen konform

standardeve ndërkombëtare dhe rrethanave vendore, dhe do të shërbejnë si bazë për vendimet e Politikës Makroprudenciale.

9.2. Kapitali shtesë kundërciklik

Kapitali shtesë kundër-ciklik ka për qëllim forcimin e stabilitetit financiar përmes mbrojtjes së sektorit bankar ndaj humbjeve që mund të shkaktohen nga akumulimi i rrezikut sistemik ciklik në një ekonomi, si dhe përmes ndikimit në sigurimin e qëndrueshmërisë së ofertës kreditore përgjatë gjithë ciklit financiar. Kapitali shtesë kundër-ciklik është pjesë e kornizës rregullative të Bazel III dhe njëherit një ndër instrumentet kryesore të politikës makroprudenciale për të adresuar dimensionin ciklik të rrezikut sistemik.

Duke rritur kërkesat për kapital në kohën kur kreditimi është në fazën e rritjes përtej fundamentaleve të ekonomisë (rritet në shpejtësi më të madhe se sa bruto prodhimi i një vendi dhe perceptohet si rritje e tepërt e kreditimit), ky instrument synon rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit (solvensës së bankave) për të përballuar situatat e stresit financiar që mund të pasojnë nga akumulimi i rrezikut si rezultat i rritjes së tepërt të kreditimit. Njëherit, instrumenti, përmes lirimimit të rezervave të kapitalit të akumuluar në fazën e rritjes, ndikon në nxitjen e rritjes së kreditimit në periudha të stresit financiar, me qëllim të evitimit të bartjes së pasojave negative të rënies së kreditimit në gjithsej sektorin financiar dhe ekonominë e vendit.

Për llogaritjen e kapitalit shtesë kundër-ciklik, udhëzimet e Komitetit për Mbikëqyrje Bankare të Bazelit⁵⁰ sugjerojnë monitorimin e disa parametrave për vlerësimin nëse kreditimi është duke u rritur përtej fundamentaleve të qëndrueshme dhe rrjedhimisht është duke ndikuar në akumulimin e rrezikut sistemik. Krahas vlerësimit të parametrave sipas udhëzimeve përkatëse, autoritetet relevante duhet të gjykojnë relevancën e aplikimit të kërkesave kundër-ciklike të kapitalit.

BQK, në Politikën për Makroprudencë⁵¹, liston instrumentin e kërkesave kundër-ciklike të kapitalit si instrument të mundshëm të objektivitetit të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale për zvogëlimin dhe parandalimin e rritjes së tepruar të kredive dhe të levës. Konform udhëzimeve të bazelit, parametri kryesor për përcaktimin e normës së KCK-së theksohet të jetë hendeku i kreditimit ndaj bruto produktit vendor (BPV) në Kosovë, krahas tregueseve të tjerë relevantë do të merren parasysh.

Në vijim, paraqitet i ashtuquajtur i model për vlerësimin e kërkesës për kapital kundër-ciklik për sektorin bankar të Kosovës. Devijimi i raportit të kreditimit ndaj BPV-së nga trendi i tij afat-gjatë paraqet parametrin kryesor të modelit. Llogaritja e hendekut të kreditimit ndaj BPV-së bëhet duke u bazuar në udhëzimet e Bazelit si dhe praktikën e unifikuar të bazuara në rekomandime, përmes filterit të njëanshëm Hodrik-prescott ($\lambda = 400,000$).

Hendeku i kreditimit është llogaritur në linjë me udhëzimet e Komitetit të Bazelit si dhe praktikën e unifikuar të mënyrës së kalkulimit nga shumica e vendeve në botë, të bazuara në rekomandime nga hulumtimet empirike. Në kreditim janë përfshirë kreditë ndaj sektorit privat⁵² nga bankat si dhe institucionet financiare jo bankare. Këto të fundit megjithëse në pjesëmarrje të ulët në gjithsej kreditimin, janë duke u rritur më normë të lartë të rritjes dhe duke zgjeruar pjesëmarrjen në sektorë të caktuar. Andaj, përfshirja e kredive të sektorit jo bankar përkundër që ka pjesëmarrje të ulët dhe aktualisht pa ndonjë efekt në rezultat të hendekut të kreditimit, siguron konsistencë në mënyrën e llogaritjes me vendet tjera, si dhe siguron që të përfshihen efektet e rritjes së mundshme të peshës së kreditimit ndaj sektorit privat nga institucionet financiare jo bankare.

⁵⁰ Banka për Ndërmjetësime Ndërkombëtare (2010). Udhëzimet për autoritetet nacionale që operojnë shtesën e kapitalit kundër-ciklik, Komiteti për Mbikëqyrje Bankare i Bazelit, dhjetor.

⁵¹ BQK (2018). *Politika për Makroprudencë, Prishtinë, qershor*.

⁵² Mospërfshirja e kredive të sektorit publik dhe kredive ndaj ndërmarrjeve financiare në llogaritjen e hendekut të kreditimit siguron që dinamikën në kreditim nuk ndikohet nga ndryshime të mundshme në kreditimin e sektorit publik apo sektorin financiar.

Rezultatet e hendekut të kreditimit në fund të vitit 2017 sugjerojnë që sektori privat në Kosovë asnjëherë nuk ka kaluar nëpër periudhë të ‘mbi kreditimit’. Ky rezultat përkon me faktin që sektori financiar në Kosovë është ende në fazë të hershme të zhvillimit dhe ekonomia e Kosovës është në fazën e rritjes së ndërmjetësimit financiar dhe konvergimit me vendet tjera (figura 123). Raporti i kredisë së sektorit privat ndaj BPV-së në Kosovë në dhjetor 2017 qëndroi në 41.4 përqind, përderisa mesatarja e këtij raporti në rajon qëndron mbi 55 përqind.

Kalkulimi i kapitalit të nevojshëm shtesë është bërë sipas udhëzimeve përkatëse nga Komiteti i Bazelit me ç ‘rast kërkesa për kapital shtesë (në përqindje të aseteve të peshuara me rrezik) është zero atëherë kur hendeku është më i vogël se 2 pikë përqindje, dhe me rritjen e hendekut mbi vlerën 2 deri në 10 pikë përqindje kërkohet mbajtje e kapitalit shtesë deri në nivelin maksimal 2.5 përqind. Sipas rezultateve të mësipërme, që sugjerojnë që Kosova vazhdon të ketë hendek negativ të kreditimit ndaj BPV-së, si dhe vazhdon të jetë në periudhë graduale të thellimit të ndërmjetësimit financiar për të arritur së paku nivelin e vendeve të rajonit, deri më tani nuk janë paraqitur asnjëherë nevojat për kërkesë të mundshme të kapitalit kundër-ciklik (figura 124).

Duhet theksuar se në vlerësimin përfundimtar të nevojave për kapital shtesë kundër-ciklik me qëllim të përdorimit të instrumentit si mjet të Politikës makroprudenciale në të ardhmen, duhet të konsiderohen fuqia e treguesit të hendekut të Kreditimit në sinjalizimin e ciklit të biznesit dhe akumulimin e rrezikut sistemik, që për rastin e Kosovës është në një masë e limituar për shkak të historikut të shkurtër të sektorit bankar (serisë kohore të shkurtër si dhe njëtrajtshmërisë së zhvillimeve pa ndonjë periudhë të stresit financiar). Andaj, në këtë kontekst, duhet të analizohen treguesit shtesë dhe në masë të madhe të përdoren të dhënat kualitative dhe gjykimi i profesionistëve të fushës për vendimmarrjen në përdorimin e mundshëm të këtij instrumenti.

9.3. Bankat me rëndësi sistematike

Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistematike paraqet një vegël të rëndësishme për vlerësimin e vazhdueshëm të dimensionit strukturor dhe ndërsektoral të rrezikut sistemik që ndërlidhet me bankat me rëndësi sistematike. Rezultatet e përgjithshme të modelit, me të dhëna të muajit dhjetor 2017, sugjerojnë që katër banka janë me rëndësi të përgjithshme sistematike (figura 125).

Figura 123. Hendeku i kreditimit




Figura 124. Kapitali shtesë kundër-ciklik




Tabela 13. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë⁵³


Kriteri	Indikatorët
Madhësia (pesha 25%)	Asetet (pa provizione)
Zëvendësueshmëria (pesha 25%)	Vlera e transaksioneve në raport me gjithsej vlerës së transaksioneve të sektorit përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj ekonomive familjare Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jo-financiare Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e ekonomive familjare
Ndërlidhshmëria (pesha 25%)	Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave tjera financiare dhe plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë) Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e korporatave tjera financiare dhe huazimeve tjera (duke përfshirë edhe depozitat e bankave tjera) Pjesëmarrja në letrat me vlerë
Aktiviteti ndërshtetëror dhe Kompleksiteti (pesha 25%)	Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor

Burimi: BQK (2018)

Dy nga këto banka kanë rezultuar me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret. Rezultatet po ashtu tregojnë që një bankë e cila nuk ka rëndësi të përgjithshme sistemike ka rezultuar e rëndësishme sistemikisht në kriterin e ndër lidhshmërisë. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike shtrihet nga 1,202 pikë bazë deri në 2,675 pikë bazë, që paraqet rritje në krahasim me vitin 2016, kryesisht si rezultat i rritjes në kriterin e ndër lidhshmërisë për bankat e mëdha. Shuma e shkallës së rëndësisë sistemike, sidoqoftë, ka shënuar rënie, të ndikuar kryesisht nga rënia e ekspozimeve dhe detyrimeve ndaj institucioneve financiare e bankave më të vogla. Gjithashtu, një bankë, e cila në dy vitet e fundit kaloi lehtësisht pragun e kufirit të rëndësisë sistemike, këtë vit mbetet nën kufi, kryesisht si rezultat i ndryshimit të bilancit me institucione tjera financiare si dhe rritjes së konkurrencës nga bankat më të vogla që rritën peshën e tyre në gjithsej asetet dhe kreditë e sektorit, gjë që ka ndikuar rënien e shumës së shkallës së rëndësisë sistemike.

Kriteri i madhësisë –Katër banka, të cilat kanë rëndësi të përgjithshme sistemike, rezultuan të rëndësishme sistemikisht në kriterin e madhësisë (figura 126). Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,304 pikë bazë në 2,400 pikë bazë. Shuma e shkallës së rëndësisë sistemike ka rënë krahasuar me vitin paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së konkurrencës në sektorin bankar, ashtu që bankat më të vogla kanë


Figura 125. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike



Burimi: BQK (2018)

shkallës së rëndësisë sistemike, sidoqoftë, ka shënuar rënie, të ndikuar kryesisht nga rënia e ekspozimeve dhe detyrimeve ndaj institucioneve financiare e bankave më të vogla. Gjithashtu, një bankë, e cila në dy vitet e fundit kaloi lehtësisht pragun e kufirit të rëndësisë sistemike, këtë vit mbetet nën kufi, kryesisht si rezultat i ndryshimit të

Figura 126. Kriteri i madhësisë



Burimi: BQK (2018)

⁵³ Për bazën teorike dhe metodologjinë e plotë të vlerësimit të Bankave me Rëndësi Sistemike, shih Materialin Studimor nr. 7 të BQK-së me titull 'Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë'.


përsheptuar rritjen e aktivitetit të tyre, theksuar aktivitetin kredi dhënës, duke rritur pjesëmarrjen e aseteve krahasuar me vitin paraprak.

Kriteri i zëvendësueshmërisë – katër bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike rezultuan sistemikisht të rëndësishme në kriterin e zëvendësueshmërisë. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,438 pikë bazë në 2,376 pikë bazë (figura 127). Edhe në këtë kriter, shumica e shkallës së rëndësisë sistemike ka shënuar rënie krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i rënies së stokut të kredisë së ekonomive familjare si dhe depozitave të ekonomive familjare nga dy banka me rëndësi sistemike, përderisa bankat me pjesëmarrje më të ulët, që nuk janë me rëndësi të përgjithshme sistemike, kanë rritur këto ekspozime.

Kriteri i ndërlidhjes – Ky kriter karakterizohet me luhatjet më të mëdha ngase bankat mund të ndërrojnë me lehtësi bilancin e tyre ndaj institucioneve financiare, si dhe investimet në letrat me vlerë. Në dhjetor 2017, me rëndësi sistemike në kriterin e ndërlidhjes rezultuan tri banka, për dallim nga gjashtë sa ishin në dhjetor 2016. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,796 pikë bazë në 2,821 pikë bazë (figura 128). Krahasuar me vitin paraprak, totali i shkallës së rëndësisë sistemike ka rënë si rezultat i rënies së aseteve ndaj institucioneve financiare të bankave më të vogla si dhe njëres nga bankat me rëndësi të përgjithshme sistemike, përderisa bankat më të mëdha kanë rritur këto ekspozime ndaj dhe shkallën e rëndësisë sistemike në këtë kriter.


Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe i kompleksitetit – Tri nga katër bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike kanë rezultuar të jenë me rëndësi sistemike në kriterin e aktivitetit ndërshtetëror. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,407 pikë bazë në 3,104 pikë bazë (figura 129). Krahasuar me vitin paraprak, shumica e shkallës së rëndësisë sistemike ka rënë si rezultat i rënies së aseteve por dhe detyrimeve ndaj jorezidentëve nga banka që në vitin e kaluar ishte me rëndësi të përgjithshme sistemike. Ndërsa, bankat me rëndësi sistemike shënuan rritje të detyrimeve ndaj jorezidentëve si dhe të mjeteve jashtëbilancore, duke ndikuar në rritjen e përqendrimit të shkallës së kompleksitetit.

Figura 127. Kriteri i zëvendësueshmërisë




Burimi: BQK (2018)

Figura 128. Kriteri i ndërlidhjes



Burimi: BQK (2018)

Figura 129. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit



Burimi: BQK (2018)

Duhet theksuar se sektori ka dëshmuar ndër vite që është mjaftë mirë i kapitalizuar dhe aplikimi i shtesave të kapital mbi kapitalin e klasit të parë të rekomanduara nga Bazel dhe ABE nuk do të tejkalonte nivelin aktual të kapitalit për sektorin bankar në Kosovë, ndaj dhe aktualisht modeli shërben vetëm për monitorimin e dinamikës së rëndësisë sistemike dhe mbikëqyrjen më të informuar dhe adekuate të institucioneve konform rëndësisë së tyre sistemike, dhe nuk paraqet rekomandim për aplikim të shtesës së kapitalit për institucione me rëndësi sistemike vendore.

9.4. Përmbledhje e zhvillimeve në tregues të zgjedhur të makroprudencës

Në gjysmën e dytë të vitit 2017, zhvillimet e përgjithshme të indikatorëve makroprudencë në Kosovë ishin të qëndrueshme, pa ndonjë kërcënim për stabilitetin financiar të vendit. Të gjithë treguesit financiarë ishin brenda parametrave të përcaktuar me kornizën legjislative. Kreditë jo performuese ndaj totalit të kredive janë karakterizuar me trend rënës dhe janë përcjellë me mbulueshmëri adekuate. Treguesit e kapitalizimit për sektorin në përgjithësi, dhe bankat me rëndësi sistemike në veçanti ishin mjaft mbi kërkesat rregullative. Ngjashëm me treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, raporti i levës së gjithsej sektorit bankar dhe i bankave me rëndësi sistemike vazhdoi të mbetet mbi kërkesat minimale ligjore. Indikatorët e likuiditetit ishin në nivel të kënaqshëm, në veçanti raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurta që ishte mbi kërkesat rregullative. Koncentrimi i ekspozimeve të mëdha në sistem bankar qëndroi në nivel adekuat me tendencë uljeje. Treguesit e profitabilitetit, në veçanti Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK), qëndroi në nivel të lartë, përderisa hendeuku Kredi/BPV (anglisht: *credit to GDP gap*) jep sinjale se sektori bankar në Kosovë ka hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit kreditues në kuadër të kornizës së ambientit makro-financiar në të cilin vepron, përkundër rritjes vjetore dyshifrore gjatë vitit 2017. Deri në dhjetor, sektori bankar vazhdoi të ketë katër banka me rëndësi sistemike, përderisa rezultatet e analizës stres-test për këto banka në vazhdimësi sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit bankar për të përballuar situata ekstreme të ekspozimit ndaj rrezikut të tregut apo rrezikut të likuiditetit. Edhe analiza e përgjithshme e treguesve të shëndetit të sektorit të sigurimeve, si indikatorë potencialisht të rëndësishëm për makroprudencën, sugjeron që stabiliteti financiar i Kosovës nuk kërcënohet nga sektori i sigurimeve marrë parasysh peshën e vogël të sektorit në sistem financiar. Gjithashtu, ndërlidhja në mes të sektorit të sigurimeve dhe atij mikrofinanciar dhe segmenteve tjerë të sistemit financiar është ende në nivel të ulët, gjë që minimizon mundësitë e shpërndarjes së rreziqeve ndërmjet segmenteve të ndryshme të sistemit financiar të Kosovës.

10. Shtojca Statistikore

Shtojca 1. Harta e Stabilitetit Financiar - Dinamika e ndryshimit të rrezikut të treguesve dhe kontributi në rrezik nga komponentët përkatës

Figura 1. Ekonomia e jashtme




Figura 2. Ekonomia e brendshme




Figura 3. Ekonomitë familjare






Figura 4. Sektori i ndërmarrjeve




Burimi: BQK (2018)

Figura 5. Sektori qeveritar




Burimi: BQK (2018)

Figura 6. Struktura e sektorit bankar




Burimi: BQK (2018)

Figura 7. Kapitalizmi dhe profitabiliteti



Burimi: BQK (2018)

Figura 8. Likuiditeti dhe financimi



Burimi: BQK (2018)

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2014	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016	Dhjetor 2017
Mjaftueshmëria e kapitalit	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	17.8	19.0	17.9	18.1
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	14.6	16.7	15.9	16.2
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	4.7	3.0	2.2	1.2
Cilësia e asetëve	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	8.3	6.2	4.9	3.1
<i>Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive</i>	Korporatat tjera financiare	0.4	0.4	0.4	0.2
	Korporatat publike jofinanciare	0.03	0.03	0.00	0.00
	Korporatat tjera jofinanciare	65.7	65.6	63.9	63.6
	Ekonomitë familjare	33.9	33.9	35.7	36.2
	QUSHEF	0.01	0.01	0.02	0.01
	Jo-rezidente	0.02	0.02	0.02	0.02
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
	Profitabiliteti	Kthimi në asete (KNA)*	2.2	2.5	2.4
Kthimi në kapital (KNK)*	22.5	21.6	19.9	22.1	
Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	75.9	75.8	68.1	65.1	
Shpenzimet e jo-nteresit ndaj të hyrave bruto	66.6	51.6	49.6	45.3	
Likuiditeti	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	25.9	24.2	26.3	25.4
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	32.8	29.2	31.7	30.1
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	32.4	30.9	34.5	32.2
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	41.0	37.3	41.5	38.2
Senzitiviteti ndaj riskut të tregut	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	1.8	1.8	4.4	1.2
	Grupi i zgjeruar i indikatorëve				
	Kapitali ndaj asetëve	10.8	12.2	12.1	12.6
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	97.1	63.5	66.9	81.7
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	41.7	36.8	36.4	40.3
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	8.1	6.5	6.0	5.5
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	129.3	130.3	125.8	119.5
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	0.0	3.7	4.1	3.9

*Janë konsideruar të hyrat neto para taksës.

Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)



Rruga Garibaldi, Nr.33, Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org